ISSN 1857-6443

Emri Zaevi paralajmëron referendum

Fq.4

REFORMAT NË ARSIM

Lektura nga shekulli i kaluar

Fq.7

Aubamejang te Arsenali është vetëm çështje kohe

Fq.21

www.koha.mk

Koha

Të jetosh me këngën autoktone shqipe

Fq.12-13

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XII · Numri 3279 · e martë 30 janar, 2018 · -3°c | 12°c · 15 DEN

EDITORIAL

Jeniçerë e qiraxhinj!



Sigurisht që kohët e nizamëve kanë perënduar, por, si duket, jo edhe koha e mendësisë jeniçere. Kjo mendësi ende vuan pasojat e të qenit vasal të një ideologjie apo idiolatrie që pikëtakimin e gjen jo në harqet e një ure që lidhin dy kultura e dy vende, por në varkat e shpuara që nxjerrin andej lumit individë me sensibilitete të dyzuara e kaotike etnokulturore. Se kjo është kështu flet edhe një prirje pak a shumë e deformuar e jona që ne në të kaluarën

Fq.2

GLOBI

Facebook dhe Google, kërcënim për shoqërinë

Fq.15

RAJON

19 vjet nga deklarata e Grupit të Kontaktit në Londër

Fq.14

VMRO KËMBËNGUL NË AMENDAMENTE, SHUMICA SHQYRTON SKENARËT

BETEJE E RENDE PËR GJUHËN SHQIPE

Vetëm për vërejtjen e presidentit në lidhje më dënimet e larta në të holla për institucionet që nuk e respektojnë zbatimin gjuhës, VMRO ka dorëzuar mbi 20 mijë amendamente, merr vesh gazeta KOHA. Realisht që të ndodh kjo, nëse nuk akumulohen amendamentet, debati edhe përskaj asaj që Parlamenti mund të punojë 24 orë, ai do të mund të zgjatet disa muaj

Fq.3

Lutja e dy grave të sëmura

Tetovë, 29 janar - Familja dyanëtarëshe Osmani nga fshati Veshallë jeton në një skamje të vërtetë. Nëna Hasija së bashku me vajzën Firixhan nuk kanë asnjë të ardhur, kurse para disa kohësh - përveçse u është ndalur ndihma sociale, atyre u është ndërprerë edhe rryma elektrike për shkak të borxhit ndaj EVN-së. Nënë e bijë janë me të meta psiqike dhe jashtë rrjedhës së jetës normale. Që tragjedia të jetë më e madhe, ata në këtë periudhë kanë ngelur pa rrymë elektrike për shkak se borxhi i papaguar është 58 mijë denarë, mjete këto që kjo familje nuk mund t'i sigurojë. "Nuk kemi rrymë, na kanë ndalur, kemi dru mjaft, por rrymë nuk kemi", ishin fjalët e vetme që mund të shqiptonte Firixhan Osmani, banore e fshatit Veshallë. Ajo thotë se ushqim u sjellin fshatarët, por pa rrymë nuk mund të jetojnë...

Fq.6

EDITORIAL

JENIÇERË E QIRAXHINJ!

Emin AZEMI

Sigurisht që kohët e nizamëve kanë perënduar, por, si duket, jo edhe koha e mendësisë jeniçere. Kjo mendësi ende vuan pasojat e të qenit vasal të një ideologjie apo idiolatrie që pikëtakimin e gjen jo në harqet e një ure që lidhin dy kultura e dy vende, por në varkat e shpuara që nxjerrin andej lumit individë me sensibilitete të dyzuara e kaotike etno-kulturore. Se kjo është kështu flet edhe një prirje pak a shumë e deformuar e jona që ne në të kaluarën por edhe sot, me sjelljet e punët tona, sikur kemi parapëlqye të ndihemi qiragjinjë në vendin tonë, dhe dofarë jeniçerësh të lodhur në dhe të huaj.

Kemalistë, Erdoganistë, Gylenistë, pro-turq, pro-kurdë. Të gjitha këto atribuime, të ndërlidhura me emra politikanësh e kombesh të largëta jashtë hapësirës sonë, po rishfaqen edhe njëherë në manualin e gjeopolitikës sonë private. Turqia si nocion gjeografik, por pse jo edhe emocional, ditëve të fundit ka nxjerrë në sipërfaqe një radiografi interesante prirjesh e pikëpamjesh, që si shkas morën ndërhyrjet e ushtrisë turke në disa vendbanime kurde në Siri dhe gjetiu. Asnjë ngjarje e madhe në afërsinë tonë gjeografike nuk mund të shikohet me indiferentizëm dhe, më së paku ato, si kjo që ndodhë në Turqi, që drejtpërdrejt apo tërthorazi prekin edhe sensibilitet grupore e individuale të njerëzve të hapësirës sonë. Së këndejmi, mund të mirëkuptohen edhe ato reagime që shprehin një dozë shqetësimi për fatet e këtij vendi euro-aziatik, madje përfshi edhe pozitën e shqiptarëve në të, sepse destabilizimi i tij reflektohet edhe në stabilitetin rajonal, aq më tepër kur kemi të bëjmë me vend-anëtar të NATO-s, por si ti kuptojmë ato brengosje që zhvillimet e një vendi të huaj i përkthejnë si të ishin ngjarje tona të brendshme. Protagonizmi dhe tifozeria e kësaj lloj brengosjeje nuk bazohet gjithmonë mbi impaktin që mund të kenë ato ngjarje në planimetrinë tonë të përgjithshme kombëtare, por ekskluzivisht në një dioptri të ngushtë e shtrembër, që shumë lehtë mund të identifikohet si interes klanor a grupor i njerëzve dhe qarqeve që metaforën për "babën dovlet" e kanë shndërruar në aksiomë të përditshmërisë së tyre.

Fundja, ç'të keqe ka edhe kjo metaforë, nëse ajo buron nga ndjeshmëria e pastërt e një kujtimi a nostalgjie, por s'na duket normale që lavjerrësi i animit të lëviz me aq dinamizëm në një kontekst social e kulturor tonin, e që nxjerr si përfundim atë thënien e moçme se "shqiptarët vdesin për të qenë mercenarë të huaj". Në krijimin dhe mirëqenien e kombit turk dhe Turqisë si shtet, shqiptarët e Ballkanit kanë dhënë jo pak mprehtësi lapsi dhe ashpërsi shpate, duke u integruar pastaj në rrjedhat shoqërore të këtij vendi me të gjitha kapacitet dhe resurset humane e intelektuale, fakt të cilin nuk e kanë mohuar edhe autoritetet e këtij vendi. Kështu kanë diktuar rrethanat dikur dhe shqiptarët nuk kanë patur fuqinë dhe fatin që t'i ndryshojnë këto rrjedha të historisë, por ajo që hë për hë del të mos ketë ndonjë sens të madh mirëkuptimi, është tendenca për t'u bërë pjesë e një milieu politik e kulturor që, jo vetëm se ndodhet fizikisht larg nesh, por në praktikë nuk prodhon kurrfarë efekti nxitës në zhvillimin shtesë të mirëqenies sonë sociale, kulturore e politike, pos atij që kthjelltësinë e alpeve e shndërron në mjegull fushe.

Shqiptarët aktualisht kanë ku t'i harxhojnë energjitë e tyre individuale e kolektive në mënyrë që arsimi i tyre të jetë më i dinjitetshëm, që përfaqësimi institucional të kaloj nga muskujt te trutë, që të rinjtë me ikjet e tyre të mos e shndërrojnë këtë vend në një "shtëpi të madhe pleqsh", e shumë e shumë preokupimesh të tjera më madhore se galja për "babën dovlet", i cili edhe ashtu nuk është kah na pyet neve.

ÇKA PËRMBAN MARRËVESHJA ME GREQINË?

"A ka mundësi dikush që të na e sjelle tekstin e marrëveshjes me Greqinë? Këta heshtin, grekët heshtin. Mirëpo kur heshtin të gjithë grekët, d.m.th. që nuk kane kundërshtime... pra kanë marrë aq sa të kënaqin edhe kundërshtarët e tyre. Një popull që të vret për një gisht gardh, nuk pyet për asgjë përtej gardhit. Po falen 365.000.000 metra katrorë det me një vlerë gazi e nafte deri në 70 miliardë dollarë. Protesta bëhet për gishtat e hapur si këmbë të drejta të Bashës dhe të tjerëve dhe mandej thonë se nuk jemi popull me mendësi katundare! Na e sillni tekstin dhe të bindemi për të vërtetën, se si duken punët ky ishte shërbimi më i madh që bizantino-jeniçerët, i kanë bërë Greqisë. Kush të mundet të na e sjellë tekstin e marrëveshjes, nuk duam llafe në mbledhje, duam atë që është nënshkruar. E sa për vitin e Skënderbeut, po bëhet shteti shqiptar sa zotërimet e tij 550 vjet më parë...", shkruan në profilin e tij në Facebook, prof.dr. Shenasi Rama.

POLITIKA QË BRAKTISI SHKUPIN

"Duket se politikanët shqiptarë e kanë braktisur Shkupin, për fat të keq. Selitë e partive kryesore, që tashmë janë rrudhur si BDI dhe PDSH, që në zgjedhjet e fundit pësoi humbje katastrofale, i kanë në Tetovë, ndërsa disa parti të tjera, që duhet të ngjallin shpresë për shqiptarët, janë strukur në qytete të tjera edhe më periferike si Struga dhe Gostivari. Nuk e di pse tremben politikanët shqiptarë nga Shkupi. Do të doja mendimin e drejtuesve të këtyre partive, të anëtarëve apo edhe të simpatizantëve. Miq ju ftoj të shprehni mendimin tuaj: Kanë bërë mirë që kanë shmangur Shkupin, apo duhet të vendosen sa më shpejt në Shkup, çfarë e pengon një gjë e tillë?", shkruan në profilin e tij në FB, shkrimtari Izet Duraku.



KUR FLET ALBINI

"Kur themi 'jemi me të dobëtin', a jemi duke thënë se Batoni është i dobët, apo se edhe Batoni ashtu si ne është me të dobëtit? Albini foli për një person të fuqishëm të medias i cili ka bashkëpunuar me Stanishiqin në kohëra të errëta e represive, ka bashkëpunuar me personat kryesorë të SHIK-ut, ka normalizuar disa nga të korruptuarit e pasluftës, dhe ia ka shpëlarë fytyrën shumëkujt, së voni edhe Gruevskit. Por Albini nuk përmendi emër. Nga e di Batoni që Albini po flet për të? Dikush mund të thotë: pse shkoni pra tek Batoni. Por, njësoj siç shkruajmë në FB mendimin tonë, pa u pajtuar doemos me Markun me mbiemër të gjatë e sidomos pa u pajtuar Marku me ne, ashtu shkojmë edhe te Batoni me mbiemër mesatar, për të thënë mendimin tonë, ashtu siç e kemi, edhe për të", shkruan publicisti Arbër Zaimi në profilin e tij në FB.



DITA E HËNË DHE "LËRE FARE"

" Desha t'ju tregoj një histori për patatet që i piqnim në mangall. Pastaj mu kujtua uji i bunarit. Në fakt mu kujtua bostani që e lëshonim të ftohet thellë në bunar. Desha t'ju tregoj edhe për zhurmën që bënte kopeja e dhive kur kthehej nga kullota... Janë histori të bukura, po pastaj mu kujtua që nesër është e hënë dhe thash 'lëre fare'", shkruan në FB, aktivistja Anita Latifi.

MEDIACitate

Një nëpunës në Spanjë, ka punuar vetëm 18 muaj në jetën e tij profesionale 15 vjeçare ndërkaq pjesën tjetër e ka kaluar me leje e raporte mjekësore dhe ka marrë pagë. Sipas lajmit të publikuar nga gazeta El Pais, nëpunësi i cili punonte si asistent në një spital psikiatrik në qytetin Alicante në juglindje të Spanjës, në vitet 2001-2016 sapo mbaronte ditët e lejes, merrte raport mjekësor dhe këtë e përsëriste vazhdimisht. Gjatë kësaj periudhe, nëpunësi ka marrë raport për 4553 ditë edhe atë 7 herë raport mjekësor 1 vjeçar dhe 3 herë nga 1 vit e gjysmë. Jashtë raporteve, nëpunësi ka përdorur dhe leje ligjore dhe për këtë periudhë ka punuar vetëm 18 muaj. Alejandro Moral, një nga zyrtarët e qytetit, në deklaratën e tij ka theksuar se sado që veprimi nuk është etik, ai është legal dhe se ndaj nëpunësit i cili ka vepruar brenda kornizave ligjore kanë hapur hetim disiplinor. Ndërkaq nëpunësi në fjalë, e fitoi padinë ndaj Këshillit Kombëtar për Sigurim Social meqenëse dëshmoi se nuk e kanë informuar se pas mbarimit të raportit do të duhet të kthehet në punë. Mësohet se nëpunësi, i cili në kuadër të ligjit për mbrojtje të të dhënave personale nuk është i detyruar të tregojë sëmundjen e cila sipas tij e ka penguar në kryerjen e detyrës, ka vazhduar të marrë pagë prej 1500 eurove.

(Anadolu Agency, 29 janar)

Qëndrimi i shteti të Malit të Zi lidhur me Marrëveshjen për shënjimin e vijës kufitare me Kosovën mbetet i pandryshueshëm, përderisa zyrtarët në Prishtinë presin që kjo çështje të jetë një nga temat e diskutimit gjatë vizitës së kryeministrit të Malit të Zi, Dushko Markoviq, më 6 shkurt. Analistët politikë në Prishtinë, nuk presin që vizita e kryeministrit malazias do të ndikojë në ndonjë qëndrim ndryshe për ratifikimin e demarkacionit në Kosovë. Kryeministri i Malit të Zi, Dushko Markoviq, pritet të vizitojë Kosovën me ftesë të kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, në një kohë kur Kuvendi i Kosovës pritet të deklarohet përfundimisht rreth Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi.

(REL, 29 janar)

NËSE NUK E KENI DITUR...

NGA E KA PREJARDHJEN EMRI I TIRANËS?

Ekzistojnë disa hipoteza për prejardhjen e emrit Tiranë. Njëra hipotezë është që emri Tiranë vjen nga fjala Theranda, e përmendur në burimet e lashta greke dhe latine, që vendasit e quanin "Të ranat", meqë fusha ishte formuar si rezultat i materialeve të ngurta që sillnin ujërat nga malet përreth. Në një nënversion të kësaj hipoteze Tirana ose Tirônë, siç quhet në dialektin e vendit, e ka origjinën nga mënyra se si thirreshin banorët e këtij vendi. Duke qenë se popullsia e vendosur në këtë territor vinte kryesisht nga malet e zonës përreth atëherë nga vendasit ato quheshin "Të rônë" (të rënë). Edhe sot, në gjuhën e përditshme, për familjet që vijnë nga zonat malore përdoret shprehja "kanë rënë (psh) në Durrës" (apo diku tjetër). Hipoteza e dytë është që emri Tirana vjen nga Tirkan. Tirkan ka qenë një kështjellë në shpat të malit të Dajtit. Akoma ekzistojnë rrënojat e kësaj kështjelle të lashtë që daton në fillimin e shekullit të parë para lindjes së Krishtit dhe mendohet të këtë qenë kështjella që historiani bizantin Prokop (shek.VI), e quan kështjella e Tirkanit. Hipoteza e tretë është që emri Tirana vjen nga Greqishtja e Vjetër Tyros, që do të thotë bulmet. Në fushën e Tiranës, bëhej tregtimi i bulmetrave nga barinjtë e zonave përreth. Me siguri dihet që për herë të parë emri i Tiranës përmendet në vitin 1418 në një dokument të Venedikut.

VMRO KËMBËNGUL NË AMENDAMENTE, SHUMICA SHQYRTON SKENARËT

BETEJË E RËNDË PËR SHQIPEN

Vetëm për vërejtjen e presidentit në lidhje më dënimet e larta në të holla për institucionet që nuk e respektojnë zbatimin gjuhës, VMRO ka dorëzuar mbi 20 mijë amendamente, merr vesh gazeta KOHA. Realisht që të ndodh kjo, nëse nuk akumulohen amendamentet, debati edhe përskaj asaj që Parlamenti mund të punojë 24 orë, ai do të mund të zgjatet disa muaj

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 29 janar - Ndonëse pritej që të hënën në seancën e 32 plenare Ligji për gjuhët të jetë pika e parë e rendit të ditës, kjo nuk ndodhi për shkak të mos përkthimit në gjuhën shqipe të 35 mijë amendamenteve të VMRO-së. Së paku kështu u arsyetuan zyrtarët e Parlamentit, edhe pse VMRO përsëriti kërkesën drejtuar shumicës parlamentare që të njëjtit të tërhiqen nga Ligji për gjuhët, ose i njëjti të futet në rend dite dhe të fillojë procedimi i mbi 32 mijë amendamenteve të kësaj partie. Kryeparlamentari Talat Xhaferi mos futjen e Ligjit për gjuhët në rend të ditës e arsyetoi me faktin se pas mos nënshkrimit të Ligjit për gjuhët nga ana e presidentit Gjorgje Ivanov, Rregullorja e punës së Parlamentit e obligon atë që maksimum për 30 ditë, i njëjti Ligj të nis në lexim të tretë.

"Ligji u miratua me shumicën e deputetëve - 69 vota, ndërsa u votua edhe me shumicën e Badenterit prej 27 votave 'për' nga 29 gjithsej, Siç e dimë, Ligji nuk u nënshkruar nga presidenti, cili dhe kanë dhënë vërejtjet e veta. Sipas Ligjit dhe Rregullores së Parlamentit, deri në 30 dite mund të pres që Ligji të futet në lexim të tretë. Pra nuk bëhet fjalë për asnjë skenarë", theksoi Xhaferi. Paraprakisht, njëri nga koordinatorët e grupeve parlamentare të VMRO-së, Ilija Dimovski, akuzoi deputetët e shumicës parlamentare se kanë skenarin që brenda ditës të votohet për nënkryetarët e Parlamentit në mënyrë, siç tha ai, që Parlament të punojë 24 orë duke aluduar në diskutimet mbi amendamentet e VMRO-së.

"Fillojmë seancë qe ka rëndësi të veçantë për Maqedoninë. Tezat se Parlamenti është para një bllokade nuk janë të vërteta. Ligji për gjuhët jo vetëm sipas VMRO-së, por edhe sipas eurokomisarit Johanes Han nuk është në agjendën evropiane. Përkrah të gjitha thirrjeve, përkundër refuzimit për debat publik, përkundër faktit që nuk u morën parasysh amendamentet, sot do të bëjmë hap tjetër. Shumica sot ka për qëllim të vendos në rend ditë zgjedhjen e nënkryetarëve në mënyrë që Parlamenti të punojë 24 orë në shtatë ditë. Kjo është shkelje klasike e demokracisë, andaj sot kërkojmë një orë pauzë", tha Dimovski. Por kryeparlamentari Xhaferi mohoi se në rend dite do të vendoset zgjedhja e nënkryetarëve dhe shtoi se nuk bëjnë asnjë shkelje klasike të demokracisë. "Mendoj se nëntë muaj mjaftonim të kuptoni se asgjë nuk ka ndryshuar, dhe unë jam këtu që kur deputetët kërkojnë debate - atë edhe tua mundësojmë. Nuk është e vërtetë ajo që thoni se vendosim sot në rend dite zgjedhjen e nënkryetarëve dhe bëjmë shkelje klasike të demokracisë", tha Xhaferi. Pa pauzës, ishte vet Dimovski nga VMRO që pati konferencë për shtyp me kërkesë të gazetarëve. Ai kishte qëndrimin se VMRO është pro avancimit të gjuhës shqipe në organet e pushtetit qendror, por se është kundër shkeljeve të procedurave parlamentare. "Janë vetë BDI dhe LSDM që flisnin për transparencë për kyçje në debat, për mendimet e ekspertëve për ligje tjera..., tani atë që çka kanë akuzuar - e bëjnë vetë. Askush në VMRO nuk është kundër avancimit të gjuhës shqipe, por jemi kundër shkeljeve të procedurave parlamentare. Për LSDM-në dhe BDI-në nuk është fare i rëndësishëm mendimi i opinionit publik, as i profesorëve të së drejtës kushtetuese as dhe profesorëve shqiptarë madje, asgjë për ta nuk vlen për përveç numrit 61 në Parlament", tha mes tjerash Dimovski. Në pyetjen e se pse VMRO dorëzon mijëra amendamente kur në bisedimet për formimin e Qeverisë ka pranuar Ligjin e njëjtë për gjuhët, siç thonë funksionarë të BDI-së, Dimosvki tha shkurt se bëhet fjalë për Ligj që përcakton të ardhmen e funksionimit të shtetit për 15 a 20 vitet e ardhshme, prandaj, sipas tij, të gjitha palët duhet të kyçen në debat. Konferencë për shtyp pati edhe lideri i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, i cili porositi VMRO-në që të heqin dorë nga sjelljet e tilla për përfitime politike. "Për Aleancën për Shqiptarët, nuk ka kuptim sjellja e VMRO-DPMNE-së që të vijnë në Parlament vetëm që t'u kundërvihen interesave të më shumë se një të tretës së qytetarëve. Për ne është e papranueshme termi 'përdorimi i gjuhës që e flasin 20 për qind e qytetarëve'. Askush nuk ka të drejtë që të shpik definicione për gjuhën tonë, ashtu siç reagojnë maqedonasit për çështjen emrit. Ajo është gjuha shqipe dhe ashtu duhet që të qëndrojë", deklaroi Sela.

Ndryshe, shumica parlamentare është kategorikë që Ligji për gjuhët të mos ndryshohet, por i njëjti në fund të votohet. "Nuk do të lejohet që Ligji të pësojë ndryshimet, do të jetë i njëjti që do të votohet në fund - pavarësisht çështjes së amendamenteve", thonë deputet të LSDM-së. Ata nuk pranojnë të flasin nëse do të presin harxhimin e debatit për Ligjin në fjalë ose për ndonjë skenar që të votohet në fillim të debatit në lexim të tretë. Ndryshe, deputetë të BDI-së përjashtojnë çdo mundësi për kompromis me VMRO-në që të ndryshohet Ligji për gjuhët. "Pa u lëshuar në diskutime si e pse apo sa mund të zgjatet, sepse nuk duam të prejudikojmë për asgjë, por që të bëhet kompromis me VMRO-në për ndryshimin e Ligjit, as nuk guxohet të mendohet e lërë më të bëhet fjalë", thonë deputetët e BDI-së. Ndërkaq në kuluaret parlamentare flitet për skenarë të mundshëm si ti shmangen bllokadës së deputetëve të VMRO-së. Njëri ka të bëjë me atë që Parlamenti të punojë pandërprerë me ndihmën e nënkryetarëve, dhe që në fillim të akumulohen disa mijëra amendament në një - ngaqë Rregullorja e punës mundëson që kur bëhet fjalë për nenin e njëjtë dhe shprehje të përafërta, kryeparlamentari të ketë të drejtën që të akumulojë vetëm në një amendament. Skenari tjetër është që të shfrytëzohet koha kur asnjë deputetë i VMRO-së të mos jetë në sallë dhe debati të quhet i konsumuar dhe menjëherë të kalohet në votim. Por që të ndodh skenari i dytë, e pritshme është që VMRO të protestojë edhe jashtë Parlamentit, por se do të llogaritet në presionin e ndërkombëtarëve ndaj kësaj partie. Sipas dispozitave ligjore, në lexim të tretë partitë kanë të drejtë të propozojnë amendamente në vërejtjet e shënuara të presidentit. Për një amendament, çdo deputet mund të diskutojë deri në 3 minuta, ndërsa kryetarët e grupeve parlamentare deri në 10 minuta. Vetëm për vërejtjen e presidentit në lidhje më dënimet e larta në të holla për institucionet që nuk e respektojnë zbatimin gjuhës, VMRO ka dorëzuar mbi 20 mijë amendamente, merr vesh gazeta KOHA. Realisht që të ndodh kjo, nëse nuk akumulohen amendamentet, debati edhe përskaj asaj që Parlamenti mund të punojë 24 orë, ai do të mund të zgjatet disa muaj.

OSMANI: LIGJI PËR GJUHËT DO TË SILLET EDHE PËRKUNDËR PENGESAVE

Ligji për përdorimin e gjuhëve do të sillet edhe krahas asaj se presidenti Gjorge Ivanov nuk e nënshkroi dhe tentimit të VMRO-DPMNE-së në opozitë me amendamentet e dorëzuara për ta bllokuar atë. Kundërshtimi i tyre është vërtetim për mungesën e ndjenjës së përgjegjësisë dhe ndjeshmërisë në lidhje me këto çështje, deklaroi sot zëvendëskryeministri, Bujar Osmani. Ai në takimin me gazetarët duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve theksoi se Ligji për gjuhët del nga amendamenti 5 i Kushtetutës së RM-së dhe Marrëveshja e Ohrit dhe se me sjelljen e tij do të rrumbullakohet zbatimi i marrëveshjes politike, e cila është sjellë 17 vjet më parë. "Ligji është brenda kornizave të Kushtetutës dhe e plotëson edhe frymën e Marrëveshjes së Ohrit. I kaloi të gjitha faza në Qeveri. Na vjen keq që presidenti i shtetit nuk e nënshkroi ligjin dhe nuk arriti ta shfrytëzojë vitin e fundit të mandatit të tij të jetë faktor kohezioni në shoqëri. Megjithatë, na vjen keq edhe se partia opozitare VMRO-DPMNE nuk e shfrytëzon këtë momentum për t'i vërtetuar pohimet e veta pas zgjedhjeve se janë interpretuar gabimisht dhe se janë me prirje antishqiptare ose se kanë gabuar në raportin me shqiptarët", tha Osmani. Sipas tij, ata kanë pasur mundësi të tregojnë ndjeshmëri ndaj kësaj çështje të ndjeshme pasi që në asnjë mënyrë zhvillimi i mundësisë shqiptarët ta përdorin gjuhën e tyre në institucione nuk e rrezikon të drejtën e asnjë komuniteti tjetër, e as unitetin e shtetit, e as të vetë shtetit.

ZAEV: OPOZITA TË MOS E BLLOKOJË PARLAMENTIN

E drejta e opozitës të parashtrojë amendamente për ligjin për gjuhë duhet të respektohet, por njëkohësisht edhe obligimi se përmes kësaj të drejte bllokohet puna e Parlamentit, porositi kryeministri Zorab Zaev. Ai theksoi se është i shqetësuar çfarë do të ndodhë me reformat nëse bllokohet Kuvendi dhe si do të miratohen ligjet të cilat janë të rëndësishme për Planin 3-6-9 nga procesi i reformave. "Maqedonia është para një klime pozitive për rekomandim të mundshëm për fillimin e negociatave për BE, ndërsa shpresoj në qershor madje edhe për datë për fillimin e negociatave. Nëse i bllokojmë reformat nuk mund të themi se do të lëvizim në këtë drejtim, por besoj se edhe opozita do të jetë e arsyeshme në fushëveprimin e Rregullores që e ofron Parlamenti. Shpresoj se do të gjendet zgjidhje në bisedimet midis koordinatorëve dhe përfaqësuesve të opozitës dhe të partive në pushtet", deklaroi Zaev. Ligji, shtoi ai, është në procedurë normale dhe ai, siç theksoi, personalisht në Ohër e ka prezantuar në verën e vitit të kaluar pas çfarë u hap debat. "Besoj se Parlamenti do të veprojë konform Ligjit për Parlamentin, Rregullorja dhe rregullat e tjera ligjore pozitive dhe pres që puna të udhëhiqet në koordinim te kryetari i Parlamentit. Është me rëndësi të ruhen procedurat demokratike konform Ligjit për Parlament dhe Rregullore, sepse demokracia është imperative", potencoi Zaev.

Kryeministri Zaev konfirmoi se LSDM-ja mbetet në vendimin se nëse gjendet zgjidhje për çështjen e emrit, populli do të prononcohet në referendum

NËSE ARRIHET KONSENSUSI KOMBËTAR PËR ZGJIDHJEN E KONTESTIT

ZAEVI PARALAJMËRON REFERENDUM PËR EMRIN

Shkup, 29 janar - Besoj se mundemi të gjejmë konsensus kombëtar në funksion të zgjidhjes së problemit me emrin, e jo në funksion të bllokimit të tij apo shtyrjes së serishme. Tani është momenti i vërtetë të zgjidhet kjo çështje, tha të hënën kryeministri Zoran Zaev. "Të shtunën kishim takim informativ në të cilin i ndamë të gjitha informacionet e mundshme që i kemi unë dhe ministri i Punëve të Jashtme të cilët erdhën nga negociatori për emrin Vasko Naumovski. Ndërtuam strategji, ndërsa unë e prezantova se si do të vazhdojmë në të ardhmen", deklaroi Zaev në përgjigjen e pyetjes pas përfundimit të seancës për "Ryshfetin" dhe theksoi se qëndrimet e VMRO-DPMNE-së dihen. Debati potencoi, është i hapur, ndërsa për çështje të tilla edhe duhet të jetë i hapur. "Të gjithë duhet ta dimë se mundemi ta zgjidhim problemin, por mund edhe të mos zgjidhet. Pas kësaj dielli sërish do të lindë, por nëse do na ngrohë dhe nëse fëmijët tanë do të vazhdojnë t'i ngrohë diku nëpër botën e bardhë është vendim i politikanëve. Gjithsesi pushteti e ka përgjegjësinë më të madhe, por jam i bindur se edhe presidenti i shtetit edhe opozita dhe të gjithë faktorët politikë në shoqëri do të jenë të arsyeshëm që të gjejmë zgjidhje e cila do ta ruajë dinjitetin e popullit tonë dhe të vendit tonë", tha Zev. Me rëndësi, theksoi ai, është të kemi kujdes edhe nga pala greke, sepse ndoshta zgjidhja do të jetë e pranueshme për ne, por nuk do të kalojë në Greqi apo e kundërta, ndoshta do të jetë e pranueshme për palën greke, ndërsa nuk do të kalojë këtu. Kryeministri

konfirmoi se LSDM-ja mbetet në vendimin se nëse gjendet zgjidhje për çështjen e emrit, populli do të prononcohet në referendum. "Qëndrimi i LSDM-së është të gjendet zgjidhje së bashku me opozitën dhe në fund zgjidhja përfundimtare të konfirmohet në referendum. Kjo nuk është aq e frikshme, tragjike apo e pamundur. Referendumi organizohet në pajtim me ligjet e procedurës së shpejtë dhe nëse ndalemi të gjithë, para së gjithash politikanët dhe i kumtojmë qëndrimet tona do t'i ndihmojmë popullit të dalë dhe ta tregojë qëndrimin e tij. Kjo është çështje tejet thelbësore, por këtë nuk e shohim si frenues apo barrierë, por si garanci shtesë për Republikën e Greqisë se zgjidhja do të jetë e përhershme, konsistente dhe mbetet për shekuj e shekuj", tha Zaev. Nimicit, siç theksoi, do t'ia transmetojnë të gjitha qëndrimet tona me të gjitha argumentet dhe shtoi se në këto qëndrime ka druajtje edhe për palën greke, sepse theksoi, për qëllim kemi ajo të kalojë edhe në Greqi. "Besoj se i tillë është edhe qëllimi i Greqisë, të paktën ashtu u prezantua para meje nga kryeministri Cipras se njëkohësisht është shumë me rëndësi zgjidhja të kalojë edhe në Maqedoni, në këtë mënyrë dhe mund të gjendet zgjidhje", theksoi Zaev. Me ngritjen e problemit për emrin do të fitojmë datë për fillimin e negociatave me BE-në, anëtarësimin në NATO, por edhe jetë më të mirë, sepse NATO-ja dhe BE-ja sjellin investime dhe aspekte pozitive ekonomike për qytetarët. "Shpresoj se me veprim të arsyeshëm do të gjejmë zgjidhje të këtij problemi shumëvjeçar dhe se të gjithë do të jemi të përqendruar para se gjithash për interesin e qytetarëve dhe për Republikën e Maqedonisë", theksoi kryeministri Zoran Zaev.

MARRËVESHJA ME SHUMICË TË GJERË PARLAMENTARE

Vlerësimi se ekziston afrim i pozicioneve të Qeverisë janë pjesë e partive greke, ndërsa me të dhe se marrëveshja eventuale do të votohet në Parlamentin grek, por se edhe Panos Kamenos nuk do të krijojë probleme, deklaroi të hënën zëdhënësi i Qeverisë greke, Dimitris Xanakopulos, duke folur për radion greke Real Fm. "Në negociatat vijmë me pozicion kombëtar, gjegjësisht emër i përbërë me përcaktim kohor apo gjeografik, tërheqje të pozicioneve dhe qëndrimeve irredentiste të fqinjit. Nëse në bazë të kësaj arrihet marrëveshje, plotësisht jam i sigurt se nuk do të kemi vetëm shumicë parlamentare, por do të kemi shumicë të gjerë parlamentare", tha Xanakopulos. Në intervistë, lajmëron korrespondenti i MIA-s nga Athina, zëdhënësi qeveritar dha vlerësim për takimet që kryeministri grek i pari të shtunën me liderët e partive politike. "Konkluzioni politik nga takimet e kryeministrit me liderët politikë është se duket se po krijohet afrim i pozicioneve të më shumë partive, me përjashtim të Lidhjes Centraliste dhe z. Micotakis", sqaroi zëdhënësi i Qeverisë greke për Real fm. Për marrëdhëniet midis Aleksis Ciprasit dhe Panos Kamenosit, Xanakopuls tha se "ekziston kimi e mirë midis tyre", dhe nuk sillet në pikëpyetje stabiliteti i Qeverisë.

Emri kërkon përgjegjësi të gjerë

Shkup, 29 janar - Deputeti Artan Grubi, kryetar i Komisionit për Çështje Evropiane, të hënën u takua me ambasadorin e Greqisë në Shkup, Dhimitris Janakakis. Deputeti Grubi dhe ambasadori Janakakis biseduan dhe shkëmbyen mendime për gjendjen politike aktuale në vend dhe në rajon, negociatat Shkup - Athinë rreth kontestit me emrin, marrëdhëniet e mira fqinjësore, si dhe për integrimin euroatlantik. Kryetari i Komisionit për Çështje Evropiane, Artan Grubi, para ambasadorit Janakakis u shpreh i kënaqur që kreu shtetëror në vend mbajti takim koordinues para vizitës së ardhshme të ndërmjetësuesit Nimic në Shkup dhe Athinë. Deputeti Grubi, gjithashtu, e përshëndeti takimin e parë të drejtpërdrejt të kryeministrave Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras, javën e kaluar në Davos, dhe vlerësoi se ky paraqet një angazhim të fortë për intensifikimin e procesit për zgjidhjen e kontestit me emrin. Koha për zgjidhje është tani dhe të gjithë të cilët synojnë në integrimin euroatlantik dhe fqinjësinë e mirë duhet të bëhen pjesë të zgjidhjes konsensuale dhe të pranuar reciprokisht. Integrimi në NATO dhe anëtarësimi në Bashkimin Evropian janë prioritetet tona absolute dhe se kjo duhet të jetë pika e lidhjes ndërmjet të dyja vendeve në interes të prosperitetit dhe stabilitetit të tërë rajonit.

NDËRMJETËSI I OKB-VE NIS MARATONËN E TAKIMEVE

NIMIC E FILLOI VIZITËN NË ATHINË, TË MËRKURËN NË SHKUP

Athinë. 29 janar - Ndërmjetësuesi i Kombeve të Bashkuara mes Maqedonisë dhe Greqisë për kontestin e emrit, Methju Nimic dje e filloi vizitën në Athinë, në suaza të negociatave të ripërtërira mes dy vendeve për zgjidhjen e kësaj çështje të hapur, e cila paraqet pengesë për anëtarësimin e vendit në BE dhe NATO. Nimic vjen për vizitë në dy vendet pas takimit të parë direkt të kryeministrave Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras, javën e kaluar në Davos, në të cilin ata dakorduan lëshime të të dyja palëve, ngritjen e negociatave në nivel të shefave të diplomacive, por edhe përpjekjen e fuqishme për intensifikimin e procesit për zgjidhjen e kontestit të emrit. Ndërmjetësuesi do të ketë biseda së pari me autoritetet greke, ndërsa pastaj edhe me ata të Maqedonisë për koordinim rreth çështjes së emrit, të cilën ditëve të fundit edhe Cipras edhe Zaev e kishin me kreun shtetëror-politik në vendet e tyre. Ai me ftesë të autoriteteve të të dyja vendeve, së pari do të mbajë takime me kreun shtetëror-politik në Athinë, në të cilat pritet të informohet për përpjekjet e Qeverisë së kryeministrit, Aleksis Cipras për ta harmonizuar pozitën në raport të mënyrës për zgjidhjen e kontestit me faktorët politik në vend. Cipras të premten dhe të shtunën kishte një sërë takimesh me kreun shtetëror-politik për koordinimin e pozitës për çështjen e emrit, me ç'rast pas përfundimit të tyre doli me konkluzionin se obligohet në periudhën e ardhshme me përgjegjësi patriotike të synohet drejt zgjidhjes së përbashkët të pranueshme. Kryeministri grek vlerësoi se është bërë progres, por shtoi se ende është e gjatë rruga deri te marrëveshja. Nimic, sipas agjendës së tij, e cila edhe zyrtarisht ishte konfirmuar, pritet më 31 janar të arrijë në Shkup, ndërsa ditën e ardhshme janë paraparë takimet me kreun shtetëror. Në takimet ai do të informohet për konkluzionet nga takimi koordinues i kreut shtetëror politik, që u mbajt të shtunën për propozimet e tij, nga e cila Zaev shfaqi optimizëm për konsensus kombëtar, ndërsa lideri i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski doli me qëndrimin se përgjegjësia tani është në duart e Qeverisë, por edhe se partia konsideron se kontesti duhet të zgjidhet, ndërsa me këtë rast të mbrohen interesat kombëtare dhe shtetërore. Në raundin e fundit të bisedimeve për emrin që u mbajt më 17 janar në Nju-Jork ndërmjetësuesi Nimic doli me një set sugjerimesh dhe propozimesh dhe vlerësoi se në horizont duket zgjidhja e kontestit shumëvjeçar mes Maqedonisë dhe Greqisë. Raundi i parë i negociatave të ripërtërira mes Maqedonisë dhe Greqisë u mbajt më 12 dhjetor të vitit të kaluar në Bruksel.

PROPOZIM-NDRYSHIMET E LIGJIT PËR GJYKATËS

FSHIHET NOTA 8 PËR GJYKATËS

Deputetët me votimin "për" ndryshimet e Ligjin për gjykata, do të vendosin kushte të reja për zgjedhje të gjykatësve, respektivisht pritet të shfuqizohet kushti për "minimum mesataren 8". Në arsyetimin ligjor ku sqarohet intervenimi në nenin 8 të Ligjit për gjykata, thuhet se ky kriter ndryshohet për shkak se sistemi i studimeve të disperzuara ka konstatuar një sistem të pabarabartë të vlerësimit të dijes, i cili nuk ka dhënë vlerësim real të suksesit të kandidatëve

Koha — Omer XHAFERI

Shkup, 29 janar - Rritja e shkallës së specializimit të gjykatësve dhe formimi i sektorëve për procedim të lëndëve nga sferave e ekonomisë brenda gjykatave civile, parashihet në ndryshimet e fundit të Ligjit për gjykata. Plotësim shtesë i këtij Ligji, siç thuhet në propozim-versionin e Ministrisë së Drejtësisë, pritet të bëhet edhe në sferën e dispozitave për mënyrën e ndarjes së lëndëve gjyqësore në Gjykata. Me ndryshimet e Ligjit të gjykatave, i cili fillimisht duhet të kalojë në Qeveri, mendohet të bëhet edhe precizimi i kompetencave të Gjykatës Supreme/Lartë të Maqedonisë, e cila thuhet se do të ketë të drejtën e formimit të Këshillit për shqyrtim të ankesave që i adresohen Këshillit Gjyqësor të Maqedonisë. Detyrim tjetër të cilin Gjykata e Lartë e Maqedonisë duhet ta përmbush pasi këto ndryshime të kalojnë në Parlament, lidhet me obligimin ligjor të publikimit të qëndrimeve parimore dhe mendimeve ligjore në adresën elektronike të saj. Përmes respektimit të këtyre dispozitave, ndryshimet e Ligjit për gjykata synojnë sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjeve nga gjykatat. Propozimi-ligji i ri për gjykata, i përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, mes tjerash parasheh kushte të reja për pranim të gjykatësve të porotës.

Shfuqizimi i kushtit për "arsim të lartë", të cilën duhej ta përmbushin kandidatët për gjykatës porotë, në ta ardhmen nuk do të vlejë. Dhënia e provimeve shtesë për gjykatësit, sipas propozim-ligjit, thuhet se është dështuar si masë jo efikase, e cila ka ndikuar në rritjen e nevojës për gjykatës porotë në të gjitha instancat gjyqësore të vendit. Kriter i vetëm i cili edhe në të ardhmen do të duhet të plotësohet nga kandidatët për gjykatës porotë, konform Ligjit aktual, është trajnimi profesional i cili realizohet nga ana e Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik. Deputetët me votimin "për" ndryshimet e Ligjit për gjykata, do të vendosin kushte të reja për zgjedhje të gjykatësve, respektivisht me plotësimin e Ligjit në fjalë pritet të fshihet (shfuqizohet) kushti për "minimum mesataren 8". Në arsyetimin ligjor, ku sqarohet intervenimi në nenin 8 të Ligjit për gjykata, thuhet se ky kriter ndryshohet për shkak se sistemi i studimeve të disperzuara ka konstatuar një sistem të pabarabartë të vlerësimit të dijes, i cili nuk ka dhënë vlerësim real të suksesit të kandidatëve. Njëkohësisht, me këto ndryshime, sic thuhet në këtë propozim-ligj, bëhet harmonizimi me plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor në sferën e mënyrës së vlerësimit të gjykatësve dhe precizimin (konkretizimin) e dispozitave të përmbajtjes për Programin e punës që duhet ta parashtrojë kandidati për kryetar i një gjykate deri te Këshilli në fjalë.

Ndalese e gjykatësve për ta shfrytëzuar funksionin e tyre dhe reputacionin e gjykatës për interese personale është njëra prej shumë ndryshimeve që pritet të futën në përmbajtjen e re ligjore të Ligjit për gjykata. Mes tjerash, këto ndryshime synojnë përforcimin e të drejtës të palës gjatë kohës kur ajo ankohet për një veprim të caktuar të gjykatësit apo nëpunësit gjyqësor. Ndryshe, me plotësimin e këtij Ligji, pritet të ridefinohen arsyet për një shkelje më të rëndë disiplinore, për shkak të së cilës është iniciuar procedura për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit, si bazë për shkarkim. Gjykatësit, ndaj të cilëve do të inicohet procedurë disiplinore, e cila brenda kohës nga ana e Këshillit për konstatim të përgjegjësisë, do të vërtetohen këto shkelje, të njëjtit parashihet t'i nënshtrohen një trajnimi shtesë pranë Akademisë për gjykatës dhe prokuror publik. Nga ana tjetër, masa disiplinore mund të shqiptohet edhe në drejtim të uljes së rrogës mujore, e cila mund të arrijë deri nga 15 deri në 30 për qind më pak nga të hyrat e rregullta. Sidoqoftë, meqë bëhet fjalë për ligje sistemore, miratimi dhe votimi i tyre në Parlament, siç qëndrojnë punët, nuk pritet të bëhet në një të ardhme të shkurtër. Arritja e dy të tretave të votave (81 deputetë), është shkalla e domosdoshme që duhet ta plotësojë Parlamenti, që këto ligje dhe të tjerët të ngjashëm si ky të hyjnë në fuqi. Mirëpo, gjatë muajve të kaluar, shumë profesorë universitar dhe njohës të rrethanave politike kanë theksuar se pa përfshirjen e opozitës maqedonase në reformat e gjyqësorit, të VMRO-së në këtë rast, kjo nismë e LSDM-së dhe partive tjera nuk do të mund të realizohet.

ZAEVI ME VANGELLOVSKIN DO TA REFORMOJ GJYQËSORIN

Shkup, 29 janar- Kryetari e Gjykatës Supreme, ai i Apelit dhe kryetari i Gjykatës Penale të Shkupit do të jenë pjesë e Këshillit për implementim të reformave në sistemin gjyqësor, me të cilin do të kryesojë kryeministri Zoran Zaev. Krahas kryetarit të Gjykatës së Lartë, Jovo Vangellovskit, atij të Apelit, Liljana Ivanovska dhe Ivan Xholev nga Gjykata Penale, pjesë e këtij Këshilli të ri do të jenë edhe kryeprokurori i shtetit, Lubomir Jovevski dhe prokurorja speciale, Katica Janeva. Lajmin në fjalë kryeministri Zaev personalisht e publikoi të hënën, me çka shtoi se konsultimet rreth këtij Këshilli janë në fazë përfundimtare dhe brenda kësaj jave, ai edhe zyrtarisht do të formohet. Për një zbatim të suksesshëm të reformave në sistemin e juridik të Maqedonisë, kryeministri mes tjerash shtoi se nevojitet përfshirja e praktikantëve, gjegjësisht kryetarëve të tre gjykatave më të larta në vend, prokurorët, si dhe përfaqësues nga Shoqata e Gjykatësve dhe Odës së Avokatëve të Maqedonisë, të cilët do të ndihmohen nga profesorë të shquar dhe persona nga sektori civil. Qëndrimit i kryeministrit Zaev për rolin e këtij Këshilli, nuk paraqet madhësia e tij. Për opinionin më të gjerë, anëtari i cili padyshim ka ngjallur më tepër kureshtje është gjykatësi Jovo Vangellovski, ndaj të cilit janë iniciuar disa procedura disiplinore për vërtetim të përgjegjësisë për arratisjen e dy personave, ndoshta më të kërkuar nga Prokuroria Speciale Publike, Goran Grujoski dhe Nikolla Boshkovski. Lidhur me këtë çështje, kryeministri Zaev nënvizoi se pjesëmarrja në Këshillin e ri, nuk duhet të lidhet me personalitetet, por me përfaqësuesit e institucioneve. "Duke filluar nga vetja e deri te të gjithë funksionarët tjerë, të gjithë ndryshojmë dhe jemi të kalueshëm. Pikënisje nuk janë emrat dhe mbiemrat e personaliteteve", tha Zaev. Formimi i Këshilli për implementimin e reformave në gjyqësor pason pas shfuqizimit të Këshillit për reforma në gjyqësor, i cili u themelua në korrik të vitit të kaluar nga ana e ministrit të Drejtësisë, Bilent Saliji.

Aktivitet dhe puna e këtij Këshilli, ndonëse nga kabineti qeveritar dhe vetë ministri u vlerësua si tejet produktive, megjithatë një pjesë e anëtarësisë së Këshillit për reforma në gjyqësor, kryesisht profesorë, në disa raste shprehen pakënaqësi dhe revoltë lidhur me mënyrën e funksionimit të Këshilli 29 anëtarësh. *(O.XH)*

KRONIKË

Tragjedi në Manastir, nënë e bir vdesin nga zjarri

Një nënë (50) dhe biri i saj 17-vjeçar e kanë humbur jetën në zjarrin që ndodhi herët në mëngjes në shtëpinë familjare në Manastir. Arsyeja për zjarrin, sipas informatave fillestare të zjarrfikësve të Manastirit, është instalimi i vjetër elektrik i shtëpisë që ndodhet në rr."Devejani" nr.115. Ekip i Prokurorisë Themelore Publike - manastir, MPB dhe Shërbimi zjarrfikës kryejnë ekspertizë në vendin e ngjarjes. Prokurori publik kompetent dha urdhër për fotografim dhe sigurim të vendit të ngjarjes, si dhe për kryerje të të gjithë ekspertizave të nevojshme në drejtim të konfirmimit të arsyeve për zjarrin. Është dhënë urdhër për autopsi të trupave të gjetur dhe po ndërmerren aksione të tjera të nevojshme për zbardhje të rastit. Kostadin Popovski, komandant në Njësitin zjarrfikës territorial - Manastir, deklaroi se zjarri është raportuar në mëngjes në orën 4:05. Menjëherë është dërguar ekip me pesë zjarrfikës dhe dy automjete zjarrfikëse, por kur kanë mbërritur zjarri veçmë ka qenë në fazë të zhvilluar dhe e ka përfshirë konstruksionin e çatisë. Popovski apelon deri te qytetarët që të kenë kujdes që gjatë mbrëmjes në shtëpitë e tyre të mos lënë zjarr të hapur.

Humb jetën një alpinist në Kodrën e Diellit

P.A (58) nga Shkupi ka vdekur pasi ka rënë pa ndjenja derisa dje ka qenë për alpinizëm në vendin "Anteni" në Kodrën e Diellit, informoi zëdhënësi i SPB Tetovë Marijan Josifovski. Sipas të dhënave të tij rasti është paraqitur dje rreth orës 17 e 45 minuta nga ana e V.N (35) nga Shkupi i cili së bashku ka qenë për alpinizëm me të ndjerin P.A. Prokuroi Publik dhe ekip i SPB Tetovë ka kryer ekspertizë të kompletuar por nuk janë konstatuar gjurmë të dhunës. Me urdhër të prokurorit trupi i pajetë i P.A i është dorëzuar familjes.

Vazhdojnë aksionet e kontrollit në komunikacion

Edhe gjatë ditës së diel në rajonin më të gjerë të Tetovës dhe Gostivarit janë zbatuar aktivitete dhe kontrolle të përforcuara të komunikacionit, në të cilat gjithsej janë zbuluar rreth shtatëdhjetë kundërvajtje të ndryshme. Nga këto 12 kanë të bëjnë me drejtim të automjeteve motorike pa leje për vozitje, 7 automjete të paregjistruara, ndërsa i konsiderueshëm është numri edhe i atyre që kanë tejkaluar shpejtësinë e lejuar, në dhe jashtë vendbanimeve. Kundërvajtjet e zbuluara në aksionin e ditës së djeshme janë rrumbullakuar me 27 sanksione për kundërvajtje, 43 fletëpagesa për gjobë, si dhe 8 vërejtje me shkrim. *(U.H)*

NËNË E BIJË NGA VESHALLA NË GJENDJE TË RËNDË

LUTJA E DY GRAVE TË SËMURA

"Janë me të meta dhe nuk ka kush përkujdeset për këta dyja. Ata mund të tentojnë të ngrohen dhe mund të ndezet e tërë shtëpia. Kjo shtëpi është djegur më herët, sepse ata nuk mund të përkudjesen as për veten e tyre", tha Daut Nurishi, imam i fshatit Veshallë

Koha — Urim HASIPI

Tetovë, 29 janar - Familja dyanëtarëshe Osmani nga fshati Veshallë jeton në një skamje të vërtetë. Nëna Hasija së bashku me vajzën Firixhan nuk kanë asnjë të ardhur, kurse para disa kohësh - përveçse u është ndalur ndihma sociale, atyre u është ndërprerë edhe rryma elektrike për shkak të borxhit ndaj EVN-së. Nënë e bijë janë me të meta psiqike dhe jashtë rrjedhës së jetës normale. Që tragjedia të jetë më e madhe, ata në këtë periudhë kanë ngelur pa rrymë elektrike për shkak se borxhi i papaguar është 58 mijë denarë, mjete këto që kjo familje nuk mund t'i sigurojë. "Nuk kemi rrymë, na kanë ndalur, kemi dru mjaft, por rrymë nuk kemi", ishin fjalët e vetme që mund të shqiptonte Firixhan Osmani, banore e fshatit Veshallë. Ajo thotë se ushqim u sjellin fshatarët, por pa rrymë nuk mund të jetojnë normalisht për shkak të nevojave të tyre elementare. Banorët e këtij fshati konfirmojnë se nënë e bijë nuk janë në gjendje të mirë dhe krahas gjendjes sociale, ata poashtu janë edhe të sëmura dhe nuk kanë asnjë mundësi të paguajnë rrymën elektrike. "Nuk është në rregull që të ndalet rryma elektrike për këtë familje. Këto dy anëtare të kësaj familje, siç e shihni - nuk janë në gjendje të mirë as shëndetësore e as mentale. Pra janë me të meta dhe nuk ka kush përkujdeset për këta dyja. Ata mund të tentojnë të ngrohen dhe mund të ndezet e tërë shtëpia. Kjo shtëpi është djegur më herët, sepse ata nuk mund të përkudjesen as për veten e tyre", tha Daut Nurishi, imam i fshatit Veshallë. Kohë më parë, me iniciativën e fshatarëve dhe mërgimtarëve të fshatit Veshallë, u është rregulluar shtëpia dhe brendia, kurse banorët i ndihmojnë me ushqim dhe veshmbathje. "Ne kemi një shoqatë me emrin 'Veshalla' e cila funksionon në Zvicër. Ajo shoqatë u ka ndihmuar që të rregullojnë banjon dhe disa rregullime brenda shtëpisë kësaj familje", thotë imami Nurishi. Tashmë disa banorë kanë marrë iniciativë që të grumbullojnë mjete, por në ndërkohë presin ndihmë edhe nga institucionet tjera që të shlyhet borxhi dhe sërish në këtë familje të kthehen dritat. Nga EVN kanë thënë se janë të gatshëm që të ndihmojnë këtë familje. "EVN Maqedoni si çdoherë është në shërbim të konsumatorëve. Ashtu si për raste të tjera, edhe këtë rast do ta trajtojmë duke ofruar ndihmë dhe mundësi të përshtatshme. Në lidhje me rastin e këtij konsumatori nga fshati Veshallë, informojmë se i njëjti është shpërngulur në objekt të ri dhe nuk ka parashtruar kërkesë për lidhje të re në rrjetin distributiv. Në lidhje me njehsorin e objektit të vjetër, ai ka borxh të caktuar për të cilin do të gjejmë mënyra për lehtësim të pagesës. Më pas, pas kërkesës së parashtruar, do të mund të bëjmë lidhjen në rrjet", Vjosa Selimi zëdhënëse e EVN-së.

Sugareski pret aneks marrëveshjen për autostradën Kërçovë-Ohër

Shkup, 29 janar - Në fazë përfundimtare është aneks marrëveshja me kompaninë kineze "Sinohidro" për vazhdimin e afatit për ndërtimin e autostradës Kërçovë-Ohër, që skadon për disa ditë. Vlerësohet se do të arrihet marrëveshje për 36 muaj shtesë. "Vazhdimisht kemi takime me kompaninë kineze me qëllim që ta arrijmë aneks marrëveshjen që ka të bëjë me vazhdimin e afatit të ndërtimit të autostradës Kërçovë-Ohër. Mendoj se jemi në fazë përfundimtare dhe pres që këto ditë të bëjmë marrëveshje përfundimtare, që përmes propozim ligjit do të shkojë në miratim në Kuvend", deklaroi ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski, duke u përgjigjur në pyetjet e gazetarëve në shënimin e 50 viteve të Shoqatës së rrugëve, ndërkaq në të cilën fokusi ishte vënë në Korridorin 8. Ministri informoi se në kuadër të Korridorit 8 është paraparë edhe përfundimi i ndërtimit të drejtimit rrugor deri në Qafë Thanë, në kufi me Shqipërinë. në përpunim final dhe fillim të ndërtimit është edhe rruga Kërçovë-Gostivar dhe rruga e shpejtë prej Rankovcit deri në Kriva Pallankë dhe drejtimi rrugor prej Kriva Pallankës deri në vendkalimin kufitar Deve Bair me Bullgarinë. Drejtori i NP për rrugë shtetërore, Zoran Kitanov theksoi se sipas vlerësimeve do të nevojiten rreth 36 muaj për ndërtimin e përfunduar të autostradës Kërçovë-Ohër. Ai shtoi se për më së shumti tre deri katër vite do të përfundohet Korridori 8 në pjesën prej Kumanovës deri në vendkalimin kufitar drejt Bullgarisë. Informoi se në një pjesë, në fazë finale të këtij Korridori është projektimi edhe i pjesës nga Gostivari deri në Kërçovë dhe tani mbetet të fillojë projektimi për pjeësn tjetër nga Bukojçani deri në Gostivar.

AGJENCIA E FILMIT SHPALL FILMAT FITUES

"Shelgu" i Mançevskit, projekti më i shtrenjtë

Sa i takon filmave nga regjisorë shqiptarë, në kategorinë e koproduksioneve janë miratuar dy projekte "Rrugica" (Macja e zezë Produksion) me regjisore Blerta Basholli (Kosovë) dhe "Vera që nuk kthehet" (Arb Film) me regjisor Besnik Bisha (Shqipëri). Të dy këto projekte kanë fond më të vogël, përkatësisht me nga 3 milionë dhe 3.5 milionë denarë

Koha — Evis HALILI

Shkup, 29 janar - Nga gjithsej 73 projekte që konkurruan - Agjencia e Filmit do të mbështesë realizimin e 17 filmave në kategoritë e metrazhit të gjatë e të shkurtër, dokumentarë e të animuar. Bëhet fjalë për konkursin e vitit të kaluar, që pas anulimit - u organizua për herë të dytë me procedura të përshpejtuara në muajin nëntor. Sipas Ministrisë së Kulturës, këto produksione do të jenë një befasi pozitive për kinematografinë maqedonase, pasi përzgjedhja e fituesve është bërë sipas kritereve dhe cilësisë së projekteve të paraqitura si nga regjisorë të njohur, ashtu edhe debitantë. Projekti më i shtrenjtë në kategorinë e filmit me metrazh të gjatë është "Shelgu", i regjisorit Milço Mançevski (produksioni i Sektor Film) për të cilin është akorduar një shumë mbi 76 milionë denarë (1.2 milionë euro). Sa i takon filmave nga regjisorë shqiptarë, në kategorinë e kooproduksioneve janë miratuar dy projekte "Rrugica" (Macja e Zezë Produksion) me regjisore Blerta Basholli (Kosovë) dhe "Vera që nuk kthehet" (Arb Film) me regjisor Besnik Bisha (Shqipëri). Të dy këto projekte kanë fond më të vogël, përkatësisht me nga 3 milionë dhe 3.5 milionë denarë. Një tjetër film fitues është filmi dokumentar me metrazh të gjatë i Kastriot Abdylit "Skënderbeu në Shkup" (Dardania) me 2.5 milionë denarë, ndërsa në kategorinë e filmave me metrazh të shkurtër është fitues filmi "Bebja" (Kodra Produksion) nga regjisori Ben Apolloni, për të cilin janë ndarë një milion denarë. "Sipas vendimit të Këshillit drejtues, mbështetjen nga Agjencia e Filmit do të marrin tre filma me metrazh të gjatë, pesë kooproduksione, dy dokumentarë, pesë filma me metrazh të shkurtër, një dokumentar me metrazh të shkurtër dhe një film i animuar. Nga Agjencia sqarojnë se mes titujve fitues numërohen emra të dëshmuar regjisorësh dhe producentësh, por edhe debutues të cilët, sipas tyre, do të jenë surpriza pozitive për kinematografinë maqedonase, thuhet në njoftimin e Ministrisë së Kulturës. Si filma të tjerë fitues me metrazh të gjatë janë "M" (produksioni Fokus Pokus) me regji të Vardan Tozija me një buxhet prej 330 mijë euro, ndë rsa autorja debitonte Dina Duma për filmin "Motra" (produksion i Krug Film) ka marrë rreth 300 mijë euro.

TË RINOVOHEN LISTAT E LEKTURAVE SHKOLLORE

LEKTURA NGA SHEKULLI I KALUAR

Në Maqedoni nuk i gjen dy shkolla në të cilat nxënësit të kenë lexuar të njëjtat lektura apo të shërbehen me të njëjtat revista. Kjo, sipas mësimdhënësve të letërsisë, krijon diferenca jo vetëm në krijimin e kulturës letrare të nxënësve, por edhe të njohurive që ata konsumojnë

Koha — Laura PAPRANIKU

Shkup, 29 janar - Paralelisht teksteve të reja shkollore që paralajmërohen të bëhen gati për nxënësit në arsimin fillor, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) duhet të mendojë edhe për lekturat e reja shkollore, si dhe për materialet tjera plotësuese, që edhe ashtu nuk janë të rregulluara si duhet me Ligj. Për vite të tërë - shërbimet profesionale të MASH-it zvarritin zgjidhjen e këtyre dy çështjeve. Lekturat për nxënësit e klasave të para, siç dihet, kanë mbetur po ato të shekullit të kaluar, ndërsa revista dhe materiale të ngjashme jashtë programeve mësimore, depërtojë në forma të ndryshme. Në Maqedoni nuk i gjen dy shkolla në të cilat nxënësit të kenë lexuar të njëjtat lektura apo të shërbehen me të njëjtat revista. Kjo, sipas mësimdhënësve të letërsisë, krijon diferenca jo vetëm në krijimin e kulturës letrare të nxënësve, por edhe të njohurive që ata konsumojnë. "Problemi vjen në shprehje sidomos gjatë organizimit të garave dhe kuizeve që organizohen mes shkollave. Ne, arsimtarët, gjatë përpilimit të pyetjeve, e kemi vërtetë të rëndë të caktojmë pyetjet pasi është e pamundur të bëhen dy-tre shkolla bashkë, ku gjatë të njëjti vit shkollor, të jenë punuar të njëjtat lektura", thotë Rajmonda Asani, arsimtare e gjuhës dhe letërsisë në shkollën fillore "Panajot Ginovski" në Shkup. Për këtë arsye, nëpër kuizet e diturisë që organizojmë me nxënësit e shkollave në nivel të Shkupit dhe më gjerë, detyrohemi të shmangim këtë dimension të njohurive të nxënësve edhe pse aq shumë i rëndësishëm për ndërtimin e kulturës letrare të nxënësve. "Letërsia nuk është vetëm mësimi përmendësh i datave dhe vendeve ku kanë lindur shkrimtarët, mbajtjes mend të veprave që ata kanë shkruar apo edhe mësimi përmendësh i disa poezive. Lënda e letërsisë paralelisht njohurive bazike, duhet t'ju shërbejë shijeve estetike", shprehet Asani. Sipas saj, është vërtetuar se ndërtimi i personalitetit të njeriut - përveç kushteve të jetesës, trashëgimisë gjenetike dhe faktorëve të mjedisit socio-kulturor, është në varësi edhe të literaturës që konsumon. Prandaj, thotë Asani, është shumë e rëndësishme që fëmijëve tu ofrojmë letërsi me vlera të qëndrueshme. Shkolla tona, fatkeqësisht kanë dështuar ta bëjë këtë, shton më tej ajo duke theksuar faktin se "nuk mbahet mend nga cili vit shkollat nuk kanë rifreskuar listën e lekturave që duhet të lexojnë nxënësit".

Para tre vitesh, në Byronë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) u formua një Komision në nivel profesorësh dhe autorë të letërsisë për fëmijë me qëllim të shqyrtimit problematikës me lekturat shkollore. Mirëpo, nuk ka as momentalisht një raport i cili do vërtetonte zyrtarisht këtë gjendje apo t'i rekomandonte MASH-it, gjegjësisht BZHA-së, se cilat lektura duhet të qëndrojnë dhe me çfarë tituj të ri do të zëvendësoheshin lekturat e larguara nga listat. BZHA, në çdo fillim të ri të vitit, u dërgon shkollave listën me lekturave që duhet të punohen në lëndën e gjuhës dhe letërsisë. Nga shkollat ka pasur vazhdimisht ankesa se listat kanë mbetur ato të para 30 viteve dhe përveç kësaj - nuk kanë as numrin e nevojshëm të titujve që qëndrojnë në ato lista. Situata "status quo", sipas mësimdhënësve të lëndës, ndikon drejtpërdrejtë edhe në demotivimin e nxënësve për letërsinë në përgjithësi. Prej vitesh, nënvizon arsimtarja Asani është zbehur pasioni i nxënësve për të lexuar libra, të cilat nuk janë pjesë e mësimeve të detyrueshme. Për fat keq, në këtë kategori kanë hyrë edhe lekturat, megjithëse nuk do të duhej të ndodhte kështu. Mirëpo, neglizhenca e institucione kompetente për ta zgjidhur problemin me lekturat dhe revistat shkollore, ka bërë që të njëjta të kalojnë në margjinat e vëmendjes edhe nga vetë shkollat, arsimtarët, nxënësit dhe prindërit e tyre.

Publicitet

Në bazë të nenit 22, 23 dhe 24 nga Ligji për shfrytëzim dhe disponim me sendet në pronësi të shtetit dhe me sendet në pronësi të komunës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/15...190/16) dhe Vendimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nr. 44-6522/1, nr. 44-6557/1, nr. 44-6558/1, nr. 44-6558/1, nr. 44-6555/1 dhe nr. 44-6523/1, të gjitha vendimet nga data 15 nëntor të vitit 2017, Komisioni për disponim me sendet e tundshme dhe sendet e patundshme në pronësi të Republikës së Maqedonisë, shfrytëzues Ministria e Financave e publikon këtë:

SHPALLJE nr. 1/2018
për shitjen e parë të sendeve të patundshme në Shtip, Prilep, Koçan dhe Kërçovë me anë të ankandit publik elektronik

I. LËNDA E SHITJES PËRMES ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

1. Lëndë e shitjes janë sende të patundshme që gjenden në Shtip në PK. nr. 9415, rr. "Borko Talev " nr. 40, të regjistruara në Fletën e pronësisë nr. 5763 për KK Shtip 4 dhe atë:

- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1-1, hyrja 1, kati K 1, numër 2, qëllimi për pjesë të veçantë/të përbashkët nga ndërtesa HN, me sipërfaqe prej 15 m²,
- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1-1, hyrja 1, kati K 1, numër 2, qëllimi për pjesë të veçantë/të përbashkët nga ndërtesa BA, me sipërfaqe prej 51 m² dhe
- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1-1, hyrja 1, kati PR, numër 1, qëllimi për pjesë të veçantë/të përbashkët nga ndërtesa BA, me sipërfaqe prej 27 m², të përfshira në Vendimin për shitjen e sendeve të patundshme në Shtip të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nr. 44-6522/1 nga data 15 nëntor të vitit 2017.

1.1. Çmimi fillestar:
Çmimi fillestar i sendeve të patundshme nga pika 1, në ankandin publik elektronik është 2.329.119,00 denarë.

1.2. Garancia bankare:
Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 46.582,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar të sendeve të patundshme nga pika 1.

1.3. Data e mbajtjes së ankandit publik:
Ankandi publik për shitjen e sendeve të patundshme nga pika 1 do të realizohet në formë elektronike në datë 6,3 2018, me fillim në ora 11:00.

1.4. Në përputhje me shkresën e Komunës së Shtipit nr. 09-7234 të datës 07.09.2015 për PK nr. 9415, KK Shtip 4 sipas ekstraktit nga dokumentacioni planor urbanistik për pjesën nga "Rajoni jugor-1" është paraparë ndërtim, gjegjësisht banim individual.
Vlera e përgjithshme e sendeve të patundshme të vendosura në pikën 1 është 2.329.119,00 denarë.

2. Lëndë e shitjes janë sende të patundshme që gjenden në Prilep në PK nr. 9412, të regjistruara në Fletën e pronësisë nr. 1532 për KK Prilep edhe atë:

- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1-1, hyrja 1, kati K, numër 2, qëllimi për pjesë të veçantë/të përbashkët të ndërtesës BA, me sipërfaqe prej 147 m²,
- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1-1, hyrja 1, kati K 1, qëllimi për pjesë të veçantë/të përbashkët HN, me sipërfaqe prej 18 m²,
- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1-1, hyrja 1, kati PO, qëllimi për pjesë të veçantë/të përbashkët од nga ndërtesa P, me sipërfaqe prej 77 m²,
- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1-1, hyrja 1, kati PR, numër 1, qëllimi për pjesë të veçantë/të përbashkët nga ndërtesa BA, me sipërfaqe prej 147 m² dhe
- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1-1, hyrja 1, kati PR, qëllimi për pjesë të veçantë/të përbashkët nga ndërtesa KSH, me sipërfaqe 6 m²

2.1. Çmimi fillestar:
Çmimi fillestar për ankand publik elektronik të sendeve të patundshme nga pika 2 është 5.671.899,00 denarë,

2.2. Garancia bankare:
Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 113.438,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar e sendeve të patundshme nga pika 2,

2.3. Data e mbajtjes së ankandit publik:
Ankandi publik për shitjen e sendeve të patundshme nga pika 2 do të realizohet në formë elektrike në datë 6.3.2018, me fillim në ora 12:00.

2.4. Në përputhje me shkresën e Komunës së Prilepit nr. 09-1519/2 të datës 14.08.2017, për PK. nr. 9412 KK Prilep, sipas ekstraktit nga dokumentacioni planor urbanistik është paraparë ndërtim, gjegjësisht A-1- Banim në shtëpi familjare.
Vlera e përgjithshme e sendeve të patundshme të vendosura në pikën 2 është 5.671.899,00 denarë.

3. Lëndë e shitjes janë sende të patundshme që gjenden në Prilep në PK. nr. 19268 pjesa 6 në rr. „Dimçe J. Dabovski" të regjistruara në Fletën e pronësisë nr. 36585 për KK Prilep dhe atë:

- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1, hyrja 1, kati 1, numër 2, hapësira ndihmëse me sipërfaqe prej 19 m²,
- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1, hyrja 1, kati 1, numër 2, banesë me sipërfaqe prej 107 ᵐ2
,- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1, hyrja 1, kati PA, numër 3, hapësira ndihmëse me sipërfaqe prej 17 m²,
- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1, hyrja 1, kati PA, numër 3, hapësira ndihmëse me sipërfaqe prej 17 m²,
- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1, hyrja 1, kati PA, numër 3, banesë me sipërfaqe prej 83 m²,
- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1, hyrja 1, kati PO, hapësirë ndihmëse me sipërfaqe prej 19 m²,
- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1, hyrja 1, kati PR, numër 1, banesë me sipërfaqe prej 70 m²,
- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1, hyrja 1, kati përdhese, garazh me sipërfaqe prej 16 m² dhe
- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1, hyrja 1, kati KSH, korridore me shkallë me sipërfaqe prej 34 m²,

3.1. Çmimi fillestar:
Çmimi fillestar për ankand publik elektronik të sendeve të patundshme nga pika 3 është 4.942.705,00 denarë

3.2. Garancia bankare:
Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 98.854,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar e sendeve të patundshme nga pika 3,

3.3. Data e mbajtjes së ankandit publik:
Ankandi publik për shitje të sendeve të patundshme nga pika 3 do të realizohet në formë elektronike në datë 6.3.2018, me fillim në ora 13:00;

3.4. Në përputhje me shkresën e Komunës së Prilepit nr. 09-1694/4 të datës 26.09.2017, për PK. nr. 19268 KK Prilep, sipas ekstraktit nga dokumentacioni planor urbanistik është paraparë ndërtim, gjegjësisht banim në shtëpi banesore.
Vlera e përgjithshme e sendeve të patundshme të vendosura në pikën 3 është 4.942.705,00 denarë.

4. Lëndë e shitjes janë sende të patundshme që gjenden në Koçan në PK. nr. 13097 pjesa 1 në rr. „P. Toshev" të regjistruara në Fletën e pronësisë nr. 18587 për KK Koçan dhe atë:

- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1-1, hyrja 2, kati K1, banesë me sipërfaqe prej 83 m²,
- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1-1, hyrja 2, kati K2, hapësira ndihmëse me sipërfaqe prej 24 m²,
- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1-1, hyrja 2, kati K2, numër 2, banesë me sipërfaqe prej 142 m² dhe
- ndërtesa 1, dedikimi për ndërtesën A1-1, hyrja 3, kati përdhesë, hapësirë ndihmëse me sipërfaqe prej 82 m².

4.1. Çmimi fillestar:
Çmimi fillestar për ankand publik elektronik të sendeve të patundshme nga pika 4 është 4.568.689,00 denarë;

4.2. Garancia bankare:
Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 91.374,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar e sendeve të patundshme nga pika 4,

4.3. Data e mbajtjes së ankandit publik:
Ankandi publik për sendet e patundshme nga pika 4 do të realizohet në formë elektronike në datë 6.3.2018, me fillim në ora 14:00.

4.4. Në përputhje me shkresën e Komunës së Koçanit nr. 22-1781/2 të datës 09.09.2015, për PK. nr. 13097 KK Koçan, sipas ekstraktit nga dokumentacioni planor urbanistik është paraparë ndërtim, gjegjësisht banim individual.
Vlera e përgjithshme e sendeve të patundshme të vendosura në pikën 4 është 4.568.689,00 denarë.

5. Lëndë e shitjes janë sende të patundshme që gjenden në Kërçovë në PK. nr. 3088 v.th. „Grad", të regjistruara në Fletën e pronësisë nr. 9784 për KK Kërçovë 4 dhe atë:

- ndërtesa 1, ndërtesa banesore – banesë, hyrja 1, kati 03, numër 12, me sipërfaqe prej 58m² dhe
- ndërtesa 1, hapësira ndihmëse, hyrja 1, kati PO, numër 12, me sipërfaqe prej 4m² .

5.1. Çmimi fillestar:
Çmimi fillestar për ankand publik të sendeve të patundshme nga pika 5 është 907.728,00 denarë;

5.2. Garancia bankare:
Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 18.155,00 denarë, përkatësisht 2% nga vlera e vlerësuar e sendeve të patundshme nga pika 5,

5.3. Data e mbajtjes së ankandit publik:
Anakandi publik i sendeve të patundshme nga pika 5 do të realizohet në formë elektronike në datë 6.3.2018, me fillim në ora 15:00.

5.4. Në përputhje me shkresën e Komunës së Kërçovës nr. 10-2208/2 të datës 17.09.2015, për PK. nr. 3088 KK Kërçovë, sipas ekstraktit nga dokumentacioni planor urbanistik është paraparë ndërtim, gjegjësisht banim kolektiv. Pjesë të rrugëve, pjesa nga parkingu.
Vlera e përgjithshme e sendeve të patundshme të vendosura në pikën 5 është 907.728,00 denarë.

II. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE

Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik kanë të gjithë personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj që mund të fitojnë të drejtën e pronësisë të sendeve të patundshme në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligj.

III.DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK

Paraqitja për pjesëmarrje në ankandin publik bëhet në formë elektronike në këtë faqe të internetit: **e-aukcii.finance.gov.mk**
Parashtruesit duhet të dorëzojnë edhe këto dokumente:

- për pikën 1: garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendeve të patundshme në vlerë prej **46.582,00 denarë** me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

- për pikën 2: garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendeve të patundshme në vlerë prej **113.438,00** denarë me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

- për pikën 3: garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendeve të patundshme në vlerë prej **98.854,00** denarë me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

- për pikën 4: garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendeve të patundshme në vlerë prej **91.374,00** denarë me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë;

- për pikën 5: garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga vlera e vlerësuar e sendeve të patundshme në vlerë prej **18.155,00** denarë me afat vlefshmërie prej 60 ditëve nga dita e lëshimit të garancisë.

Si dhe:

a) për persona juridikë

- gjendja rrjedhëse nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht dokument adekuat i lëshuar nga organi përkatës nga shteti ku është regjistruar subjekti juridik jo më i vjtër se 6 muaj nga dita e lëshuar:

b) për personat fizikë

- kopje të letërnjoftimit valid apo të dokumentit të udhëtimit.

Garanci bankare në vlerë prej 46.582,00 denarë për sendet e patundshme nga pika 1, garanci bankare në vlerë prej 113.438,00 për sendet patundshme nga pika 2, garanci bankare në vlerë prej 98.854,00 denarë për sendet e patundshme nga pika 3, garanci bankare në vlerë 91.374,00 për sendet patundshme nga pika 4 dhe garanci bankare në vlerë prej 18.155,00 denarë për sendet e patundshme nga pika 5, deri në afatin e fundit për paraqitje dorëzohet edhe në formë të shkruar (në origjinal) deri te Komisioni për disponimin dhe shfrytëzimin me sendet e tundshme dhe të patundshme në pronësi të Republikës së Maqedonisë, shfrytëzues Ministria e Financave, në adresë rr. „Dame Gruev"nr.12, Shkup.

IV. AFATI PËR PARAQITJE

Për pjesëmarrje në ankandin publik, pjesëmarrësit duhet të paraqiten në formë elektronike deri në fund të ditës së 30-të, llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes në gazetat ditore dhe në faqen e internetit.

Komisioni në afat prej tre ditësh pas mbarimit të kohëzgjatjes së shpalljes, të gjithë parashtruesve të cilët në sistemin e ankandit publik elektronik janë paraqitur me të gjitha dokumentet e duhura, të cekura në pikën III të shpalljes, do u dorëzojë shifër (fjalëkalim) dhe emër shfrytëzuesi për pjesëmarrje në ankandin publik, ndërsa parashtruesve të cilët nuk kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë do u dërgojë njoftim me arsyetimin se nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.

V. MËNYRA DHE PROCEDURA PËR ZBATIMIN E ANKANDIT PUBLIK

1. Ankandi publik zbatohet në pajtim me dispozitat në nenin 26 nga Ligji për shfrytëzim dhe disponim me sendet në pronësi të shtetit dhe me sendet në pronësi të Komunës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/15...190/16).

2. Që ankandi publik të realizohet nevojitet të ketë së paku një pjesëmarrës.

3. Për ofrues më të volitshëm në ankandin publik konsiderohet pjesëmarrësi i cili ka ofruar çmimin e fundit, që paraqet vlerën më të lartë për shitje të sendeve të patundshme.

4. Ofruesi më i volitshëm është i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit me shkrim për zgjedhje, të paguajë mjete në pajtim me çmimin e arritur përfundimtar nga ankandi, në të kundërtën nuk do të vazhdohet me lidhjen e kontratës, ndërsa garancia bankare për seriozitet të ofertës do të aktivizohet dhe ofruesi në periudhë prej 1 viti nuk do mund të marrë pjesë në cilin do ankand publik të ardhshëm për sendet e patundshme.

5. Bartësi i të drejtës së pronësisë me ofruesin më të volitshëm, do të lidh kontratë për shitblerje në afat prej 15 ditë pune pas kryerjes së pagesës së çmimit të sendeve të patundshme.

Tatimin e qarkullimit dhe shpenzimet noteriale për solemnizim të marrëveshjes për shitblerje të sendeve të patundshme, do ti mbulojë blerësi - ofruesi më i volitshëm.

6. Pjesëmarrësit në ankand publik kanë të drejtë ankese vetëm në raport me procedurën e ankandit publik. Ankesa dorëzohet tek Komisioni në afat prej 3 ditësh nga dita e mbajtjes së ankandit publik. Komisioni vendos lidhur me ankesën me vendim në afat prej 5 ditësh nga pranimi i ankesës. Kundër vendimit të Komisionit mund të paraqitet ankesë tek Komisioni Shtetëror për Vendim-marrje në Procedurë Administrative dhe procedura e punës në shkallën e dytë.

VI. FAQJA E INTERNETIT KU DO TË MBAHET ANKANDI PUBLIK

Ankandi publik do të realizohet në mënyrë elektronike në këtë faqe të internetit:

e-aukcii.finance.gov.mk

Komisioni për disponim me sendet e tundshme dhe senet e patundshme në pronësi të Republikës së Maqedonisë shfrytëzues
Ministria e Financave

OH "KALLIRI I MIRËSISË" SHTRIN AKTIVITETET

BANESA SOCIALE PËR JETIMË DHE FAMILJE TË VARFRA

Rufat Sherifi, kryetar i "OH "Kalliri i Mirësisë", thotë se tashmë punimet e karabinasë kanë përfunduar dhe se objekti është legalizuar ndërsa këtë vit, do të përfundojnë 10 banesat - katër banesa për familje më status të vështirë social dhe gjashtë për jetimët

Koha Aida XHONI

Shkup, 29 janar - Objekti banesor social për familjet e bonjakëve dhe atyre të kategorisë së rënduar sociale që po e ndërton Organizata Humanitare "Kalliri i Mirësisë" në lagjen Vizbeg të Shkupit, pritet brenda këtij viti ti hap dyert. Rufat Sherifi, kryetar i kësaj shoqate, thotë se tashmë punimet e karabinasë kanë përfunduar dhe se objekti është legalizuar ndërsa këtë vit, do të përfundojnë 10 banesat - katër banesa për familje më status të vështirë social dhe gjashtë për jetimët. "Duke dashur që të jemi sa më ekonomik, edhe të kursejmë vetëm dhe të kursejmë donatorët tanë ne para disa viteve siguruam hapësirën apo tokën në Vizbeg dhe tani jemi në fazën kur kemi përfunduar punimet e karabinasë të themi dhe është bërë faza e legalizimit të objektit, gjatë vitit 2018 do të shkojmë në fazën e rregullimit dhe fasadimit si dhe rregullimit të brendshëm të banesës. Aty është paraparë të kemi banesa sociale - do të thotë gjashtë banesa për familje jetim dhe katër banesa për familje raste sociale. Shpresat janë pasi ne vitin 2017 bëmë goxha një punë të madhe besojmë së ne vitin 2018 të përfundon ndërtimi", tha ai. Në këtë objekt, siç tregon Sherifi, do të vendosen 10 familje, përzgjedhjen e të cilëve do ta bëjë një komision i posaçëm, ndërsa banimi në to do të jetë me kontratë dhe jo i përhershëm, sqaron Sherifi. Para përfundimit të objektit, do të formohet një komision i veçantë i cili do të vendos edhe kushtet dhe kriteret që duhet ti plotëson familja dhe ata që do të vlerësohen si më prioritare do të vendosen aty.

"Familjet do të kenë mundësi të banojnë aty në periudha të caktuara përderisa ata nuk arrijnë ti përmirësojnë kushtet e tyre dhe më pastaj - tua lëshojnë dikujt tjetër, nëse nuk përmirësohen kushtet ato do të vazhdojnë vite me radhë me kontratë do të jetë me disa standarde që mos të dëmtohen dhe të kenë kujdes për mirëmbajtjen e objekteve, por ata nuk do të jenë pronë, por do të jenë 5 vjet apo 10 vite aty me kontratë dhe do mbeten. Nëse fëmijët e tyre rriten, shkollohen, avancohen, krijojnë kushte materiale pa dyshim se duhet t'ia japin rastin dikujt tjetër që të vjen dhe të banon aty. Sepse në momentin kur ia jep pa dyshim se ai qetësohet dhe rehatohet dhe dëshira për të vazhduar dhe avancuar ngelet pak më e zbehur", tha Sherifi. Në mandatin e kaluar katër vjeçar, OH "Kalliri i Mirësisë", ka ndërtuar dhe dhuruar si ndërmjetësues mbi 16 shtëpi dhe banesa, vitin e kaluar (2017) është dhuruar një banesë për familjet e jetimëve për një grua që ka katër fëmijë dhe është ndërtuar po ashtu edhe një shtëpi në Gazi Babë po ashtu për një familje skamnorë. Ndryshe, në evidencën e Organizatës Humanitare "Kalliri i Mirësisë" numërohen mbi 2000 familje skamnore dhe 1200 jetimë.

Fundjava me 16 aksidente në Shkup

Shkup, 29 janar - Një person është lënduar rëndë në një prej gjithsej 16 aksidenteve të regjistruara gjatë fundjavës së kaluar në rajonin e SPB Shkup. Në katër aksidente lëndime më të lehta kanë marrë tetë persona, ndërsa në 10 është shkaktuar dëm material. Nga MPB informojnë se gjatë kësaj fundjave policia rrugore ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh kundërvajtjesh. Njëqind e dy shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se shpejtësia e lejuar, 12 shoferë kanë kaluar në udhëkryq në semafor të kuq, dy shoferë nuk kanë dhënë përparësi kalimi, 10 shoferë për rreshtim jo të drejtë dhe katër shoferë për tejkalim jo të drejtë. Nga komunikacioni janë përjashtuar shtatë shoferë të cilët e kanë drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit dhe 25 shoferë para se ta fitojnë të drejtën e drejtimit të automjetit motorik si dhe 11 automjete me afat të skaduar të patentë shoferit dhe tre automjete me probleme teknike. Është sanksionuar edhe një këmbësor i cili e ka kaluar rrugën jashtë vendkalimit për këmbësorë. Janë hasur edhe 153 automjete të cilat nuk janë parkuar sipas rregullave. Me ndihmën e automjetit special karrotreci, janë larguar 149 automjete.

Arrijnë 120 kërkesa për amnisti

Shkup, 29 janar - Gjykata Themelore Shkupi 1 njoftoi se deri të hë në n, në adresë të tyre kanë mbërritur rreth 120 kërkesa lidhur me Ligjin për Amnisti, për të cilët është konfirmuar se janë të kompletuara dhe menjëherë janë dërguar deri te këshillat penale. "Deri më sot në mesditë para Gjykatës Penale në sektorin për krim të organizuar dhe korrupsion janë dorëzuar 16 kërkesa të kompletuara, ndërsa në sektorin Penalisht të rritur kanë mbërritur më shumë se 100 kërkesa, por numri në çdo moment po ndryshon për shkak se pritet që në periudhën e ardhshme në gjykatë të mbërrijnë edhe kërkesa të tjera, ndërsa pasi që të konfirmohet se kërkesat e mbërritura janë të kompletuara, menjëherë sistemohen në punë para këshillave penale", citohet në kumtesën nga Gjykata Penale. Njëherit, thuhet se, duke pasur parasysh që këshillat kanë afat prej pesë ditësh për vendosje, pasi që të sillen vendime adekuate në kërkesat konkrete dhe do të dorëzohen deri te institucionet kompetente, opinioni do të informohet në mënyrë plotësuese për numrin konkret të vendimeve të marra dhe të dorëzuara. Ligji për amnisti, i cili u miratua më 15 janar, hyri në fuqi më 26 janar. Deri te Gjykata pritet të mbërrijnë rreth 1.500 kërkesa për amnisti, prej të cilëve 500 për lirim të plotë të personave të dënuar, ndërsa 1.000 të tjerët për amnisti të pjesshme. Amnistia nuk është e paraparë për personat e dënuar për vrasje, për vepra penale kundër zgjedhjeve dhe votimit, për abuzim seksual, pedofili, ndërmjetësim në kryerje të prostitucionit, pastaj për vepra penale kundër shtetit, për bashkëpunim kriminal, si dhe për veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare.

Kryetari i BFI-së ngushëllon familjen Zylbehari

Tetovë, 29 janar - Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë, Reis Ul Ulema Sulejman Efendi Rexhepi i shoqëruar nga shumica e përfaqësuesve të institucioneve relevante të Bashkësisë Fetare Islame, Myftive të qyteteve të ndryshme, dekanit të fakultetit të shkencave Islame në Shkup, drejtorit të Medresesë Isa Beu dhe përfaqësuesve të tjerë kanë qëndruar dje për vizitë në familjen Zylbehari për të shprehur ngushëllime, për tu solidarizuar dhe për të ndarë dhembjen me këtë familje pas asaj tragjedie që ndodhi ditë më parë kur kjo familje si pasojë e një zjarrit humbi pesë anëtarë të saj. Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis Ul Ulema Sulejman Efendi Rexhepi me këtë rast nënvizoi se Bashkësia Fetare Islame pas organizimit të ceremonisë së varrimit nëpërmjet Myftisë së Tetovë për pesë anëtarët tanimë të ndjerë të familjes së Zylbehari, ndarjes së një shumë simbolike për të mbuluar disa nga shpenzimet, ka paraparë edhe organizimin e Mevludit, dhe premtoi se gjithmonë do të mbështesë këtë familje për të vazhduar jetën përpara. *(U.H)*

NDOTJA E AJRIT MBI TË LEJUARËN

S'KA KUSH E NDALË AJRIN E NDOTUR

Koha Fisnik PASHOLLI

Prej mbrëmë në Karposh koncentrimi maksimal ka arritur 213 mikrogramë, Gazi Baba 326, Qendra 348, te Rektorati 376 dhe në Lisiçe 527 mikrogramë

Shkup, 29 janar - Banorët e Shkupit disa ditë me radhë thithin ajër të ndotur. Koncentrimet e grimcave PM10 sipas matjeve të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, të shtunën kanë arritur maksimumin prej 426 mikrogramë në Lisiçe, dje 596, gjithashtu në Lisiçe dhe gjatë natës deri në mëngjes koncentrim më i lartë prej 527 mikrogramë është matur sërish në Lisiçe. Edhe në vendet e tjera të matjes janë matur koncentrime të larta kështu që në Qendër të shtunën janë matur 207 mikrogramë maksimal, Gazi Babë 242, Karposh 307, Lisiçe 426 dhe te Rektorati 402 mikrogramë. Gjatë ditës së djeshme, maksimalet kanë qenë në Qendër 230 mikrogramë, 361 në Gazi Babë, 295 në Karposh, 596 në Lisiçe dhe 532 te Rektorati. Prej mbrëmë në Karposh koncentrimi maksimal ka arritur 213 mikrogramë, Gazi Baba 326, Qendra 348, te Rektorati 376 dhe në Lisiçe 527 mikrogramë. Në rast se koncentrimet e mesditës janë mbi 100 mikrogramë rekomandohet të shfrytëzohet transporti publik, automjetet të mos shfrytëzohen pa nevojë të madhe, më shumë persona të voziten me një automjet në të njëjtën kohë, të mos përdoret për ngrohje të hapësirave vaji i mbetur, mbeturina me llak apo të ngjyrosura nga druri dhe mobilie, polisterol, PET, ambalazh, copa gome apo çfarëdo materiali sintetik, si dhe në mënyrë të drejtë të shfrytëzohen furrat për dru. Fëmijëve, personave në moshë, të sëmurëve kronik nga mushkrit apo sëmundjet e zemrës, por edhe për personat të cilët punojnë në sipërfaqe të hapura në zonat e ndotura të qytetit u rekomandohet lëvizje e kufizuar dhe aktivitete në sipërfaqe të hapur. Masat urgjente që Qeveria i miratoi para më shumë se një muaji hyjnë në fuqi në rast se dy dytë me radhë në dy stacione matëse do të maten koncentrime prej mbi 200 mikrogramësh. Në mesin e atyre masave janë rekomandimet që të lirohen nga detyrimet e punës gratë shtatzëna, personat më të moshuar se 60 vjet, personat me astmë kronike, personat me infarkt të pësuar ose tronditje në tru, pa dallim të moshës. Të riorganizohet orari i punës për ata të cilët punojnë në hapësira të hapura prej orës 11 deri në orën 17, ndalesë për mbajtjen e ndeshjeve sportive dhe manifestimeve të tjera në ambient të hapur dhe sigurim i kushteve për aktivitet të rritur të ndihmës së shpejtë, vizitë në shtëpi dhe shërbimit të patronazhit. Komunat janë të obliguara ta ulin çmimin e biletës në transportin urban në periudhën e kushteve të pavolitshme klimatike që do të ishte nxitje e qytetarëve për shfrytëzimin e transportit publik, të mundësojnë transport publik falas, të rritet frekuentimi i autobusëve të NTP, çdo ditë të pastrohen rrugët dhe hapësirat për këmbësorë, t'i rrisin kontrollet inspektuese në vend ndërtimet, të trajtuesve me mbeturinat e vajit dhe serviseve që punojnë me ndërrimin e vajit, auto-shkollat t'i realizojnë trajnimet në periudhën prej orës 9:30 e deri në 14:30 dhe pas orës 18, si dhe furnizimi i mallit në zona të ndaluara të kryhet deri në orën 7:30. Kompanive ndërtimore u rekomandohet të përdorin ujë për uljen e pluhurit, gjegjësisht spërkatje, larje e gomave të kamionëve para vendeve të ndërtimit, ndërsa makinat ndërtimore t'i dërgojnë deri te vendi i ndërtimit deri në orën 7:30 në mëngjes. Inspektorati Shtetëror për Mjedis Jetësor të kryejë kufizim të emisioneve nga lejet e integruara B dhe kapacitetet më të vogla ekonomike dhe të bëjnë kontroll më të shpeshtë të instalimeve të cilat posedojnë leje të integruar A. Pastaj të zbatojë matje të emisioneve të substancave të ndotjes në ajër me laboratori të akredituar me qëllim që të konfirmohet nëse zbatohen kushtet e përcaktuara në lejen lidhur me emisionet në ajër, ndërsa të njëjtat do të marrin rekomandim ta ulin prodhimin deri në 50 për qind.

Rritet delikuenca e të miturve në Pollog

Tetovë, 29 janar - Sa i përket dukurisë së delikuencës së të miturve, vitin e kaluar në rajonin që mbulon Sektori për Punë të brendshme në Tetovë janë evidentuar gjithsej 65 vepra penale, ose 14 më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë kohore të vitit paraprak, kur kishte 44 akuza penale. Në këto vepra, tregojnë analizat e Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë, gjithsej janë të përfshirë 90 të mitur, me të cilëve numri më i madh prej tyre janë të mitur të cilët kanë përsëritur po të njëjtën vepër penale, të cilët disa herë kanë marrë pjesë në kryerje të vjedhjeve, jo rrallë herë janë angazhuar dhe udhëzuar nga persona më të rritur, e të cilët kanë qenë frymëzuesit dhe kanë ndihmuar ato në kryerjen e këtyre veprave penale. Më tej, nga policia njoftojnë se kryesisht bëhet fjalë për vjedhje nëpër dyqane të ndryshme, marrje të automjeteve të ndryshme, më pas vepra penale që ndërlidhen me sigurinë në komunikacion, dhunë, pjesëmarrje në rrahje dhe së fundmi - keqpërdorim të të dhënave personale përmes rrjeteve sociale, veçanërisht në Facebook dhe Instagram. "Këto keqpërdorime jo vetëm vitin e kaluar, por edhe këtë vit janë dukuri të zakonshme në rajonin e Pollogut, nga të miturit, por edhe nga persona më të rritur, të cilët pas vendosjes së kontaktit shpesh me femra, në mënyra nga më të ndryshmet i kërcënojnë ato pasi paraprakisht sigurojnë fotografi kontroverse të tyre ose video-materiale të ndryshme. Për shkak të kësaj, deri tek të miturit apelohet që jashtëzakonisht të kenë kujdes së me kënd kontaktojnë dhe ndajnë të dhëna personale, fotografi dhe të ngjashme. Për shkak se shpejtë dhe shumë lehtë mund të keqpërdoren, të kërcënohen dhe kompromethohen, ndonjëherë pa kurrfarë arsye dhe shkaku", thonë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë. *(U.H)*

ME QË LLIM RRITJEN E EFIKASITETIT

Doracak për punë efikase të komunave

Shkup, 29 janar - Puna më efikase e njësive të vetëqeverisjes lokale, menaxhimi më i mirë, planifikimi dhe shfrytëzimi i resurseve publike, është qëllimi i Doracakut, i dedikuar për kryetarë komunash dhe anëtarë të këshillave në komunat në Maqedoni, që të hënën e promovoi Qendra për analiza ekonomike (QAE) nga Shkupi. Përmban 12 kapituj dhe ka për qëllim t'i rrisë kapacitetet e strukturave të reja udhëheqëse nëpër komuna për zbatim efikas të kompetencave dhe rritje të vetëdijes së qytetarëve për monitorim të punës së komunave. Autorë janë Marjan Nikollov, Mirosllav Trajanovski dhe Ana Maria Petrovska. Kryetari i QAE-së dhe njëri nga autorët e Doracakut, Marjan Nikollov, deklaroi se në treg ekzistojnë disa doracakë. "Nevojitet doracak i cili më shumë do të detajojë aspekte të posaçme të cilat janë të lidhura me punën horizontale të njësive të vetëqeverisjes lokale për efikasitetin e tyre më të madh për menaxhim, planifikim, shfrytëzim të resurseve publike, d.m.th. të parave të obliguesve tatimorë. Ato janë aspektet të cilat kanë të bëjnë me furnizimet publike. menaxhimin me pronën komunale, transparencën, ndërkaq më ngushtë transparencën fiskale dhe transparencën e buxheteve", tha Nikollov. Ministri i Vetëqeverisjes Lokale, Suhejl Fazliu theksoi se kryetari i komunës dhe Këshilli janë dy organe të cilat ndaras janë përgjegjës për funksionimin e komunës dhe për sigurimin e shërbimeve të qytetarëve. Ai potencoi se qytetarët kanë të drejtë të një qasje përafërsisht të barabartë drejt shërbimeve, pa dallim nëse jetojnë në mjedise urbane apo rurale. Bëri thirrje për bashkëpunim mes sektorit qytetar, komunitetit afarist dhe opinionit të ekspertëve. Recenzentë të Doracakut, profesorët universitarë Jove Kekenovski dhe Gordana Siljanovska-Davkova potencuan

se bëhet fjalë për libër të cilin kryetarët e komunave dhe këshilltarët duhet ta kenë afër vetes në mënyrë që të mund t'i referohen atij dhe ta zbatojnë. Doracaku është dygjuhësor, në gjuhën shqipe dhe maqedonase, dhe këtë javë do t'u distribuohet kryetarëve të komunave dhe kryetarëve të Këshillave. Financiarisht është mbështetur nga Civika dhe Mobilitas. (Z.V)

19 vjeç veteran

Nga Agron DEMI

G.H. nuk e kishte festuar ende ditëlindjen e dytë kur u nënshkrua Marrëveshja e Kumanovës, e cila i dha fund luftës në Kosovë. Njëzet e një muajt e parë të jetës së tij ai i kaloi në gjendje lufte, me gjasa shumë të vogla për të mbijetuar ai dhe familja e tij. Por ditëlindjen e dytë ai do ta priste në paqe. Pasi që forcat serbe ishin larguar nga Kosova, për sigurinë e qytetarëve do të kujdeseshin ushtarët e KFOR-it dhe së shpejti do të fillonte vetëqeverisja nga institucionet vendore. G.H. së bashku me gjithë moshatarët e tij do të mundë të ndërtonin jetën e tyre në një vend të lirë, i cili u garanton liri ekonomike dhe politike.

Por në shtator të vitit 2017, ditëlindjen e tij të 20-të, G.H. do ta festonte duke paguar nga pensioni i veteranit. Si 19-vjeçar ai është përfshirë në listën e pensioneve të veteranëve të luftës. G.H. nuk është i vetmi, i cili që në moshën 19-vjeçare të ardhmen e tij e ndërton mbi pensionin e veteranit. Janë së paku edhe tre persona të tjerë të lindur më 1997, të cilët marrin pension veterani, kurse në listën e veteranëve përfitues janë gjithsej 21 persona të lindur pas vitit 1991, të cilët në kohën e luftës ishin mes moshës dy e tetë vjeç. Kur një person i moshës 19-vjeçare të ardhmen e tij e bazon në pension veterani, kjo është një shenjë që shumë gjëra kanë shkuar keq me shtetndërtimin në Kosovë, dhe ky vend nuk ka arritur t'i përmbushë ato ëndrrat për liri ekonomike dhe politike, së paku jo për të gjithë qytetarët. Së pari, një sistem politik i cili krijon pensione për 19-vjeçarët është një sistem i dështuar ekonomikisht. Së dyti, një sistem i cili i jep status të veteranit dikujt që ka qenë vetëm 21 muajsh në kohën e përfundimit të luftës është sistem i ndërtuar në mashtrim e korrupsion. Së treti, një sistem politik i cili krijon favore financiare dhe politike për një kategori të caktuar të qytetarëve është sistem politik i padrejtë.

Së bashku me G.H. janë edhe së paku 36.000 përfitues të tjerë të pensionit të veteranit, të cilët kanë lindur mes viteve 1924 dhe 1997. Komisioni për verifikimin e statusit të veteranëve është themeluar në muajin prill të vitit 2010. Po bëhen gati nëntë vjet që procesi i verifikimit të veteranëve po vazhdon. Gjatë këtyre viteve, vetëm për punën e Sekretarisë së Komisionit për verifikim të veteranëve janë shpenzuar afro 400 mijë euro. Nga nëntori 2016 deri në nëntor 2017 i është vazhduar katër herë mandati Komisionit për verifikim, secilën herë duke dhënë ultimatum që procesi të përfundojë sa më parë. Dy herë është aprovuar lista e papërfunduar e veteranëve, një herë në Qeverinë Mustafa dhe një herë në Qeverinë Haradinaj. Por listës përfundimtare nuk po i duket fundi. Deri në fund të vitit 2017, rreth 70 mijë persona kanë aplikuar për të marrë statusin e veteranit. Sipas të dhënave të Fondit Monetar Ndërkombëtar, mbi 46 mijë aplikues kanë marrë certifikatat e veteranit, gjersa rreth 36 mijë prej tyre vetëm se marrin pensione. Numri prej 36 mijë personash që marrin pension të veteranit është për 11 mijë veta më shumë sesa numri i ish-ushtarëve të çarmatosur pas luftës, më 1999, sipas të dhënave të NATO-s dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM). Buxheti i planifikuar për pensionet e veteranëve prej 25 milionë eurosh më 2016, u trefishua deri në fund të vitit 2017. Duke parë se buxheti për pensionet e veteranëve po del nga kontrolli, FMN-ja bëri presion tek Qeveria dhe Kuvendi që të amendamentohet Ligji për veteranët, duke vënë një tavan prej 0.7% të GDP-së për buxhetin e pensioneve. Por në ndryshimet që u bënë në ligj u përfshi edhe një fjali, sipas së cilës këto ndryshime do të hyjnë në fuqi pas aprovimit të listës përfundimtare të veteranëve. Për këtë arsye, ndryshimet në ligj nuk kanë hyrë në fuqi ende, ngase Komisioni nuk është i interesuar që ta përmbyllë procesin. Në fund të 2017-s, buxheti i ndarë për veteranët tejkaloi 1% të GDP.

Përveçqë numri i përfituesve të pensionit të veteranit është shumëfish më i lartë sesa numri real i ushtarëve që kanë qenë pjesë e UÇK-së deri më 1999, një numër i madh i përfituesve kanë gjendje të mirë sociale dhe ekonomike. Në anën tjetër, për të marrë pensionin e veteranit shumë përfitues kanë lënë punën ose punojnë në ekonomi joformale, kësisoj duke ndikuar në rritjen e informalitetit. Nëse marrim për bazë numrin aktual të përfituesve të pensionit të veteranit, moshën e veteranëve përfitues, shumën mujore të pensionet, si dhe inflacionin në vitet në vazhdim, del se në 30 vjetët e ardhshëm nga buxheti i Kosovës do të shpenzohen deri 2.5 miliardë euro vetëm për pensionet e veteranëve. Se listat janë manipuluar, këtë e pranojnë edhe anëtarët e Komisionit për verifikimin e veteranëve dhe liderët institucionalë. Në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës, më 25 tetor 2017, Kadri Veseli deklaroi se në listat e veteranëve janë përfshirë me qindra persona që nuk kanë qenë në luftë, dhe kjo, sipas tij, është bërë për arsye politike. Ish-kryeministri Mustafa, ditën që Qeveria nën drejtimin e tij aprovoi listën e papërfunduar të veteranëve, i bëri kërkesë publike Prokurorisë që të hetojë listat. Por ka edhe politikanë të cilët fryrjen e listave nuk e shohin si problem. Në të njëjtën seancë plenare të Kuvendit, deputetja Ganimete Musliu (PDK) deklaroi se edhe nëse dalin 100 mijë veteranë ata duhet t'i marrin pensionet, për të vazhduar se "janë apo nuk janë listat e fryra, ata do t'i marrin pagat, sepse sikur të mos ishin ata veteranë, dikush tjetër do të fliste ndryshe në këtë Kuvend". Në një intervistë të muajit dhjetor të vitit të kaluar, kryeministri Haradinaj nuk befasohet me numrin e veteranëve, duke deklaruar se 30 mijë veteranë janë vetëm në rajonin e Dukagjinit. Sipas deklarimeve publike të Prokurorisë, procesi i verifikimit të veteranëve është duke u hetuar, dhe

Kur një person i moshës 19-vjeçare të ardhmen e tij e bazon në pension veterani, kjo është një shenjë që shumë gjëra kanë shkuar keq me shtetndërtimin në Kosovë

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha
Epërditshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 29 janar | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

këtë proces po e mbështesin më së shumti ata veteranë të cilët ishin vërtet pjesë e luftës çlirimtare. Aplikimi i skemës së pensioneve për veteranët ka qenë vendim i gabuar që nga fillimi. Të gjithë veteranët e luftës së UÇK-së do të duhej të merrnin mirënjohje jofinanciare, kurse ata veteranë dhe familjet e tyre të cilët përballen me gjendje të rënduar ekonomike, do të duhej të përfshiheshin në kuadër të asistencës sociale. Në anën tjetër, shuma mujore e asistencës sociale do të duhej të shtohej dukshëm, ngase aktualisht nuk e mbulon as kufirin e varfërisë dhe nuk pritet ta mbulojë as me rritjen prej 20% që nga janari i këtij viti. Aktualisht, 77% e familjeve që marrin asistencë sociale nuk e kalojnë kufirin e varfërisë. Nëse buxheti që ndahet për pensionet e veteranëve do të orientohej nga asistenca sociale, sot asnjë familje, e cila i plotëson kriteret për asistencë sociale, nuk do të mbetej në varfëri. Në gjendjen aktuale, procesi i verifikimit dhe lëshimi i certifikatave për mbi 36 mijë veteranë të UÇK-së, më shumë sesa përpjekje për të njohur statusin e luftëtarëve, është shndërruar në proces për ndikim politik dhe zgjerim të bazës klienteliste. Nëse, sipas Çajupit, tragjikomedia e shqiptarëve të fillimshekullit të kaluar ishin martesat e 14-vjeçarëve, tragjikomedia e këtij fillimshekulli është pensionimi i 19-vjeçarëve.

NË SHIRITIN E KOHËS

Gjuha, shkenca dhe shqiptarët...

Nga
Faik KONICA

GJUHA. Fjalët turqisht që shpallmë tjatrën herë janë më të përdorurat. Po ka, mjerisht, edhe shumë të tjera. Japim këtu një tjatër mbledhje:

Mos thoni mutlhak (po thoni: do-e-mos, pa ndyshim); mos thoni siklet (por thoni shtrëngicë); alhaversen (dhëntë Perëndia, dashtë Zoti, etj.); sabah (mëngjes); aksham (mbrëma); karpus (shalqinë); bereqaversen (Perëndia të dhëntë); inshallah (Zoti e bëftë); ghye (turp, mundim); dava (gjyq); hajvan (kafshë); terbije (shtrim); çurek (bukë); hala (ende, edhe); tudshar, reshper (tregetar, kumerkar, shitetar); saraf (kembimtar); bardak (kupe); çunqe, madam, (me qenë që, me gjithë që); dizge (rreze); malli (gjë); mulq (tokë); tavan (plafe); shishe (bucelë); hasha (mohim); bën hasha (mohon); dxhenet (parajsë) dxhenhem (ferr, skëterrë); sokak (rrugë); mejdan (shesh); bën vaki (godit); vakt (kohë); selam (të fala); direk (shtyllë); taban (tra);



surrat (fytyrë); made, mesele (çështje); hava (klimë); teptil (përkthim); qefil (dorëzënës); ejvalha (falem nderës): pace (këmbë kafshësh).

KOMBËSIA. Është e thënë prej shumëve, edhe do të thohet se një nga shkaket më të rënda që ndajnë edhe lëshojnë prapa Shqipëtarët është ndryshimi i feve. Autori i librit gegënisht 'T'ndodhunat e Shqypnis' rrëfen, në një copë që do t'a nxjerrim herën e ardhur, qysh qindëra mij Shqipëtarë u-bënë muhamedanë në kohë të ardhjes s'Turqve në dhe tonë. Në Malësi të Dibrës puna ka ngjarë ndryshe, si e kini për të parë e si na e ka rrëfyer një trimosh dibran. Osmanllitë, kur hyjtin në Dibër, thirrnë të parët e Malësorëve e u bëjtin një pyetje: Kur ka, thanë, një baba, dy djelm, cilin do më shumë, më të vogëlin a më të madhin? Më të voglin, u - përgjigjnë te padjallëzuarit Malësorë.

Mirë, thanë përsëri Osmanllitë, po me që Perëndia e ka Muhamedin djalë më të vogël, e do më shumë se Krishtin. U muntmë, u-përgjigjnë aherë budallenjtë tanë, e po si berra u-bënë muhamedanë.

SHKENCA. Këndojmë te e përkohëshmia shkenctare "Cosmos" se ca kafshë nukë pinë as një pikë ujë në tërë jetën e tyre: Këto kafshë janë lamat e Patagonise edhe gazelet e Lindesit. Në "kopshte kafshëtore" të Londonit, ku kanë mbledhur nga gjithë shpesat e egërsirat e dheut, një papagall rrojti 52 vjet pa pirë një pikëzë ujë. Shumë shkencëtarë besojnë se ljepurat nukë pinë tjatër gjë përvec vesen e paktë që ndodhet mbi barërat. Një Amerikan, i quajtur John Bargeman shkruan se gjeti në malet e Meksikut-Ri qen t'egër e të tmerruar.

Këta qen janë ngjyrë hiri, me leshëra të gjata, peshojnë 50 kilo (40 okë) edhe kur derdhen mbi një kope, çajnë kafshët shtëpiake me qindra.

Feja e shqiptarit nuk është shqiptaria!

Nga
Artan FUGA

Vjersha e Vaso Pashës O moj Shqypni..., shkruar në dekadat e fundit të shekullit 19-të, është ndofta nga ato që është përmendur më shumë. Jo thjesht në rrafsh letrar e poetik, por brenda platformave politike dhe ligjërimeve sociale. Gati si themeli i ndjenjës kombëtare shqiptare dhe pastaj jo vetëm si vendosje e kësaj ndjenje mbi atë fetare, por edhe si kundërvënie e kombësisë dhe besimit, ose si ngjizje e kombësisë pa besimin. Çfarë ka sipas meje në këtë varg kaq problematik që e quajnë madje edhe një poezi ku është hedhur një nga paradigmat që ja kanë veshur themelive të albanologjisë?

E para, ka një nëntekst të përzierjes të konceptit të përçarjes fetare me institucionet e besimit fetar, që pastaj e kanë ngatërruar edhe me vetë besimin. Në vargjet e veta poeti, ngrihet kundër përçarjes kombëtare dhe kjo është merita e tij e pakundërshtueshme. Po, një rrezik i tillë ka ekzistuar për çdo komb. Përçarja institucionale fetare kundër solidaritetit dhe identitetit kombëtar. Nuk jemi ne të vetmit. Por, jo çdo pluralitet besimesh fetare çon në përçarje. Nuk ka përse dallimet fetare njehsohen me përçarjen fetare. Feja nuk ka në brendësi të vetën përçarjen por dashurinë për njeriun. Tjetër se si e kanë përdorur. Poeti sa ngrihet kundër përdorimit antikombëtar të besimit, por jo kundër vetë besimit sikurse na e kanë mësuar dhe vazhdojnë ta dërdëllisin.

E dyta, tjetër është feja dhe tjetër janë institucionet fetare, kishat, xhamitë. Midis besimit dhe institucioneve apo klerikëve ka dallime dhe nuk mund të barazohen me njëra tjetrën. Pashko Vasa nuk i barazon ato aspak. Ai kritikon klerikë të kohës dhe institucione fetare në kontekstin e dhënë, por nuk ja vendos fajin e përçarjes fesë si besim.

E treta, në ato vargje ka një metaforë, pra kur thuhet se mbi dallimet fetare lulëzon ndjenja e kombësisë, dhe thuhet se feja e shqiptarit është shqiptaria, kjo duhet marrë në kuptim metaforik. Sepse barazohen dy gjëra të ndryshme me njëra-tjetrën. Se ashtu mund të thuhet edhe se politika e shqiptarit është shqiptaria, se krahinarizmi i shqiptarit është shqiptaria, se shkenca e shqiptarit është shqiptaria, se familja e shqiptarit është shqiptaria., etj. Por, metafora nuk duhet marrë dhe nuk merret asnjëherë si koncept shkencor.

Së katërti, ka edhe një tautologji kur thuhet se feja e shqiptarit është shqiptaria. Meqenëse flitet për shqiptar kuptohet që shqiptari barazohet me shqiptarinë dhe shqiptaria me shqiptarin. Nuk ka vend për fe as për asgjë tjetër. Si kur thuhet vëllai dhe vëllazërimi. Thelbi i vëllait është vëllazërimi. Nuk ka gjë tjetër. Thelbi i pedagogut është pedagogjia. Pra, sigurisht kur barazohen logjikisht konceptet patjetër thelbi logjik i shqiptarit është shqiptaria, i grekut greqizimi, etj.

Së pesti, kemi edhe një utopi sepse kjo parrullë nuk mund të realizohej ashtu sikurse u interpretua gabim. Pra, sikur shqiptari do të kishte fe shqiptarinë, ndjenjën kombëtare dhe do ta braktiste fenë. Jo shqiptari nuk e braktisi fenë as dallimet fetare nuk e bënë të harronte patriotizmin.

Së gjashti, poeti nuk e braktis Zotin, as fenë në këtë vjershë, madje në vargun e fundit e përmend duke e vendosur në thelb të përpjekjeve për shqiptari. Si do të dalim para Zotit? – thërret pak a shumë. Kuptohet se për të tjetër është përçarja fetare, tjetër janë institucionet fetare, tjetër janë klerikë të ndryshëm, tjetër është feja, tjetër është Zoti.

* * *

Pashko Vasa është keqinterpretuar. Me qëllim. Për ideologji, për politikë. Madje shqiptarëve, është sa përçarja fetare aq edhe likuidimi i fesë që ia ka dëmtuar ndjenjën e patriotizmit. Kombi mbi fenë, a thua se janë dy koncepte ekskluzivisht opozitare a thua se kemi katet e një ndërtese vertikale, a thua se ndjenja e pastër fetare nuk ka ushqyer patriotizmin shqiptar! As kombi si zëvendësim i fesë që është edhe më keq. Sepse Pashko Vasa nuk i ka shprehur këto as figurativisht as në kuptimin e parë të leximit të poezisë së tij. Zëvendësimi i fesë me kombin, ngritja e kombësisë në fe, dëmton edhe kombin edhe fenë autentike. Ngrihet kundër monoteizmit për idhujtaria dhe idole politike të konsideruara si Perëndi. E lë shqiptarin pa mbrojtje metafizike, i heq mistikën metafizike kombësisë shqiptare. Pasi e keqinterpretuan Pashko Vasën dhe barazuan ndjenjën fetare me kombësinë, e ngritën këtë ideologjikisht si bazën e identitetit shqiptar nën ideologjinë totalitare. Po sot përse nuk guxon kush ta vendosi Pashko Vasën në vend? Sepse stalinizmi vazhdon ta mbajë albanologjinë në disa kështjella të konservuar, pastaj punën tjetër e bën inercia mendore, lodhja intelektuale, përtacia e gjykimit, plakja e arsyetimit, e në fund budallallepsja sociale.

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

NDRYSHE ME JASHAR SEJDIU

TË JETOSH ME KËNGËN AUTOKTONE SHQIPE

"Kemi kënduar dhe vazhdojmë të këndojmë këngë patriotike, këngë për kurbetin dhe këngë për dashurinë. Këto këngë u kënduan edhe nga të tjerët. Diku janë pesëqind këngë, ku përveç që kemi mbledh këngët, kemi shkruar edhe tekste, ku më vonë janë bërë këngët tona. Tashmë kemi dymbëdhjetë albume, ku në të gjitha ato albume janë këngë autoktone të trevave tona..."

Koha — Delvina KËRLUKU

Jashar Sejdiu ka lindur në fshatin Bozovcë, në vitin 1955. Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, pastaj e ndërpreu shkollim për dy vite. Si u hap shkollë në fshatin Veshallë e rinis shkollimin. Por dy vitet e fundit të tetëvjeçares vazhdon në qytet, në Tetovë, ku edhe kreu gjimnazi. Shkollën e lartë për financa e kreu në Pejë, dy vite student i rregullt, por gjendja ekonomike e dobët e detyron të ndjek studimet me korrespodencë. Pas përfundimit të shkollimit mbetet pa punë, ku edhe sot diploma i rri në shtëpi. Detyrohet të nxjerr bukën e gojës, me dhuntinë që ia ka dhënë Zoti, këngën, ku mëson t'i bie vetë çiftelisë. Bashkë me vëllain - Idajetin krijojnë grupin "Vëllezërit Jashar dhe Idajet Sejdiu". Vitet e 70'ta, ku edhe u hapën dyert ishte transmetimi i këngëve në Radio Shkupin. Jashari do ta ndërpres këngën, për gati një dekadë. Ai punësohet në Afganistan dhe në Irak. Më vonë kthehet në vendlindje dhe bashkë me dy vëllezërit do të punojnë në kultivimin e këngës së vjetër shqipe, të trevave tona. Me zërin dhe këngën e tyre arrijnë të fitojnë çmime në festivalin "Oda Dibrane", dhe në Gjirokastër, "Çmimin e karrierës". Aktivitetet e tyre do të transmetohen në radio si brenda vendit dhe jashtë, në Vjenë, vendet Skandinave, etj. Jashari me vëllezërit kanë hapur një televizion, ku edhe kanë programin e tyre, për promovimin e vlerave të folklorit shqip. Jashar Sejdiu është i martuar, ka dy fëmijë dhe një nip, i cili ia ka trashëguar këngën.

KOHA: Muzika popullore shqiptare përbën një ndër pasuritë më të çmuara të vendit. Si lindi dashuria ndaj kësaj muzike?

SEJDIU: Jam rritur në një familje ku është kënduar kënga e mirëfilltë, e anës së malësisë, nga fshati Bozovcë, nga ku edhe vi unë. Një fshat i largët apo i fundit në Malësinë e Sharrit. Fshat ku formohet trekëndëshi Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Por, në familjen tonë gjithnjë është kënduar, nga hallat, tezet, kurse unë si i vogël i kam dëgjuar. Mirëpo, diç më tepër, në moshën shtatë vjeçare më ka tërhequr gjyshi që edhe këndonte. Kishte një zë aq të bukur sa që të gjithëve na linte në baltë. Ai ishte i shoqëruar me disa shokë nga katundi, ku edhe ishte në krye, ndërsa të tjerët e përcillnin, e mbanin iso-në. Por, e veçanta është se në anën tonë ka një lloj këndimi i ashtuquajtur "palë- palë". Ky lloj këndimi është kënduar edhe te femrat, por me raste edhe tek meshkujt. Femrat e kanë kënduar nëpër dasma, kur e marrin nusen edhe atë pa "defa". Ky lloj këndimi, është pa def. Dhe aty, deri diku dominonte zëri iso, por një meso-zë, ndërmjet zërit të parë dhe iso-s, dhe është një lloj këndimi shumë i bukur. Unë kam disa inserte të vjetra që kanë kënduar gratë, mirëpo nuk janë edhe aq të pastra, por e njëjta do të shfrytëzohet për hulumtimet shkencore, që dikush ta sheh e të vërtetojë këtë që e them unë. Ky këndim bëhet në një dhomë, ku një dyshe ndahet në një anë të murit, tjetra në anën tjetër, në skaj të tretë dhe të katërt, që gjithsej janë 8-të persona. Dhe secili grup këndon nga një varg, pastaj të gjithë njëzëri. Këtu krijohet një zë shumë i fortë, por edhe kur lëshohet zëri iso dhe zëri që është udhëheqësi i grupit, me të vërtet krijohet një melodi jashtëzakonisht e bukur dhe njeriu në atë moment mendon se fluturon nga ajo mrekulli e zërave. Këtë kur e kam dëgjuar si fëmijë, më dukej diçka e hatashme dhe ai imazh u ngulit në mendjen time. Dhe u bë ëndrra ime, ku edhe erdhi dita. Por kjo ditë erdh, pasi gjyshi ka patur një dyqan në Edrene të Turqisë, ku atje ai këndonte, madje këngë turke. Bile, emri im më është vënë nga gjyshi. Emri Jashari është emër i një këngëtari në Turqi, ku këngët e tij, siç thashë - gjyshi im i këndonte shumë. Mirëpo, më rekomandonte t'i dëgjoj, por jo t'i këndoj. Dhe ishte gjyshi që më la amanet të vazhdoj rrugën e të kënduarit dhe më detyroi të këndoj në gjuhën amë, gjuhën shqipe.

KOHA: Z. Jashar, ju keni filluar të këndoni pa përcjellje instrumentale në mungesë të instrumenteve folklorike, por i ndjekur nga dy shokë të tjerë që e mbanin zërin iso. Si e përshkruani këtë moment, ku edhe ju hapi rrugë në botën e muzikës?

SEJDIU: Kur dëgjoja gjyshin, lëshoja zë edhe unë. Kur fillova të këndoj isha i vetëm, por më vonë kontaktova dy shokë që përpiqeshin të mbanin zërin e dytë dhe më jepnin kurajo dhe zbukuronin këngën. Në Shqipëri i thonë ta zbukurojnë me "lule", ndërsa ne i themi "ta hjekim këngën". Ashtu fillova bashkë me to të këndojmë, por nuk e gjeja veten mirë dhe fillova vetë të këndoj. Isha dymbëdhjetë vjeçar, ndërsa im vëlla ishte 6-vjeç dhe e nxita të këndojë, megjithëse nuk ishte i gatshëm atëherë. Kështu, u detyrova të marr një çifteli, por në fshat nuk kishte. Rastësisht shoku im, Lazim Destani, i cili ishte katërmbëdhjetë vjeçar, si artdashës, por edhe duke më parë në manifestime, veçmas fetare, se këndoj edhe librin e shenjtë Kuranin, pasi e di të gjithin përmendësh si hafiz, shprehu dëshirë të më blejë një çifteli. Ai e kishte gjendjen ekonomike më mirë se unë. Por, më detyroi të mësoj një këngë, ku ndenja pa bukë e pa gjumë atë natë. Të nesërmen në mëngjes jo vetëm këngën që më propozoi, por mund të përcjellja një reportuar të gjerë. Ajo çifteli më plotësoi zërin e dytë që unë nuk e kisha. Megjithëse atë bukuri të zërit s'e jep, por kisha një melodi që më përcillte. Dalëngadalë, duke u rrit më lindi ideja të bëjmë një "sharki". Por meqë babain e kam patur bari, ai ka takuar në bjeshkë një brigader, ku si me lojë i ka thënë: "Tashmë ke dy djem dhe do të përfitosh tre rroga", këtë gjë na e kumtoi babai në shtëpi, por përgjigja ndaj tij ishte se shumë shpejt do t'ua dëgjosh zërin djemve të mi. Bëmat e jetës na sollën në Reçicë të Madhe, ku edhe kishte kushte pak më të mira, jo për jetesë, por për këngën. Atëherë bashkë me vëllain nisëm t'ia themi këngës së Shqipërisë. Por, një gazetar - Enver Murati, në një mbrëmje na tha nëse dëshirojmë të dëgjohet zëri anekënd, kjo mundet përmes radios. Ishte dëshira më e madhe që të depërtojmë në Radio Shkupin.

KOHA: Ju u shoqëruat më vonë në këngë nga vëllai, ku edhe u emëruat në botën e artit si "Vëllezërit Jashar dhe Idajet Sejdiu". Si lindi ky gërshetim vëllazëror?

SEJDIU: Gjatë këndimit, im vëlla më shoqëronte me një zë të lehtë, ku zërat përputheshin njëri me tjetrin. Por, unë e stimuloja duke i thënë se këndon aq bukur dhe kështu vendosëm që të jemi bashkë, ai dëshironte ta mbajë çiftelinë e mua më mbet sharkia. Në kohën kur ne filluam të njihemi në tregun e muzikës - kishte shumë pak këngëtarë. Ne ishin të parët që e kënduam këngën me plot përgjegjësi, këngën burimore. E them të parët sepse kemi futur zërin e dytë. Në Gostivar kishte shumë këngëtarë që këndonin këngët e asaj zone, por nuk ishte i përfshirë zëri i dytë si në këngët "Moj Mirushe"..., por ajo zonë ishte mjaftë e pasur me këngë. Si fillim kemi patur emrin "Jashar dhe Idajet Bozovca", por kur u zhvendosëm në vend tjetër, e ndryshuam që të mos dukemi lokalist. Ne kishim nisur tashmë me kultivimin e këngës me aktivitete në rrethin tonë. Por, këngën e parë e kemi incizuar në Radio Shkupin, kënga "Çika e Malësisë", kënga e dytë ka qenë "E morra kuferin, nisa nga Tetova", kënga e tretë "Moj e mëjrë e holl e gjatë", këngë të popullit, si dhe shumë këngë të tjera. Atë ditë kur i incizuam këngët, i bleva babait një "tranzitor", që të dëgjojë këngët në radio në bjeshkë. Gjatë transmetimit të këngëve, babain e ka shoqëruar ai maqedonasi (që fola më lartë) dhe duke dëgjuar radion, komentatori i atëhershëm i radios kishte thënë: "Tani do të dëgjojmë këngë folklorike nga Vëllezërit Jashar dhe Idajet Sejdiu". Në moment, maqedonasi i shprehet babait: "Janë djemtë e tu, a e di ç'do të thotë të transmetohen këngët nga Radio Shkupi, aty është shumë vështirë të depërtosh". Babai vërtet ishte ndjerë krenar me ne!

KOHA: Pra, audio-regjistrimet e para i keni realizuar në stacionin radio-televiziv Radio Shkupi, fund vitet e 70'ta. Si u realizua ky mision dhe si u mirëprit nga audienca, si u hapën rrugët e mëtejshme?

SEJDIU: Ishte Enver Murati që na dëgjoi dhe ka shkuar në Radio Shkupi e i thotë kompozitorit tashmë të ndjerë, Ismail Hoxha, që ka gjetur dy këngëtarë, të cilët këndojnë këngë nga Kosova dhe të Shqipërisë së Veriut. Por, ai ia pret shkurt duke i thënë që ne të shkojmë menjëherë në radio. Ku edhe na hapi derën, na dëgjoi dhe siç e shprehu ai, ishte habitur. Dha na kështilloi të këndojmë këngë të rrethit tonë. Pastaj u hapën dyert edhe në radio të tjera si në Tetovë, ku na xhiroi një maqedonas, që me gjasë ishte shqiptar sipas asaj që na përshkruante kur dëgjonte këngët tona. Ai na thoshte: "bie shi (studio pikonte), por unë do t'ua mbaj çadrën, ju vetëm këndoni!". Në Radio Gostivar, na ka xhiruar Gjejaz Fejzullahu. Kështu që ne incizuam një numër të madh të këngëve, ku edhe për një kohë të shkurtër ato këngë u shpërndan në Kosovë e gjetiu.

KOHA: A ka qenë pjesë e juaja varfëria gjatë fëmijërisë? Na përshkruani disa momente nga shkolla e mesme, pastaj për shkollën e lartë, në Pejë?

SEJDIU: Ne kemi qenë të varfër, thuajse nëna na ka shkolluar, duke mbledhur kaça, boronicë, rrënjë lule-

sh e duke i shitur, vetëm e vetëm që të na blejë libra. Sa herë që kujtoj fëmijërinë, lotët s'mund ti ndalë, sepse nëna kur mblidhte kaça, duart çaheshin dhe e mbulonte dorën gjaku. Por, kur e shoh suksesin tonë, them që atë mund që e ka dhënë nëna, e cila ka "luftuar", për mirëqenien tonë. Ajo ka qenë grua dhe njëkohësisht burrë, sepse babai gjithmonë në bjeshkë ka ndenjur. Kjo ishte periudhë kur jetonin në fshatin, në malësi. Pastaj erdha në Tetovë të shkollohem, prej klasës së shtatë, ku e kreva edhe gjimnazin në shkollën "Kiril Pejçinoviq". Më shkonte për shtati lënda e matematikës, ku më pas ndoqa mësimet në shkollën e lartë të financave, në Pejë të Kosovës. Dy vite isha i rregullt, më pas për shkak të gjendjes së dobët ekonomike, vazhdova me korrespodencë, ku edhe e mbarova. Edhe pse e kreva komercialen, atë ditë edhe sot diploma më rri në xhep, pa u punësuar në vendin tim, në Maqedoni. Por, këtë profesion e kam ushtruar në biznesin e shokut tim Lazim Destani, ku kam qenë dhjetë vite në Afganistan edhe një vit në Irak. Por, qëllimi që ika andej ishte që të mos rri të këndoj nëpër dasma. Mirëpo, duke e pa se gjendja ekonomike e komercializon në njëfarë mënyre këngën. Por, thash se ne kemi nis një mision që na e ka lënë gjyshi dhe nuk desha ta shkel atë amanet. Prandaj, i thash Idajetit, që do të largohem. Ajo kohë një dekadëshe mbeti pa aktivitet, ku vëllai nuk dilte vetë të këndojë. Por, kjo periudhë solli shumë këngëtarë në tregun e muzikës. Më pastaj u ktheva në Tetovë dhe pashë që kishte vërshuar "tallavaja", dhe i them vëllait që duhet ta "luftojmë" këtë lloj muzike dhe rifilluam të bëjmë incizime, tashmë në televizione. Por, na ndihmoi vëllai tjetër, Arifibishi, që tashmë ka produksionin e tij "Jehona". Aty edhe i lindi ideja që të hap një televizion, që e quajtëm "Top Estrada", me muzikë 24 orë. Kështu që, tani kemi hapësirë më të madhe për t'i shprehur vlerat tona. Mirëpo, ka qenë dhe është shumë vështirë dhe na është dashur të gjurmojmë thellë këngët e vjetra.

KOHA: Kthehemi në vitin 1995... si pjesëmarrës në festivalin "Oda Dibrane", arritët të merrni titullin "Rapsod më të mirë të festivalit". Një vit më vonë, po në këtë festival fituat çmim "Kënga më e mirë". Pastaj vazhduat të merrni mirënjohje e çmime në Preshevë e gjetiu, duke vazhduar aktivitetet edhe në vendet skandinave.... Si përshkruhet ky rrugëtim nga suksesi në sukses?

SEJDIU: Është një periudhë shumë interesante. Kemi qenë dhe jemi anëtarë të Shoqërisë Kulturore Artistike "Xheladin Zeqiri", ku nëpërmjet kësaj shoqata - ne kemi arrit të zhvillohemi dhe të fitojmë mirënjohje dhe çmime. Vitet e 90'ta shkuam në Peshkopi dhe u prezantuam me këngët tona dhe këtu u vlerësuam. Por të arrijmë çmimin e parë, ishte e habitshme, se përpara nesh kishim këngëtarë, të cilët ishin idolët e mi si Aziz Ndreu, Qerim Sula, Sali Mani, etj, të cilët ishin të pranishëm. Atë ditë dimri, ku edhe u ndanë çmimi i tretë, pastaj çmimi i dytë, që u fitua nga dy rapsodë, i them vëllait të ikim, sepse nuk kishim shpresa më, meqë u ndanë dy vendet e para dhe në ndërkohë u larguam nga salla dhe ikëm në një kafiteri ku kishte stufë dhe që u ngrohëm, por erdhi njëri e na tha ecni shpejt. Kujtuam se na thërret të këndojmë ndonjë këngë për përshëndetje. Më pastaj kuptuam se kishim fituar çmimin e parë, ku na e ndau zotëri Paskal Milo, ndërsa në krye të jurisë ka qenë Agron Gjakolli. Një vit më vonë fituam po në të njëjtin festival çmimin për këngën më të mirë, e cila titullohej "Kur kam qenë më i ri". Pastaj në Preshevë fituam çmimin për duetin më të mirë në këngën "Ah, more ti djal i mejdanit malloja biliken shullanit", malloja do të thotë kur i shpërndan dhentë nëpër bjeshkë. Pastaj filluam të bëjmë xhirime, videokaseta. Atë kohë u takuam me një etno-muzikolog, prof.dr. Ardian Ahmetdaja, që punon në një institucion të Vjenës dhe ai para shtatë viteve na ftoi atje, ku edhe u prezantuam me këngën "Vjeshtë moj virane" dhe "Sulçebegun", kemi shëtitur edhe në vendet e Skandinavisë, në Berat kemi marrë "Çmimin e karrierës", i cili ka qenë shumë i rëndësishëm, sepse të ta jep çmimin e karrierës Shqipëria, do të thotë shumë. Përderisa në Shqipëri të jepet një çmim, do të thotë se të kanë dëgjuar emrin apo zërin.

KOHA: Përveç që shquhen si këngëtar autokton, keni edhe potenciale të tjera në përdorimin e instrumenteve folklorike si sharki, fyell, def, çifteli... Si arritët t'i përvetësoni këto instrumente?

SEJDIU: Është e pabesueshme, por vetë e kam mësuar. Ia kam thënë këngës dhe e kam shkel notën, në qoftë se ajo notë përputhej me zërin tim, atëherë bindesha. E mbaj mend, një nga këngët e para ka qenë "Ani moj ti çikë përpara shtëpisë", pastaj mësova "Moj shamia e kuqe, moj shamia e verdhë", etj. Ndërsa vëllait ia mësova unë. Por, duhet theksuar se kemi gjithë familjen që kanë vesh muzike. Çdo mbrëmje në shtëpinë tonë këndohej, fërshëllenim, me fyell, çifteli, sharki, def, bëhej si koncert. Dhe kështu u njohëm edhe nga fqinjët e më gjerë, të cilët shprehnin edhe ata dëshirë të na tregonin se dinin këngë të vjetra. Ato këngë u futën në raportuarin tonë.

KOHA: Krijimtaria e juaj muzikore është mjaft e begatshme dhe e pasur, ku numri përfshirës i këngëve është rreth 400 këngë, 12 albume të realizuara me këngët më të bukura dhe mbresëlënëse popullore. Ç'do të thotë kjo krijimtari dhe ky bagazh?

SEJDIU: Kjo krijimtari do të thotë vepër e vlefshme dhe mbresëlënëse. Ne i kemi kënduar dhe vazhdojmë të këndojmë këngë patriotike, këngë për kurbetin dhe këngë për dashurinë. Këto këngë u kënduan edhe nga të tjerët. Diku janë pesëqind këngë, ku përveç që kemi mbledh këngët, kemi shkruar edhe tekste, ku më vonë janë bërë këngët tona. Tashmë kemi dymbëdhjetë albume, ku në të gjitha ato albume janë këngë autoktone të trevave tona.

KOHA: Folklori paraqet tërësinë e zakoneve, e riteve të një populli që përcillen brez pas brezi. Si e përshkruani trashëgiminë e folklorit shqiptar? Dhe cilat këngë i veçoni nga raportuari juaj?

SEJDIU: Ne i trashëguam nga gjyshi, ku edhe sot i këndojmë ato këngë. Por, na brengos fakti që pak, të mos them aspak, nuk kultivohet ky zhanër i këngës shqipe. E kemi ndërmarrë të bëjmë një libër, duke i bashkangjitur këngët, por edhe notat muzikore. Besojmë se ai libër do t'u mundësojë brezave të rinj të orientohen më lehtë mbi këngën e vjetër shqipe. Për ne është e rëndësishme që të mbledhim sa më shumë këngë të vjetra ose autoktone. Përmes emisioneve televizive kemi grumbulluar një mori këngësh, brenda një viti, të trevave të ndryshme. I vazhdojmë lidhjet me Institutin e Vjenës, ku edhe arkivohen këto këngë. Kjo lloj kënge që ne këndojmë - nuk është e lehtë të thuhet. Gjithsesi, këngët tona, kanë tekst, muzikë, art, kanë porosinë brenda. Madje, nëpër dasma shtrohet një sofër dhe sipas traditës - këndohen këngët e lashta, që do të thotë nuk humbet kjo traditë dhe më bën shumë krenar.

KOHA: Si ju mirëpret familja juaj pas çdo suksesi dhe si e shprehin gëzimin?

SEJDIU: Kam një djalë dhe një vajzë, të shkolluar. Ndërsa bashkëshortja ime është e mbuluar, ashtu siç e do feja dhe zakoni. Por, ajo nuk e ka kuptuar kurrë botën time të artit, por besoj që për secilin që kur të vdesim - do t'ia dimë vlerën për punë që ka bërë.

Nga fëmijët, djali merret me teknikën që i nevojitet artit të muzikës, ndërsa vajza këndon aq bukur, por e ëma nuk e ka lejuar të merret me muzikë, mbase është rrethi i tillë që e ngushton. Djalin e kam të martuar me një nuse që i është përkushtuar shkollës. Në jetën e tyre ka ardhur tashmë trashëgimtari. Nipi e ndjej se do ta trashëgojë muzikën që më flenë mua në shpirt, por më thotë një gjë: "Unë nuk do të këndoj si ty gjysh, por më mirë se ti. Kur ti gjysh i bie çiftelisë qëndron me një vend, ndërsa unë do ta pushtoj skenën edhe duke kërcyer". Ai ka dëshirë muzikën, me këngë rritet. Ne, pra, jemi një familje e lumtur, siç thashë - çdo mbrëmje buçet kënga shqipe në vatrën tonë, bashkë me familjet e vëllezërve të mi.

19 VJET NGA DEKLARATA E GRUPIT TË KONTAKTIT NË LONDËR

Më 30 janar 1999, Këshilli i NATO-s e ripërtëriu vendimin e marr në tetorin e vitit të kaluar, duke vendosur kështu kornizë diplomatike për Konferencën. Fryma e Deklaratës së Grupit të Kontaktit nuk la vend dyshimi në vendosmërinë për të gjetur një zgjidhje e për të negociuar para pranverës. Është gati ultimatum, do të shprehet në librin e tij Paskal Milo

Masakra e Reçakut përfundimisht e përjashtoi mundësinë e një marrëveshjeje për paqe në bisedime të drejtpërdrejta shqiptaro-serbe, siç ishte propozuar për disa vite me radhë. Pas kësaj masakre u rrit aktiviteti diplomatik në relacionin Uashington-NATO-Bruksel-Grup i Kontaktit, ku dhe të gjithë kishin arritur pajtimin se ideja për organizimin e një Konference duhej të kishte prioritet ndaj politikës së ultimatumeve. Më 29 janar 1999 Grupi i Kontaktit, i takuar në Londër në Pallatin Lancaster House, në afërsi të Pallatit Mbretëror St.James, doli me Deklaratën historike për mbajtjen e Konferencës në Rambuje, dhe miratoi parimet e panegociueshme, mbi të cilat duhej të ndërtohej Marrëveshja Kalimtare për Kosovën. Më 30 janar Këshilli i NATO-s e ripërtëriu vendimin e marr në tetorin e vitit të kaluar, duke vendosur kështu kornizë diplomatike për Konferencën. Fryma e Deklaratës së Grupit të Kontaktit nuk la vend dyshimi në vendosmërinë për të gjetur një zgjidhje e për të negociuar para pranverës. Është gati ultimatum, do të shprehet në librin e tij Paskal Milo. Në Beograd natyrshëm deklarata e Grupit të Kontaktit nuk është pritur mirë. Shqipëria zyrtare nëpërmjet ambasadorit të saj në Francë, Luan Rama kishte kërkuar nga këshilltari i posaçëm i Vedrinit, i ngarkuari për Kosovën, që Shqipërisë t'i jepej statusi i vëzhguesit, gjë që nuk u pranua.

Si arsyetim këshilltari Fushe do të deklarojë se nuk do të ketë vëzhgues të tjerë nga Ballkani, dhe se në Rambuje nuk do të ketë konferencë ndërkombëtare si ajo e Parisit për Bosnjën. Vendosmëria për ndërhyrje ushtarake Grupi i Kontaktit i përkrahur nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, bashkë me NATO-n tanimë ishin pjesë e lojës. Qeveria amerikane në veçanti kishte filluar të bënte trysni për aksion të mundshëm ushtarak për ta ndalur represionin në Kosovë. Kërcënimi i përdorimit të forcës në raport me Kosovën nga SHBA-ja ishte bërë që nga viti 1992.

"Në rast të konfliktit në Kosovë, i cili do të shkaktohej nga veprimi i Serbisë, SHBA-ja do të ishte e gatshme të përdorte forcën ushtarake kundër serbëve në Kosovë dhe në vetë Serbinë", i kishte shkruar kryetari i atëhershëm, George Bush, Sllobodan Millosheviqit, kërcënim ky që u përsërit nga administrata e Bill Clinton. Kurse Javier Solana, sekretari i përgjithshëm i NATO-s kishte deklaruar se Aleanca, në përpjekjet e veta për ta përkrahur bashkësinë ndërkombëtare që të arrihej një marrëveshje e negociuar, kishte "....rishikuar planifikimin ushtarak për një vistër mundësish që të ndalej dhuna dhe të krijoheshin kushtet për negociata. Këto e përfshijnë edhe përdorimin e forcave tokësore e ajrore, e posaçërisht një vistër të gjerë opsionesh për përdorimin vetëm të forcës ajrore. Këto sigurojnë që NATO-ja të mund të vepronte me shpejtësi dhe në formë efikase po të shfaqej nevoja". Këshilli i Sigurimit i OKB-së, kishte miratuar edhe rezolutat 1160 (1998), sipas së cilës Beogradi duhej të ndërpriste të gjitha veprimet luftarake, si dhe 1199 (1998), që ishin të bazuar në kapitullin e VII të Kartës së OKB-së. Një rezolutë e cila merret duke u mbështetur në Kapitullin e VII të Kartës së OKB-së, çmohet si hap i parë drejt masave më të ashpra të ndërmarra nga KS, të cilat mund të shkojnë deri tek intervenimi ushtarak. Në bazë të kapitullit VII të Kartës së OKB-së, keqësimi i gjendjes në Kosovë u cilësua si "rrezik për paqe dhe siguri në rajon. Edhe ministri i Jashtëm rus Ivanov, votoi pro Rezolutës 1199, çka nënkupton një tërheqje nga pozicioni i saj i fortë në mbështetje të Beogradit. Para opinionit publik, si justifikim rusët do të theksojnë se kjo rezolutë do të shërbejë si impuls për dialog të drejtpërdrejtë midis Beogradit dhe Kosovës.

PAS ACARIMIT TË RAPORTEVE ME VENDET ALEATE TË BE-SË DHE SHBA-TË

Vështirësohet anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare

Anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare do të bëhet edhe më i vështirë pas acarimit të raporteve me vendet aleate të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, thonë analistë të çështjeve politike. Përkeqësimi i raporteve ndërmjet liderëve politikë dhe shteteve mike të Kosovës, erdhi pas mospajtimeve që u shfaqen në dy nga çështjet më të rëndësishme aktualisht në skenën politike të Kosovës, siç është ratifikimi i Marrëveshjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi dhe nisma për shfuqizimin e Ligjit për Gjykatën Speciale për krime lufte. Analisti i çështjeve politike, Ilir Ibrahimi, në një prononcim për Radion Evropa e Lirë thotë se nga i gjithë ky dëmtim i raporteve, do të ketë pasoja të mëdha për qytetarët dhe të ardhmen e vendit. "Ky është një hap prapa në relacionet që shteti i Kosovës i ka pasur me këto vende mike. Në vend që të ndërtohen dhe forcohen këto marrëdhënie që i kemi pasur, ne jemi duke i dëmtuar ato dhe kjo e dëmton edhe të ardhmen e vendit në rrugën drejt integrimeve euroatlantike, mirëpo edhe në integrimin e Kosovës në organizatat e ndryshme ndërkombëtare, ku padyshim do të ketë nevojë për ndihmën e këtyre vendeve mike", thotë Ibrahimi. Që nga shpallja e pavarësisë më 17 shkurt të vitit 2008, Kosova është bërë anëtare e shumë organizatave ndërkombëtare, përfshirë edhe organizatat më të rëndësishme financiare dhe sportive. Përderisa e arritura kryesore në raportet me BE-në, mbetet Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, e cila ka filluar të zbatohet nga prilli i vitit 2016. Por, nuk ka arritur të rrumbullakojë subjektivitetin e saj ndërkombëtar, pasi që nuk është bërë pjesë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe organizatave tjera, që ndërlidhen me OKB-në. Tre vitet e fundit, me gjithë paralajmërimet të zyrtarëve më të lartë të shtetit, Kosova nuk arriti të bëhet anëtare e UNESCO-s (Agjencisë për Kulturë, Shkencë dhe Arsim e Kombeve të Bashkuara), Këshillit të Evropës dhe as INTERPOL-it (Policisë Ndërkombëtare). Anëtarësimi i Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë, siç është Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, ishte ndihmuar nga vendet aleate. Anëtarësimi i Kosovës në këta dy mekanizma kishte ndihmuar vendin në zhvillimin ekonomik. Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, thotë për Radion Evropa e Lirë se janë vendet aleate të Bashkimit Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës që kanë ndihmuar që Kosova të jetë jo vetëm shtet i pavarur, por edhe anëtar i shumë mekanizmave ndërkombëtarë. "Dëmtimi i mundshëm i raporteve me këto shtete mike do të pamundësonte ose do të pengonte Kosovën në anëtarësimin në institucione tjera, së paku nuk do të mund të llogarisim në mbështetjen e këtyre shteteve.

Duke e ditur që ekziston edhe një numër i madh i shteteve që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës dhe duke ditur që dy tre shtete të fuqishme përdorin autoritetin e tyre qe ta pengojën avancimin e Kosovës në aspekt të njohjes ndërkombëtare, kjo do të ishte një fatkeqësi tjetër e radhës për vendin", thotë Zeka. Kosovën që nga shpallja e pavarësisë më 17 shkurt të vitit 2008, e kanë njohur 115 shtete. Ndërkohë, janë edhe pesë shtetet anëtare të Bashkimit Evropian që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Problemet me anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, ndërlidhen edhe me mosnjohjen e saj nga këto pesë shtete të BE-së. (REL)

Tregtari serb i armëve në Listën e Zezë të SHBA-së

SHBA kanë vendosur në listën e zezë 39 persona, përfshirë një biznesmen nga Serbia. Sllobodan Teshiq, i njohur si një nga tregtarët më të mëdhenj të armëve në Ballkan është pjesë e kësaj liste, transmetojnë mediat serbe. Në arsyetimin e për vendosjen e sanksioneve ndaj Teshiq përmendet se administrata amerikane ka vendosur një regjim të ri të sanksioneve ndaj personave që kanë lidhje me korrupsionin dhe shkeljen e të drejtave të njeriut. Kjo nuk është hera e parë që emri i Teshiq lidhet me ndalimin e udhëtimeve. "Teshiq është ndër tregtarët më të mëdhenj të armëve dhe municioneve në Ballkan, një person i cili është i ndaluar të udhëtojë për shkelje të sanksioneve të OKB-së në eksportin e armëve në Liberi", ka bërë të ditur Thesari amerikan. Në arsyetimin e vendimit për vendosjen e sanksioneve qëndron edhe ajo, se Teshiq me qëllim të sigurimit të marrëveshjeve për armatim, zyrtarëve të vendeve të ndryshme drejtpërdrejt ose tërthorazi u ka dhënë ryshfet dhe ndihmë financiare. Në dokumente thuhet se Teshiq edhe në mënyra tjera ka korruptuar të gjithë ata nga të cilët ka pasur përfitim. Ai pagoi për edukimin e fëmijëve të klientëve të mundshëm, pushimet e shtrenjta dhe përfitime tjera. Sipas pohimeve nga SHBA, Teshiq posedon ose kontrollon kompanitë serbe Partizan Tek dhe Tehnoglobal Sistems d.o.o. Beograd, si dhe kompanitë qipriote Gravit Limitid dhe Karso Limitid. "Teshiq negocion shitjen e armëve përmes Karso Limited dhe përdor Gravit Limited si një mekanizëm për financimin e politikanëve", thuhet në njoftim. Teshiq ka qenë njeri i afërt i ish-presidentit serb Tomisllav Nikoliq dhe posedon pasaportë diplomatike.

Për një muaj, tre fëmijë të vrarën dhe 52 të arrestuar

Forcat izraelite kanë vrarë tre të mitur palestinezë dhe kanë arrestuar 52 të tjerë që nga fillimi i këtij viti, bën të ditur Ministria e Informacionit të Palestinës. Në deklaratën e publikuar të dielën, ministria akuzoi autoritetet izraelite për "përshkallëzimin e sulmeve kundër fëmijëve palestinezë". Më tej theksohet se sulmet izraelite janë rritur ndjeshëm që nga vendimi i presidentit të SHBA-së Donald Trump i cili zyrtarisht njohu Kudsin si kryeqytet të Izraelit. Vitin e kaluar, 17 të mitur palestinezë u vranë dhe 1.620 të tjerë u arrestuan nga forcat izraelite në territoret palestineze, thotë ministria. Sipas deklaratës, gjithsej 350 fëmijë ende janë duke vuajtur në burgjet izraelite. Tensionet kanë vazhduar në territoret palestineze që nga vendimi i Trumpit, i cili ka shkaktuar reagime nga mbarë bota dhe protesta në disa vende.



FACEBOOK DHE GOOGLE, KËRCËNIM PËR SHOQËRINË

Investitori miliarder dhe filantropi, George Soros, në një deklaratë të hapur ka sulmuar dy gjigandët e internetit Facebook e Google. Ai tha se këto dy platforma janë bërë "pengesa për risitë" dhe janë një "kërcënim" për shoqërinë njerëzore. "Kompanitë minerare dhe ato të naftës shfrytëzojnë mjedisin fizik; shoqëritë e mediave sociale shfrytëzojnë mjedisin social", tha biznesmeni hungarezo-amerikan. "Kjo është veçanërisht e keqe, sepse kompanitë e mediave sociale ndikojnë në mënyrën se si njerëzit mendojnë dhe veprojnë pa qenë të vetëdijshëm për të. Kjo ka një efekt të kundërt në funksionimin e demokracisë". Sipas Soros, "përveçse sfumojnë demokracinë, kompanitë e mediave sociale mashtrojmë duke manipuluar vëmendjen e tyre dhe drejtuar publikun drejt qëllimeve të tyre komerciale". "Ata ofrojnë shërbime të varësisë, që mund të jenë shumë të dëmshëm, veçanërisht për adoleshentët. Fuqia për të formuar vëmendjen e njerëzve është gjithnjë e më e koncentruar në duart e disa kompanive. John Stuart Mill e quajti 'lirinë e mendjes'. Ekziston një mundësi që do të humbasë dhe njerëzit që rriten në epokën digjitale do të kenë vështirësi në rimarrjen e saj. Kjo mund të ketë pasoja të gjera politike", theksoi milardieri Soros.

> Soros paralajmëroi për një "perspektivë" edhe më "alarmante" në horizont nëse kompanitë e internetit me të dhëna të pasura si Facebook dhe Google kanë monitoruar sistemet e tyre të mbikëqyrjes me mbikëqyrjen e sponsorizuar nga shteti

Soros paralajmëroi për një "perspektivë" edhe më "alarmante" në horizont nëse kompanitë e internetit me të dhëna të pasura si Facebook dhe Google kanë monitoruar sistemet e tyre të mbikëqyrjes me mbikëqyrjen e sponsorizuar nga shteti. Kompanitë, të cilat ai i përshkroi si "monopole gjithnjë e më të fuqishme", nuk kanë gjasa të ndryshojnë sjelljen e tyre pa rregullime të jashtme. "Monopolet e internetit nuk kanë as vullnetin as prirjen për të mbrojtur shoqërinë kundër pasojave të veprimeve të tyre", tha ai. Soros shtoi më tej se Davosi ishte një vend i mirë për të njoftuar se "Ditët e tyre janë të numëruara". Ai gjithashtu kritikoi udhëheqjen e Donald Trump, duke thënë se ai kishte vënë SHBA-të në një luftë bërthamore me Korenë e Veriut.

ISIS-i i futet Afganistanit, sulm i ri në Akademinë ushtarake

Ministria e Mbrojtjes në Afganistan ka thënë se disa militantë kanë sulmuar rojet ushtarake, afër akademisë kryesore ushtarake në Kabul, duke lënë të vdekur 11 persona dhe duke plagosur 16 të tjerë. Grupi militant, Shteti Islamik e ka marrë përgjegjësinë për sulmin e ditës së sotme, përmes agjencisë së tyre të lajmeve Amaq. Ky sulm vjen pas disa akteve të tjera të përgjakshme në kryeqytetin afgan, për të cilat talibanët kanë marrë përgjegjësinë. Zëdhënësi Dawlat Waziri, ka thënë, se bomba vetëvrasëse ka sulmuar njësinë për mbrojtjen e Akademisë ushtarake, Marshal Fahim dhe më pas sulmuesit kanë nisur betejën me armë zjarri në të cilën kanë vdekur pesë ushtarët afganë. Waziri i ka thënë Shërbimit të Afganistanit të Radios Evropa e Lirë, se dy militantë kanë kryer sulme vetëvrasëse, dy janë vrarë gjatë betejës dhe tjetri është zënë i gjallë. Personeli i akademisë ushtarake ka qenë cak i një sulmi të talibanëve më 21 tetor, në të cilin kanë mbetur të vdekur të paktën 15 kadetë. Ndërkohë, Qeveria e Afganistanit ka shpallur Ditë Zie për të hënën, pasi nga një sulmi i një dite më parë vetëvrasës me makinë-bombë, u vranë më se 100 vetë. Përgjegjësinë për këtë sulm në kryeqytetin Kabul e kishin marrë militantët talebanë. Ministri i brendshëm afgan, Wais Barmak, ka njoftuar se numri i të vrarëve nga sulmi vetëvrasës me makinë-bombë në pjesën qendrore të Kabulit ka arritur në 103 vetë dhe 235 të plagosur, përfshirë 30 policë.

Lirohet Aleksei Navalny

Kreu i opozitës ruse, Aleksei Navalny është lënë i lirë pas ndalimit një ditë më parë gjatë tubimit të thirrur prej tij për të protestuar kundër zgjedhjeve presidenciale të muajit mars. Avokati i tij i tha shtypit vendas se Navalny është lënë i lirë pa u ngritur akuza ndaj tij, por i është kërkuar që të paraqitet më vonë në sallën e gjyqit, e ndoshta aty mund të përballet me një aktpadi. Më herët, policia bastisi zyrat e kryeopozitarit në Moskë dhe sekuestroi atje disa pajisje. Navalnyt, zërit më kritik ndaj Vladimir Putinit, i është ndaluar pjesëmarrja në zgjedhjet e 18 marsit. Pak pas prangosjes, ai kishte shkruar në Twitter: "Arrestimi i një personi nuk ka asnjë kuptim nëse ne jemi shumë. Dikush të vijë e të zëvendësojë!". Kreu i opozitës thotë se votimi i marsit duhet bojkotuar, duke i quajtur ato "pseudo-zgjedhje". Arsyeja përse atij nuk i lejohet kandidimi është një dënim i pezulluar me burg, për të cilin Navalny këmbëngul se është krejtësisht i fabrikuar.

Irani dëshiron të krijojë "Internetin Hallall"

Irani ka në plan të krijojë versionin e vet të internetit të kontrolluar në nivel lokal, të quajtur "Hallall Net", për të ruajtur kontrollin e rreptë mbi rrjedhën e informacionit në publik. Sipas mediave të huaja, kjo po ndodh në një kohë kur ky vend është afër shënimit të 40-vjetorit të revolucionit. Tutje thuhet se marrëdhënia e Republikës Islamike me rrjetin botëror është shumë e komplikuar. Për t'iu ikur problemeve të shumta, si zgjidhje e autoriteteve është krijimi i të ashtuquajturës "Interneti Hallall", që është version i kontrolluar i internetit në nivel lokal. Ideja e këtij interneti në Iran ka filluar që nga viti 2001, pas protestave e trazirave të vitit 2009, e që do të thotë se do të ketë më shumë kontroll në vend.

FËMIJËT E PARË QË U VRANË ISHIN ATA INVALIDË!

"Nuk do ta harroj kurrë atë tym. Nuk do t'i harroj kurrë ato fytyra fëmijësh trupat e të cilëve i pashë të transformoheshin në tym nën një qiell të shurdhët. Nuk do t'i harroj ato flakë që digjnin përgjithmonë Feden tim. Nuk do harroj kurrë gjithë këtë edhe sikur të isha dënuar të jetoja sa Zoti vetë, kurrë!", shkruan Elie Wiesel, shkrimtar dhe fitues i Nobelit për paqen në vitin 1986 që në librin e tij "Nata" rrëfeu përvojën e tij të të mbijetuarit

Hebrenj, sllavë, invalidë, romë: fëmijë të padëshirueshëm, viktima të Rajhut të Tretë numërohen të paktën 1 milionë e gjysëm. Shumë vdiqën në kampe shfarosëse dhe geto, ku uria dhe tifoja zhdukën mijëra njerëz. Kush mbijetoi si Elie Wiesel apo si Liliana Segre që kur u rritën dëshmuan tmerrin që kishin përjetuar. Kushtet e fëmijëve jo arianë në Gjermaninë naziste u bënë kritike në vitin 1933 kur Hitleri hipi në pushtet, por u përkeqësuan dy vite më vonë me shpalljen e ligjeve raciale (ligje të Nurembergut). Qëllimi ishte arianizimi i shoqërisë duke filluar pikërisht nga të vegjlit. Fëmijët "e papastër" u përjashtuan nga shkollat, aktivitetet sportive dhe nga ato krijuese të etiketuar si elemente të huaja në shoqëri. Në Gjermani ngjarjet precipituan me "natën e kristaleve" në vitin 1938 kur disa ditë dyqanet, sinagogat dhe shtëpitë e hebrenjve u shkatërruan në mënyrë shkencore dhe sistematike.

NË FILLIM INVALIDËT

Me objektiv luftën situata u rëndua shumë. Fëmijët e parë që e paguan ishin ata invalidë (qoftë arianë ose jo) të eliminuar nga programi i eutanazisë Aktion T4, i planifikuar për të pastruar racën dhe që i kushtoi jetën 7000 fëmijëve "jo perfektë" dhe të prekur nga sëmundje gjenetike ose mendore. Ndërkohë, në Evropë hebrenjtë vendoseshin në geto dhe më i famshmi është ai i Polonisë me 400.000 hebrenj nga të cilët 100.000 fëmijë të mbyllur në një sipërfaqe prej 3.4 km katrorë. Në çdo dhomë jetonin mesatarisht 7 persona. Në pak muaj filluan vdekjet nga kequshqyerja dhe tifoja. Në këtë ferr pati edhe histori humanizmi si ajo e profesor Korczak-ut, pedagog dhe mjek polak që në geton e Varshavës për dy vite drejtoi jetimoren me 2000 fëmijë. Pavarësisht kushteve të vështira u garantoi atyre një jetë dinjitoze dhe i shoqëroi deri në vdekje, kur në vitin 1942 u deportuan të gjithë në kampin shfarosës të Treblinkës.

RASTI TEREZIN

Anomalia e vetme në dukje, ishte rasti Terezin vetëm 60 km larg Pragës. Propaganda e konceptoi si një vend të rezervuar për hebrenjtë e famshëm saqë e prezantoi si model nazist banimi për hebrenjtë. U vendosën në këtë kamp artistë dhe intelektualë që patën një jetë kulturore që kishin mundësi shfrytëzimi të një biblioteke dhe që fëmijët mund të frekuentonin shkolla të drejtuara nga ata vetë me mësime të përditshme. Gati 15.000 fëmijë të Terezinit u bënë të famshëm për dëshmitë e tyre të gjetura pas lufte: poezi dhe vizatime që treguan jetën të parë nga sytë e fëmijëve 5 ose 6 vjeç. Pothuaj asnjë prej tyre nuk shpëtoi. 90% e fëmijëve nga viti 1942 e më tej përfundoi në kampet e përqendrimit.

FERRI

Me të mbërritur në kamp, fëmijët poshtë moshës 13 vjeçare që nuk mund të punonin vriteshin menjëherë në dhoma gazi. Ata që nuk vriteshin në dhomat e gazit përfundonin si kavie për eksperimente pseudoshkencore dhe dërgoheshin në Auschwitz-Birkenau apo dhe në laboratore të tjera gjermane. Janë të shumta eksperimentet e doktor Mengeles që Auschwitz-i seleksionoi një grup fëmijësh rreth 3000, kryesisht binjakë , si kavie për studimet e tij, nga të cilët mbijetuan 200. Edhe disa fëmijë të Terezinit përfunduan në këto eksperimente.

> Gati 15.000 fëmijë të Terezinit u bënë të famshëm për dëshmitë e tyre të gjetura pas lufte: poezi dhe vizatime që treguan jetën të parë nga sytë e fëmijëve 5 ose 6 vjeç. Pothuaj asnjë prej tyre nuk shpëtoi. 90% e fëmijëve nga viti 1942 e më tej përfundoi në kampet e përqendrimit

MREKULLIA E BUCHENWALD-IT

Në kampin e përqendrimit të Buchenwald-it ndodhi një mrekulli. 904 fëmijë u shpëtuan falë solidaritetit të disa të burgosurve që i mbrojtën deri në fund të çlirimit. Me mbarimin e luftës fëmijët, viktima të Holokaustit, ishin një milionë e gjysëm, rreth një milionë nga këta ishin hebrenj. Të rralla ishin rastet që fëmijë hebrenj arrinin të arratiseshin nga fati i tyre tragjik, që strehoheshin apo që jetonin me identitet fals. Ata të vegjël që arritën të shpëtoheshin dëshmuan tmerrin e tyre personal dhe 5 prej tyre fituan çmimin Nobel.

NGA KAMPI NË NOBEL

Ky është rasti i fizikantit teoricien François Englert, Nobel për fizikën në vitin 2013, i mbijetuar në vitet e luftës me një identitet fals në një jetimore, kimisti dhe shkrimtari Roald Hoffmann, Nobel për kiminë në vitin 1981 që arriti të arratisej bashkë me të ëmën nga kampi i përqendrimit në vitin 1939, psikologu Daniel Kahneman, Nobel për ekonominë në vitin 2002 që jetoi klandestin deri në vitin 1945, shkrimtari Imre Kertész , Nobel për letërsinë në vitin 2002 që u deportua 15 vjeçar në Auschwitz e më pas në Buchenwald, ku i lirua në vitin 1945. Elie Wiesel, shkrimtar dhe fitues i Nobelit për paqen në vitin 1986 që në librin e tij "Nata" rrëfeu përvojën e tij të të mbijetuarit: "Nuk do ta harroj kurrë atë tym. Nuk do t'i harroj kurrë ato fytyra fëmijësh trupat e të cilëve i pashë të transformoheshin në tym nën një qiell të shurdhët. Nuk do t'i harroj ato flakë që digjnin përgjithmonë Feden tim. Nuk do harroj kurrë gjithë këtë edhe sikur të isha dënuar të jetoja sa Zoti vetë, kurrë!". *(Focus)*



Me objektiv luftën situata u rëndua shumë. Fëmijët e parë që e paguan ishin ata invalidë (qoftë arianë ose jo) të eliminuar nga programi i eutanazisë Aktion T4, i planifikuar për të pastruar racën dhe që i kushtoi jetën 7000 fëmijëve "jo perfektë" dhe të prekur nga sëmundje gjenetike ose mendore



GJITHÇKA QË DUHET TË DIMË PËR KEFIRIN

Një ushqim antik me origjinë nga kaukazi por që po përdoret gjithnjës e më shumë në gjithë botën dhe bëhet fjalë për kefirin, një probiotik me mjaft veti të shëndetshme, sidomos për sistemin imunitar

Ajo është një pije me bazë qumështin e fermentuar, qoftë prej dele apo prej dhie. Mjaft i ngjashëm me kosin, por më i lehtë në acide dhe freskues. Kefiri tradicional përgatitet duke bashkuar në qumësht kokrat e kefirit, përbërë nga përzierja e mikroorganizmave. Por mund të përgatitet dhe me ujë në një version të përshtatshëm për vegjetarianët dhe intolerantët ndaj laktozës. Edhe pse duket si kos, kefiri është rezultat i veprimit të llojeve të ndryshme të baktereve dhe majave dhe për këtë arsye është shumë më aktiv në veprimin e tij të ri-balancimin në florën e zorrëve bakteriale. Ajo gjithashtu ka pak kalori dhe ka një përqendrim të veçantë të vitaminave B dhe acidit folik. Veprimtaria e tij në florën e zorrëve bakteriale e bën atë një aleat i fuqishëm të sistemit imunitar.

Kefiri është gjithashtu një ndihmë e vlefshme për të lehtësuar tretjen, dhe për të kontrolluar sasinë e kolesterolit "të keq" në gjak. Duke qenë se favorizon rregullsinë e zorrëve, kefir është gjithashtu një ushqim që ndihmon në "zbrazjen" e stomakut dhe na jep një bark të sheshtë dhe një bel të hollë. Prandaj, është një ushqim i shkëlqyer që nuk duhet humbur, nëse ndjekim një dietë pastrimi dhe detoksifikimi. Kefir është shumë e pasur me minerale, duke përfshirë kalcium, magnez, fosfor dhe zink, dhe disa aminoacidet.

Kefiri mund të blihet i gatshëm ose të përgatitet në shtëpi, në mënyrë që të jetë gjithmonë i freskët: 2 lugë kokra kefiri (rreth 50 gramë), për përzierje në një gjysmë litër qumësht në temperaturë dhome në një enë qelqi me kapak dhe e mbani në temperaturën e dhomës. Në verë, është më mirë të ruhet në frigorifer.

Lëreni për të pushuar për 48 orë, duke e përzierë herë pas here. Kur të nisni të konsumoni kefir për herë të parë është mirë për të filluar me dozë të vogël për të parë efektin që ka në fizik, duke kontrolluar se nuk ka efekte anësore: Ajo fillon me një lugë disa ditë deri në një ose dy gota.

Çka u zbulua në piramidën e lashtë greke?

A është qytetërimi jonë më i zhvilluari në histori? Mbase jo! Arkeologët që gërmojnë në një strukturë të lashtë piramidale në ishullin grek të Kerosit, kanë gjetur dëshmi se krijuesit e saj shumë më të sofistikuar se sa ishte menduar më parë. Ndërtuesit e vendbanimit të Dhaskalio gdhendën kullën në tarraca të hapura dhe shtuan afërsisht 1,000 ton gur të bardhë në mënyrë që ajo të dukej si një piramidë gjigante dhe e shkëlqyeshme. Guri u transportua nga 10 kilometra larg. Hulumtimet e reja në faqen 4000 vjeçare kanë zbuluar një sërë karakteristikash mbresëlënëse, duke përfshirë një seri të ndërlikuar të tuneleve të kullimit dhe punimet metalike që ishin "jashtëzakonisht të sofistikuara" për kohën. Dëshmia e punimeve metalike u zbuluan fillimisht rreth 10 vjet më parë dhe studiuesit më pas gjetën vegla pune dhe objekte të ngjashme. Arkeologët nuk ishin të vetëdijshëm se qytetërimi i lashtë që zinte vendin ishte i aftë për punë të tilla të inxhinierisë teksa po vazhdon kërkimet për të gjetur më shumë rreth asaj se kush ka jetuar atje. Dr.Michael Boyd i Universitetit të Kembrixhit, një nga drejtuesit e gërmimeve, thotë se është e qartë se vendi ishte një pikë qendrore për përpjekjet drejt metalurgjisë dhe punës tjetër të kualifikuar. "Në një kohë kur qasja në lëndët e para dhe aftësitë ishte shumë e kufizuar, ekspertiza e përpunimit të metaleve duket se ka qenë shumë e koncentruar në Dhaskalio", tha ai në një deklaratë. Dhaskalio ishte i njohur më parë për zbulimin e mijëra figurinave të mermerit të thyer, që datuan 4500 vjet, që mendohej të ishin përdorur në aktivitete rituale.

Deshifrohen dorëshkrimet e fundit të Detit të Vdekur



Hulumtuesit kanë deshifruar një prej dy dorëshkrimeve të papublikuara të Detit të Vdekur, duke hedhur dritë në një pergamenë antike prej mbi dy mijë vjetësh. Dhe nuk ishte punë e lehtë. Për rreth një vit dijetarët kanë mbledhur me durim të madh më shumë se gjashtëdhjetë fragmente teksti të zhubrosur. E që gjërat të vështirësoheshin edhe më shumë, çfarë shkruhej në të nuk mund të lexohej prej kujtdo - ishte enkriptuar me një kod të harruar kaherë. "Dorëshkrimi ishte me kod, por përmbajtja aktuale e tij është e thjeshtë dhe fort mirë e njohur, dhe nuk kishte arsye për ta fshehur", kanë vlerësuar vlerësuesit Eshbal Ratson dhe Jonathan Den-Dov nga Universiteti i Haifës në Izrael.

Zgjidhet situata e familjes që jetoi në aeroport për 3 muaj

Nëse jeni shqetësuar ndonjëherë se jeni detyruar të flinië aeroport për shkaqe të ndryshme, mendoni pak për një familje zimbabweane që ka jetuar në atje për tre muaj.

Familja prej 8 anëtarësh ka arritur që më në fund të largohet nga aeroporti i Bangkok. Ata u përpoqën të largoheshin në tetor për në Spanjë, por nuk kishin vizat e duhura. Gjithashtu nuk mund të hynin përsëri në Tajlandë pasi kishin kaluar limitin e qëndrimit si turistë dhe duhet të paguanin gjobën. Sipas BBC, ata nuk mund të ktheheshin në Zimbabwe sepse do përballeshin me persekutim. Situata e tyre mori drejtim tjetër kur një punonjës në aeroportin Suvarnabhumi publikoi fotografi me një prej fëmijëve, duke thënë se ata po jetonin aty për shkak të një çështje të pazgjidhur. Autoritetet shpjeguan se do ndihmonin familjen të bënte marrëveshje me Ukrainën për të bërë dokumentet që shkonin nga Kiev për në Dubai, duke anashkaluar emigracionin evropian. Familja kërkoi ndihmë nga OKB, duke thënë se ata kishin frikë nga persekutimi në Zimbwabe, pas trazirave të nëntorit që panë largimin e liderit afatgjatë Robert Mugabe.

OKB tha se po shikonte për një mundësi, ndërsa Tajlanda nuk ofronte status ligjor për refugjatët dhe azilkërkuesit. Kështu, familja qëndroi brenda zonës së nisjes, duke u kujdesur nga stafi i aeroportit. Sipas një zëdhënësi të zyrës së imigracionit të Tajlandës, ata më në fund u larguan nga Bangkoku të hënën pasdite.

Republika e Maqedonisë
Ndërmarrja publike për rrugë shtetërore

Në bazë të nenit 20 paragrafi 1 pika 9 e Statutit të Ndërmarrjes publike për rrugë shtetërore, ndërsa në pajtim me nenin 19 paragrafi 2 pika 11 të Ligjit për ndërmarrje publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 38/96, 6/2002, 40/2003, 49/2006, 22/2007, 83/2009, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15 dhe 39/16), Këshilli drejtues i Ndërmarrjes publike për rrugë shtetërore në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2018 publikon

Konkurs publik
Për zgjedhje të Drejtorit të Ndërmarrjes publike për rrugë shtetërore

1. Shpallet konkurs publik për zgjedhje të Drejtorit të Ndërmarrjes publike për rrugë shtetërore.

2. Kandidatët të cilët do të paraqiten në konkursin publik për zgjedhje të Drejtorit të Ndërmarrjes publike për rrugë shtetërore duhet të përmbushin kushtet në vijim:

– Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
– Të jetë i moshës së rritur,
– Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
– Në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

3. Krahas kushteve të përgjithshme për punësim, duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim:
– Të ketë të mbaruar arsim sipëror – të fituara së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit,
– Të ketë minimum pesë vjet përvojë pune,
– Të posedojë një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë: TOEFEL IBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) - të dhënë ose BULATS – së paku 60 pikë,
Të kenë të dhënë testin psikologjik ose testin për integritet.

4. Së bashku me fletëparaqitjen në konkurs për zgjedhje të Drejtorit të Ndërmarrjes publike kandidati duhet të dorëzojë edhe dokumentacionin në vijim:

- Certifikatë shtetësie (origjinal apo kopje të verifikuar në noter),
- Dëshmi për arsim të lartë të mbaruar e cila është e paparë me konkursin (origjinal apo kopje të verifikuar në noter),
- Dëshmi për përvojë pune të cilën e posedon kandidati i cili paraqitet në konkursin për Drejtor të Ndërmarrjes publike,
- Certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet,
- Vërtetim/Certifikatë se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor që nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë e plotfuqishme për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës (origjinal apo kopje të verifikuar në noter, jo më të vjetër se gjashtë muaj),
- Vërtetim për test të dhënë psikologjik ose test për integritet.
- Certifikatë nga mjeku (origjinal apo kopje të verifikuar në noter, jo më të vjetër se gjashtë muaj),

5. Fletëparaqitjet e pakompletuara në kuptim të pikës tre nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar.

6. Kohëzgjatja e afatit për paraqitje në konkursin publik është pesë ditë nga dita e publikimit të saj.

7. Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në konkursin publik, kandidatët ti dorëzojnë me postë apo në adresën e Ndërmarrjes publike për rrugë shtetërore në rr."Dame Gruev" nr. 14 Shkup apo personalisht në arkivin e Ndërmarrjes publike për rrugë shtetërore, në zarf të mbyllur me shenjë për konkurs publik për zgjedhje të Drejtorit.

Këshilli Drejtues i Ndërmarrjes publike
për rrugë shtetërore

REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16 dhe 142/16") dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 90/15"), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16") dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/15"), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 03/2018

për punësimin e 1 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komunën e Negotinës "për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101B04000 Udhëheqës i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat juridike ose Shkencat politike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) nëpërmjet posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombtarisht e të lëshuar nga testatorët oficialë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve të B1 niveli i CEFR, përkatësisht IELTS me 3,5 – 4,5 pikë, PET, BEK P, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 450 pikë, TOEFL CBT së paku 135 pikë ose TOEFL IBT së paku 45 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose certifikatë Gete.
njohja e gjuhës angleze mund të dëshmohet edhe me dorëzim të certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht nga STANAG 6001 standarde të NATO-s në nivelin përkatës, ku nëpunësit administrativë nga kategoria B3 dhe B4 duhet të posedojnë certifikatë me STANAG 2222

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 28.715,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Faza e 4 – të: Testi i personalitetit realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të fazës së 3 – të.

INSTITUCIONI PUBLIK PARKU
NACIONAL PELISTER MANASTIR

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (tekst i pastruar) (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15) Institucioni Publik Parku Nacional Pelister – Manastir, publikon

SHPALLJE

Për pranim të 8 (tetë) punëtorëve për kohë të pacaktuar – personel ndihmës teknik, me orar të punës prej ora 07 deri në ora 15, 40 orë në javë.

Kandidatët janë të obliguar së bashku me fletëparaqitjen të parashtrojë dëshmi për përmbushjen e kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, edhe atë:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore;
- Të mos jetë i dënuar.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara në Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet të parashtrojnë edhe dëshmi për përmbushjen e kushteve të posaçme të parapara në Statutin e Institucionit Publik Parku Nacional Pelister, Manastir dhe Rregulloren për sistematizim edhe atë për:

1. Bashkëpunëtor për meliorim dhe shfrytëzim të mirëmbajtur të resurseve natyrore..1 realizues
Me Arsim sipëror të mbaruar - 240 kredi, për fushën shkencore Klasifikimi ndërkombëtar Fraskativ: Pylltaria dhe hortikultura, me minimum përvojë pune prej 1 viti. Përparësi kanë kandidatët të cilët posedojnë Certifikatë për provim të dhënë profesional – rojtar në rajonin e mbrojtur.
Për vendin e punës është paparë neto pagesë prej..... 34.638,00 den.

2. Bashkëpunëtor për monitorim dhe mbrojtje të resurseve natyrore.....1 realizues
Me Arsim sipëror të mbaruar - 240 kredi, për fushën shkencore sipas Klasifikimit ndërkombëtar Fraskativ: Pylltaria dhe hortikultura ose Biologji, me minimum përvojë pune prej 1 viti. Përparësi kanë kandidatët të cilët posedojnë Certifikatë për provim të dhënë profesional – rojtar në rajonin e mbrojtur.
Për vendin e punës është paparë neto pagesë prej..... 34.638,00 den.

3. Bashkëpunëtor për mbrojtje nga zjarri dhe shënim për prerje private ….....1 realizues
Me Arsim sipëror të mbaruar - 240 kredi, për fushën shkencore sipas Klasifikimit ndërkombëtar Fraskativ: Pylltaria dhe hortikultura, me minimum përvojë pune prej 1 viti. Përparësi kanë kandidatët të cilët posedojnë Certifikatë për provim të dhënë profesional – rojtar në rajonin e mbrojtur.
Për vendin e punës është paparë neto pagesë prej.....34.638,00 den.

4. Bashkëpunëtor për mbrojtje nga sëmundjet.....1realizues
Me Arsim sipëror të mbaruar 240 ose 180 kredi, për fushën shkencore sipas Klasifikimit ndërkombëtar Fraskativ: Prodhimet blegtorale (blegtoria) ose Prodhimet bimore, me minimum përvojë pune prej 1 viti.
Për vendin e punës është paparë neto pagesë prej.....33.000,00 den.

5. Bashkëpunëtor për mbrojtje gjatë punës në terren .....1 realizues
Me Arsim sipëror të mbaruar 240 ose 180 kredi, për fushën shkencore sipas Klasifikimit ndërkombëtar Fraskativ: Shkencat organizative dhe menaxhim (menaxhment), me minimum përvojë pune prej 1 viti.
Për vendin e punës është paparë neto pagesë prej.....33.000,00 den.

6. Teknik i veterinarisë..... 1realizues
Me arsim të mesëm të mbaruar, Veterinari, me së paku 1 vjet përvojë pune, për vendin e punës është paparë neto pagesë prej.....25.944,00 den.

7. Rojtar në rajonin e mbrojtur.....1 realizues
Me arsim të mesëm të mbaruar, Përparësi kanë kandidatët të cilët posedojnë Certifikatë për provim të dhënë profesional – rojtar në rajonin e mbrojtur, me së paku 3 vjet përvojë pune.
Për vendin e punës është paparë neto pagesë prej.....25.944,00 den.

7. Punëtor i përgjithshëm..... 1 realizues
Me arsim të mesëm të mbaruar, me ose pa përvojë pune.
Për vendin e punës është paparë neto pagesë prej.....16.244,00 den.

Kandidatët e interesuar janë të obliguar fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm ta parashtrojnë në adresën në vijim:
Institucioni Publik Parku Nacional Pelister, Manastir, R. M (me shenjë për cilin vend pune do të konkurrojnë) në: rr. "Vienska" nr. 14, Manastir, Republika e Maqedonisë.
Kontakt telefoni: 047 233 464 ose 070 312 214
Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve është 5 (pesë) ditë pune, duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar vet ditën e shpalljes).
Hapjen, shqyrtimin dhe zgjedhjen e kandidatëve do ta realizojë Komisioni në afat prej 45 ditëve nga dita e fundit e caktuar për paraqitje.
Fletëparaqitja e dorëzuar pas afatit, jo e plotë dhe e parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga ana e komisionit.

Për IPPN Pelister – Manastir,
Drejtor
Amet Axhiu

Në bazë të nenit 128 Paragrafi 3 të Ligjit për mbrojtje të konsumatorëve, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 38/04, 77/07, 103/08, 24/11, 164/13, 97/15 dhe 152/15) në bazë të pjesës B. Aktivitetet për vitin 2018, Pika 1. Ministria e Ekonomisë, nga Programi për mbrojtjen e konsumatorëve për periudhën 2017-2018 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë "nr. 192/16), Ministria e Ekonomisë shpall:

THIRRJE PUBLIKE
Për ndarje të mjeteve financiare për realizimin e Programit (projektit) të shoqatave të konsumatorëve

1. LËNDA: ndarja e mjeteve financiare për realizimin e programit (projektit), të cilin do ta realizojnë shoqatat e konsumatorëve**.**

2. MJETE I NDANË: Ministria e Ekonomisë, rr. „Jurij Gagarin"nr. 15, Shkup.
Mjetet në vlerë prej 550.000 denarësh, janë të siguruara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, për vitin 2018, në bazë të Programit për mbrojtjen e konsumatorëve për periudhën 2017 - 2018 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 192/16).
Afati i fundit për pranimin e ofertave, është më së voni deri më ora 16.00, në datën **12.02.2018 (e hënë).**
Informata më të hollësishme lidhur me Thirrjen e Shpallur Publike mund të gjeni në UEB-faqen e Ministrisë së Ekonomisë : www.economy.gov.mk.

Tel: ++389 2 30 93 433
Fax: ++389 2 30 84 901

Ministria e Ekonomisë

I. Nr. 324/2014

SHPALLJE PUBLIKE
(në bazë të nenit 46-b, të Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për përmbarim, Gazeta Zyrtare nr. 8 të datës 17.01.2008)

Përmbaruesi Vanço Markovski duke vepruar me propozim të kreditorit Eshref Ajruli, përmes aut. avokatit Branko Trajkovski nga Tetova dhe vendbanim në rr. Drenoec – Poroj nr. 8, kundër borxhliut Husein Memedi nga Tetova me NVAQ dhe vendbanim në rr. Lubo Bozhinovski Pish nr. 69, dhe borxhliut pengmarrës Imer Shaqiri nga Tetova me NVAQ dhe vendbanim në rr. Lubotenska nr. 69 në Tetovë, për shkak të realizimit në holla në shumë prej 24.600.000,00 denarë **më datë 26.01.2017**

FTON

Borxhliun pengmarrës Imer Shaqiri nga Tetova me NVAQ dhe vendbanim në rr. Lubotenska nr. 69 në Tetovë të paraqitet në zyrën e përmbaruesit Vanço Markovski në rr. Ilindenska nr. 64 Tetovë, për parashtrim të akteve në vijim: Konkluzion për shitje publike me gojë I nr. 324/2014 të datës 15.01.2018, Konkluzion për përcaktim të vlerës nga data 15.01.2018 dhe Konkluzion për mënyrën e shitjes së patundshmërisë I nr. 324/2014 të datës 15.01.2018, **NË AFAT PREJ 1 (NJË) DITE**, duke llogaritur nga dita e publikimit të fundit të kësaj thirrje publike në shtypin ditor.

PARALAJMËROHET borxhliu pengmarrës Imer Shaqiri se mënyra e këtillë e dorëzimit llogaritet si dorëzim në rregull dhe se për pasojat negative që mund të dalin i bartë vet pala.

Kjo shpallje paraqet **PUBLIKIMIN E DYTË** të thirrjes publike

PËRMBARUES
Vanço Markovski

URGJENTISHT
Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

FEDERATA E MUNDJES SË MAQEDONISË SHPALLI MË TË MIRËT

KM "LIRIA", KLUBI MË I MIRË PËR VITIN 2017

Mundësi i natyralizuar dhe anëtari i Klubit të Mundjes "Vardar", Mogamedxhi Nurov u shpall mundësi më i mirë i vitit 2017, ndërsa çmimi për ekipin më të mirë shkoi në sirtarin e Klubit të Mundjes "Liria", që la pas Ballkanecin dhe Tefejuzin. Drejtuesit e mundjes vendore premtuan se vitin e ardhshëm do të ketë edhe shpërblime në të holla për më të mirët nga sporti i mundjes

Shkup, 29 janar - Federata e Mundjes së Maqedonisë pas një pauze të gjatë riktheu traditën e përcaktimit të mundësve më të mirë të vitit që lamë pas. Mundësi i natyralizuar dhe anëtari i Klubit të Mundjes "Vardar", Mogamedxhi Nurov u shpall mundësi më i mirë i vitit 2017, ndërsa çmimi për ekipin më të mirë shkoi në sirtarin e Klubit të Mundjes "Liria", që la pas Ballkanecin dhe Tefejuzin. Drejtuesit e mundjes vendore premtuan se vitin e ardhshëm do të ketë edhe shpërblime në të holla për më të mirët nga sporti i mundjes. "Kjo traditë do të jetë për çdo vit sa do të jem kryetar un, do të zhvillohet për çdo vit dhe mendojë se për çdo vit do të ketë edhe risi të reja . Për mundësit më të mirë do të ketë ndonjë shpërblim tjetër , në të holla ose ndonjë bursë, në koordinim me Këshillin Profesional të Federatës", deklaroi për "Alsat-m" Betim Vrenezi, president i Federatës së Mundjes të Maqedonisë. Ndryshe, në konkurrencën e juniorëve çmimi shkoi në duart e Elmedin Sejfullahut nga KM "Liria", ndërsa në konkurrencën e kadetëve, Aid Salihasi nga KM "Tefejuz" nuk kishte konkurrencë. Besir Alili nga KM "Liria" u shpall mundësi më i mirë në konkurrencën e juniorëve, ndërsa mundësia më e mira është Bojana Lazarevska nga KM "Bezbednost". Davor Tasev dhe Sufijan Ismaili u shpallën trajnerët më të mirë për vitin 2017, çmimi i referit më të mirë i takoi Marjan Lazarevit dhe Ilço Markoskit, derisa nënkryetari i klubit "Liria" Amet Ademi, u shpall punëtori sportiv me i suksesshëm. Gjithashtu, Federata e Mundjes së Maqedonisë ndau mirënjohje për Komitetin Olimpik, Agjencinë për Rini dhe Sport, por edhe për përfaqësuesin e FILA-s, Kiril Latev. "Mundja nuk është në atë nivel të cilën e dëshirojmë dhe në atë nivel në të cilin ishte vite më parë. Mirëpo jemi në rrugë të mbarë që të rikthejmë atje ku e ka vendin dhe ku meriton që të jetë. Dhe që mundjen e respektojmë dhe duam është fakti se në Lojërat Olimpike në Buenos Aires edhe pse nuk kishim normë, ne siguruam një uajld kartë për mundjen dhe një mundës nga Maqedonia do të jetë pjesëmarrës në Gojart Olimpike për të rinj "Buenos Aires 2018", tha për "Alsat-m" Vladimir Bogoevski, drejtor i Komitetit Olimpik të Maqedonisë.

Seferi rikthehet nga lëndimi i gjatë

Shkup, 29 janar - Ka marrë fund makthi nga lëndimet për talentin shqiptar nga Kumanova, Taulant Seferi. Mesfushori anësori i Kombëtares së Shqipërisë U21 ka qenë i lënduar në dy vitet e fundit. Por, ai nuk është dorëzuar në asnjë moment dhe ka punuar shumë për tu rikthyer në fushë. 22-vjeçari është rikthyer në fushë dhe ka luajtur dy ndeshje miqësore me Jang Bojsin bën të ditur "Telegrafi". Ai tani pritet të luaj edhe në elitën e futbollit zviceran për ta ndihmuar skuadrën e tij drejt objektivave. Jang Bojsi është në garë për titullin e kampionit pasi po kryeson kampionatin me 40 pikë. Cekim, Seferi ka kontratë me Jang Bojsin deri në qershor të vitit 2019.



SHKËNDIJA VAZHDON PËRGATITJET NË ANTALIA

Dinamo, kundërshtari i radhës

Shkup, 29 janar - Kushtet e shkëlqyeshme dhe moti shumë i mirë sinkronizohen me atmosferën e kuqezinjve në përgatitjet dimërore që vijojnë në Antalia të Turqisë. Faqja zyrtare e klubit njofton se skuadra dje ka zhvilluar dy seancat e radhës stërvitore me intensitet të shtuar, ushtrime force në palestër dhe pjesën tekniko-taktike në terren. Vetëm Cuculi vazhdon terapinë intensive te rikuperimit dhe punën në terren e kompenson në pishinë. Gjithë futbollistët tjerë me profesionalizëm maksimal u përgjigjen kërkesave të stafit teknik, të bindur se puna e tashme do

të jetë "bagazh" për gjithë gjysmësezonin pranveror ku skuadra do të kërkojë trofe. Cekim, djemtë e trajnerit Qatip Osmani deri më tani kanë zhvilluar dy ndeshje kontrolluese, duke pësuar një humbje (Cyrih 2:1) dhe një fitore (Olimpik Donjekc 4:1), derisa sot (e martë) e zhvillojnë ndeshjen e tretë përballë Dinamo Zagrebit.

Renova barazon ndaj Javorit

Skuadra e Renovës ka vazhduar me fazën përgatitore, ndërsa në kuadër të përgatitjeve ka luajtur edhe ndeshjen e radhës kontrolluese. Kundërshtari i fundit i Renovës ishte ekipi serb Javor, me të cilët u ndanë me rezultatin 0:0. Renova deri më tani ka luajtur edhe dy ndeshje tjera kontrolluese, ku ka shënuar fitore 1:0 ndaj Pobedës dhe 5:0 ndaj Vëllazërimit të Kërçovës. Ndeshjen e radhës Renova e luan me 31 janar kundër skuadrës serbe Maçva.

Abdurahimi zyrtarizon kalimin te Partizani

Partizani ka vijuar dje përgatitjet në prag të sfidës së parë ndaj Flamurtarit, e vlefshme për turin çerekfinal të Kupës së Shqipërisë. Seanca e radhës, e para pas humbjes minimale në Vlorë, për kampionat, është zhvilluar në orën 16:30, në ambientet e "Qendrës Stërvitore të Ekipeve Kombëtare", Kamëz. Me grupin është bashkuar edhe ish-lojtari i Shkëndijës së Tetovës, Besart Abdurahimi. Sulmuesi ka zhvilluar normalisht programin stërvitor me pjesën tjetër të ekipit. Ndryshe, me ardhjen e ish-sulmuesit të Shkëndijës së Tetovës rritet konkurrenca në vijnë sulmuese dhe stafit i del më shumë punë e përgjegjësi për të përzgjedhur formacionin e duhur, pasi alternativat janë shtuar. Abdurrahimi është një armë më shumë për krahun e djathtë të sulmit, rol të cilin te Partizani e kanë ushtruar, Asani, Progni, por edhe Bardhi me Filin. 27-vjeçari i kombëtares së Maqedonisë mund të përshtatet në krahë në shërbim të "pykës", por mund të luajë edhe me skemën me dy sulmues.

AMIR KHAN SËRISH NË RING

MË 21 PRILL PËRBALLË FIL LO GRECO

Mezi po pres që të rikthehem sërish në ring. mezi po e pres datën 21 prill", tha Amir Khan për mediat. "E di që do të kam pak të vështirë në fillim dhe Lo Greko do të vijë për të fituar, por nuk do t'i jap asnjë shans, nuk do ta lejoj asnjë centimetër që të më afrohet", shprehet Khan

Pritja e gjatë e boksierit Amir Khan do të marrë fund më 21 prill, kur do të përballet me Fil Lo Greko në "Echo Arena" të Liverpulit. Kjo do të jetë sfida e parë e ish-kampionit të botës në peshën "welter" pas dy vitesh. Lajmin e ka konfirmuar vetë boksieri britanik. "Mezi po pres që të rikthehem sërish në ring. mezi po e pres datën 21 prill", tha Amir Khan për mediat. "E di që do të kam pak të vështirë në fillim dhe Lo Greko do të vijë për të fituar, por nuk do t'i jap asnjë shans, nuk do ta lejoj asnjë centimetër që të më afrohet. Është një boksier agresiv dhe që gjithnjë ushtron presion gjatë duelit. Kjo do ta bëjë mjaft interesante sfidën me mua dhe për fansat. E respektoj si boksier, që vjen me ambicie të mëdha, por edhe unë kam ambiciet e mia", shtoi më tej Khan. "Unë dua t'i tregoj gjithë botës që jam rikthyer sërish në ring për të qenë sërish kampion", përfundoi 31 vjeçari. Britaniku numëron 31 fitore (19 prej tyre me KO) dhe 4 humbje në karrierën e tij, ndërsa kanadezi Fil Lo Greko, 33 vjeç, ka zhvilluar 31 duele si profesionist, ka arritur 28 fitore (15 me KO) dhe pësuar 3 humbje.

TALENTI QË NUK SHKËLQEU KURRË

Krkiç përjashtohet edhe nga Alavesi!

Kur ishte adoleshent vishte fanellën e Barcelonës dhe konsiderohej si talenti më i pastër i futbollit spanjoll. Statistikat e tij janë ende sot e kësaj dite më të mirat në Akademinë e Barcelonës, me 648 ndeshje zyrtare me moshat në harkun e 7 viteve dhe mbi 900 gola. Debutimi në La Liga erdhi në vitin 2007 dhe ishte shumë shpresëdhënës, por që atëherë dhe deri tani karriera e Bojan Krkiç nuk mori kurrë drejtimin që pritej. Në vitin 2011 u largua nga Katalonja dhe nisën disa përvoja zhgënjyese në Itali, Holandë, Angli dhe Gjermani. Në shtatë vitet e fundit ka veshur fanellën e 6 klubeve të ndryshme, por pa arritur asnjëherë të lërë shenjë. Stok Siti e huazoi te Alaves, skuadra në vendin e 16-të në kampionatin spanjoll, por te bardheblutë koleksionoi vetëm 4 ndeshje në të gjitha veprimtaritë.



I përjashtuar nga ndeshja e fundit e Kupës së Mbretit, djaloshi u grind me drejtori sportiv Sergio Fernandez dhe në këto kushte klubi e përjashtoi, teksa Stok nuk ka ndërmend ta rikthejë në "Britania Stadium", duke sjellë rrezikun që Krkiç të qëndrojë për pesë muaj pa luajtur. E vetmja mundësi për momentin për futbollistin është që tifozët e "Potters", me të cilët ka një marrëdhënie shumë të mirë, të shtyjnë klubin ta rikthejë në Premier Ligë për ta vënë në dispozicion të ekipit për pjesën e dytë të sezonit. Gjithsesi, Krkiç do të mbahet mend si historia e talentit që nuk çeli kurrë.

VALENTINO ROSSI OPTIMIST

Një ndjesi fantastike me motorin e ri

"Kam pasur një ndjesi fantastike me motorin e ri, që nuk i kisha provuar gjatë vitit të kaluar", ka deklaruar piloti italian i Jamahas, Valentino Rossi në përfundim të ditës së parë të testeve dimërore, që po zhvillohet në pistën e Sepang të Malajzisë. Një sinjal ky që sipas 9 herë kampionit të botës në Moto GP i jep atij shumë optimizëm për të ardhmen. "Duhet ende të punojmë shumë për të pasur një motor kompetitiv, pasi nuk kemi qenë shumë të saktë në pistë, por ndjesia që provova ishte mjaft e mirë", tha piloti italian. Valentino Rossi shton se motori nuk ishte i shpejtë në pistën e lagur, por kompetitiv në pistën e thatë. "Në një pistë të lagur gjërat shkuan normalisht, nuk patëm ndonjë sukses të madh. Por në pistë të thatë ishim shumë të shpejtë dhe kjo është shumë e rëndësishme. Telajo është ndërtuar duke pasur për bazë motorin e vitit 2016 dhe ky është një start i mirë për këtë sezon. Për fat, testet do të vijojnë dhe janë të rëndësishme për të pasur një motor kompetitiv që në start të sezonit", deklaroi Rossi.



Publicitet

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

ADVERTISEMENT FOR APPOINTMENT OF RECTOR

As the current Rector's term is coming to an end in August this year, the South East European University (SEEU) (www.seeu.edu.mk) is launching the procedure, in accordance with the Law and the University Statute, for appointment of a rector. SEEU is a private-public not-for-profit University of about 4000 students, with five Faculties (Law, Public Administration, Business and Economy, Contemporary Sciences and Technologies, Languages Cultures and Communications), with its main academic centre in Tetovo and another centre in Skopje. The Rector is the chief executive officer of the University, leading a small management team and reporting to a Board, made up of international and national members, which is the appointing body. The essential requirements for the position are:

(i) holding the academic title of full professor recognised in the Republic of Macedonia,
(ii) experience of management preferably gained in a university setting,
(iii) enthusiasm for developing SEEU's distinctive mission.

All interested candidates fulfilling the criteria are welcome to apply. Preference will be given to candidates with a good command of the three working languages of the University (Albanian, Macedonian and English).
The term of appointment is four years.The **Application package** as well as further particulars of the position and the procedure may be obtained from the Secretary-General, Mr Xhevair Memedi (x.memedi@seeu.edu.mk).
Applications using the prescribed form (only) must be received through e-mail by the Secretary-General by 19 February 2018. Informal enquiries may be made of the President of the University Board, Dr Dennis Farrington (d.farrington@seeu.edu.mk).
Advertopening date: 29 January, 2018
Advertclosing date: 19February, 2018

Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor
dhe Planifikimit Hapësinor

МКД СЕРТИФИКАТ
MKC EN ISO 9001:2009

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë

SHPALL
Vendim për bartje të tërësishme e A- Lejes së harmonizuar me plan operativ

Nga: NN GEOTEHNIKA DOOEL – Shkup
Tek: DGR GRADBA PROMET doo Kavadar

Drejtoria për mjedis pranë MMJPH përgatiti:

Vendim për bartje të tërësishme e A-Lejes së harmonizuar me plan operativ

Nga: NN GEOTEHNIKA DOOEL – Shkup
Tek: DGR GRADBA PROMET doo Kavadar

Vendimi për bartjen e tërësishme të A-Lejes së harmonizuar me plan operativ do të jetë e publikuar në ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor www.moepp.gov.mk
Informata në lidhje me lejen, publiku i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në numrin e telefonit 02-3213-651 ose në e-mailin: f.baliu@moepp.gov.mk
Publiku i interesuar në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit në mjetet për informim mund të dërgojë vërejtjet e veta në lidhje me Vendimin për bartjen të tërësishme e A-Lejes së harmonizuar me plan operativ në formë të shkruar deri tek Ministria për mjedis jetësor dhe Planifikim Hapësinor në adresën në vijim: Bulevardi "Goce Dellçev" nr. 18 (Ndërtesa e MTV-së), 1000 Shkup.

Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

Bul."Goce Dellçev" nr.18,
1000 Shkup,
Republika e Maqedonisë
Tel. (02) 3251 400
Faksi. (02) 3220 165
E-mail:
infoeko@moepp.gov.mk
Ueb faqja: www.moepp.gov.mk

AUBAMEJANG
TEK ARSENALI ËSHTË VETËM ÇËSHTJE KOHE

Aubamejang luajti në barazimin e Dortmundit me Fraiburg, të shtunën, mes pretendimeve nga ana e klubit të Bundesligës se një transferim do të sanksionohet nëse Arsenali arrin "parametrat e caktuar"

Arsenali është në prag të përfundimit të nënshkrimit me Pierre-Emerik Aubamejang nga Borussia Dortmund, pasi klubet u pajtuan në parim për një pagesë prej 60 milionë sterlinash. Aubamejang, 28 vjeç, ka qenë subjekt i negociatave midis "Topçinjve" dhe Dortmundit për disa javë, me Arsenalin që ka refuzuar të përmbushë çmimin e kërkuar prej 70 milionë sterlinash nga klubi i Bundesligës. "Goal" kupton se gabonezi ndërkombëtar tashmë ka pranuar kushtet personale me londinezët e veriut, me një njoftim zyrtar për të arritur në ditët e ardhshme. Sulmuesi, i cili shënoi 31 gola në sezonin e kaluar, u la jashtë dy ndeshjeve radhazi nga Dortmundi, pasi humbi një stërvitje ekipore. Megjithatë, Aubamejang luajti në barazimin e Dortmundit me Fraiburg, të shtunën, mes pretendimeve nga ana e klubit të Bundesligës se një transferim do të sanksionohet nëse Arsenali arrin "parametrat e caktuar". "Ne jemi të gatshëm të biem dakord për një transferim nën disa parametra, por vetëm nëse këto janë përmbushur plotësisht", – tha drejtori sportiv Mihael Zork për televizionet gjerman. "Kemi një qëndrim të qartë: Arsenali ka bërë disa përpjekje deri më tani, por e kemi refuzuar". Aubamejang do të bashkohet me ish-bashkëlojtarin e ekipit të Dortmundit, Henrikh Mikitarian tek Arsenali, pasi armeni kaloi te "Topçinjtë" falë një marrëveshjeje shkëmbimi, që e pa Aleksis Sançez te Mançester Junajtedo. Kjo është dyshja e kombinuar e 62 golave në të gjitha garat, dy sezone më parë. Këtë sezon, Aubamejang ka shënuar 21 gola në 24 ndeshje, në të gjitha garat.

Bejll i vendosur të rikthehet në Angli

Largimi i shumëpërfolur i Geret Bejll nga Real Madridi në verën e kaluar mund të realizohet at të ardhshmen. Në fakt, sipas "Diario Gol", ylli i madrilenëve duket se është i vendosur të kthehet në Premier Ligë dhe të veshë fanellën e Mançester Junajtedit. Kështu, pas Aleksis Sançez, Hoze Murinjo mund të përforcojë ekipin e tij me një tjetër "big", i cili ka një vlerë prej 75 milionë eurosh në merkaton, por ka shumë mundësi që ky çmim të rritet ndjeshëm nëse lojtari do të këmbëngulë të largohet. Uellsiani, i cili ka veshur në të kaluarën fanellat e Sautemptonit dhe Totenhemit në Premier Ligë, ka luajtur 18 ndeshje në këtë sezon, në të cilat ka realizuar 9 gola dhe ka dhënë pesë asistime.



Pakti sekret mes Nejmar dhe Perez ka Ronaldon ndërmjet

"Neymar do të vazhdojë sezonin e ardhshëm te PSZH-ja me 2000 për qind", këto ishin fjalët e presidentit të klubit parisien, Al-Khelaifi, kur u pyet në lidhje me një transferim të mundshëm të yllit braziliat te Real Madridi në verën e ardhshme. Sheiku i PSZH-së është shumë i qartë dhe i prerë duke mohuar kategorikisht shanset që të ndodhë transaksioni aq i përfolur prej kohësh. Por, presidenti i "Los Blancos", Florentino Perez e ka mes vetullave të tij dhe është i bindur se herët a vonë, Nejmar do të veshë fanellën e bardhë. Në fakt, sipas "Don Balon", mes brazilianit, përfshirë përfaqësuesit e tij dhe Real Madrid ka një pakt. Një pakt për të cilin të dy palët kanë rënë dakord që ta negociojnë në të ardhmen. Florentino Perez është i ndërgjegjshëm se PSZH nuk do ta lërë të lirë Nejmar këtë verë, vetëm një vit pasi klubi parisien pagoi 222 milionë euro për ta "rrëmbyer" nga Barcelona. Prandaj, Perez është rikthyer te plani i tij fillestar, të negociojë për vitin e ardhshëm, 2019. Sepse refuzimit të PSZH, i shtohet edhe një tjetër problem, vendi i

Kristiano Ronaldo. Transferimi i portugezit është më se i vështirë në këtë moment. Florentino konsideron vetëm një opsion, të presë që Kristiano të largohet në MLS në verën e 2019 dhe pastaj të "rrëmbejë" NeJmar. Pas dy viteve në Paris, PSZH mund të jetë më i hapur ndaj negociatave për një transferim që do të ishte një rekord tjetër botëror. Ajo që duket e qartë sipas medias spanjolle është fakti që Nejmar ka pranuar se Real Madrid do të sulmojë për atë dhe është i gatshëm të presë edhe një vit tjetër.

De Gea nuk jep shenja se do të lëvizë nga Junajtedi

Rinovimi i Kepa me Atletik ka vendosur edhe një herë David de Gea në mesin e kandidatëve për të mbrojtur portën e Real Madridit. Portieri ishte gati të nënshkruante për Real Madridin në atë operacion të frustruar nga faksi në vitin 2015. Që atëherë kanë kaluar dy vite e gjysmë dhe ndërkombëtari spanjoll tashmë është në sezonin e tij të shtatë te Mançester Junajtedi. Një periudhë që De Gea e ka rishikuar në mediat zyrtare të Premier Ligës, përmes një deklarate, në të cilën ai thotë se është shumë i lumtur

për kohën që ka qenë në Angli, duke mos treguar shenja se dëshiron të lëvizë nga "Old Trafford". "Po luaj sezonin e shtatë te Mançester Junajtedi dhe jam shumë i lumtur me gjithë kohën që kam kaluar këtu. Shumë gjëra kanë ndodhur, shumë prej tyre janë vërtet të mira, një ose dy gjëra nuk kanë qenë aq të mira, por jam shumë i lumtur. Duke shikuar prapa, kanë qenë shtatë vite fantastike", deklaroi De Gea.

LAJME SHKURT

Dortmundi i rrëmben Barçës talentin Gomez

Barcelona humb një nga perlat e La Masia dhe është Borussia Dortmundi që arrin ta rrëmbejë lojtarin nga akademia e katalanasve. Bëhet fjalë për Sergio Gomez, i cili shkëlqeu edhe në Botërorin për 17-vjeçarët. Dortmund arriti ta bindte duke i premtuar se do të luajë që këtë sezon me ekipin e parë. Për ta marrë nga Barcelona, klubi gjerman pagoi klauzolën për vetëm 3 milionë euro, ndërsa sulmuesi premtues do të firmosë kontratën e parë të rëndësishme deri në vitin 2022.

Lajiç nuk largohet nga Torino

Kur kanë mbetur pak ditë nga mbyllja e merkatos së janarit, te Torino merr fund edhe saga "Adem Lajiç". Fantazisti serb, i cili nuk luante në ndeshjet e fundit me Mihajloviç në stol, por as tani me Mazzarrin, dukej shumë pranë firmës në Rusi me Spartak Moskë, por presidenti Urbano Kairo ka vendosur veton. Pas një takimi me Mazzarrin dhe Drejtorin Sportiv, Petraki, numri 1 i klubit granata deklaroi se Lajiç nuk ka shanse të largohet edhe pse nuk po luan, por ai u shpreh se lojtari do të ketë shanset e tij deri në fund të sezonit.

Uest Hem rikthen Pellen

Afrimi i Zhoao Marios në huazim nga Interi nuk e ka mbyllur merkaton e Uest Hemit, që po tenton të blejë një sulmues në ditët e fundit të këtij sesioni. Drejtuesit e klubit kanë shënjestruar Graziano Pelle i cili ka luajtur më parë te Sautemptoni dhe mund të largohet nga Shandong Luneng. Për 32-vjeçarin problemi mbetet te paga tepër e lartë prej afro 15 milionë eurosh në sezon të cilën duhet ta reduktojë ndjeshëm ndërsa akordi ekonomik mes dy klubeve është drejt mbylljes me sukses.

Remy largohet nga Las Palmasi

Loik Remy ndryshon skuadër, por nuk rikthehet te Çellsi. Sulmuesi francez që është në pronësinë e "Bluve të Londrës" është larguar nga Las Palmas ku ndodhej në huazim për shkak të problemeve të kishte me trajnerin Pako Jemez dhe kalon me të njëjtën formulë te Getafe. Skuadra nga periferia e Madridit mund ta blejë kartonin e 31-vjeçarit për 1.5 milionë euro në verë nga Çellsi, ndërsa për të qëndruar në Spanjë, Remy refuzoi një ofertë rë rëndësishme nga Uatford.

SHTATË SHKARKIMET MË TË PAMËSHIRSHME NË HISTORINË E FUTBOLLIT

Di Matteo, një legjendë e Çellsit, i udhëhoqi "Blutë" drejt triumfit të parë në Çampions Ligë dhe fitoi Kupën e Anglisë para se të shkarkohej vetëm tetë muaj pasi kishte marrë drejtimin e ekipit

Bota e futbollit është një botë e pamëshirshme, veçanërisht kur mungojnë rezultatet. Por, në disa raste, as arritja e objektivave nuk mjafton. Këto janë shtatë shkarkimet më të pamëshirshme në historinë e sportit më popullor në botë.

Klaudio Ranieri
Shkarkime: 6

Ranieri është ka fituar çmimin e Trajnerit të Vitit nga FIFA pasi fitoi Premier Ligën me Leiçester, por skuadra luftoi për mbijetesë sezonin pasardhës dhe "dhelprat" nuk u menduan dy herë për t'i thënë lamtumirë.

Rafa Benitez
Shkarkime: 4

Komunikimi i keq, mospëlqimi i tifozëve, pakënaqësia e lojtarëve dhe rezultatet negative kanë sjellë shkarkimin e tij Rafa Benitez te Real Madrid në mes të sezonit.

Karlo Ançeloti
Shkarkime: 5

Ai, bashkë me legjendën e Liverpulit, Bob Paislej, janë dy trajnerët e vetëm që e kanë fituar tri Çampions Liga. Por italiani e ka bërë këtë me dy skuadra të ndryshme (2 me Milan dhe 1 me Real Madrid). Gjithashtu, ai ka shkuar në finalen e kompeticionit evropian më të rëndësishëm për klube plot katër herë. Çellsi e ka shkarkuar pasi ka dalë i dyti në Premie Ligë, një vit pasi e kishte fituar kampionatin.

Roberto Di Matteo
Shkarkime: 3

Di Matteo, një legjendë e Çellsit, i udhëhoqi "Blutë" drejt triumfit të parë në Çampions Ligë dhe fitoi Kupën e Anglisë para se të shkarkohej vetëm tetë muaj pasi kishte marrë drejtimin e ekipit.

Roy Hodgjson
Shkarkime: 5

Hodgjson është shkarkuar nga Kristal Palas vetëm pak orë pas nënshkrimit të kontratës dhe pa pasur mundësinë të drejtonte asnjë ndeshje. "Nuk shikova asnjë rezultat", tha pronari i Palas, Stiv Parish.

"Njerëzit thonë se ai nuk pati mundësinë të drejtonte asnjë ndeshje, por unë them se pati 40 minuta në dispozicion për të vënë në punë planin e tij dhe nuk kishte asnjë shenjë për këtë".

Avram Grant
Shkarkime: 2

Kur ishte në drejtim të Çellsit, ai nuk humbi asnjë ndeshje në shtëpi, ishte finalist i Kupës së Ligës, doli i dyti në Premier Ligë dhe humbi finalen e Çampions Ligës pas penalltive.

Kris Hujton
Shkarkime: 1

Ai mori drejtimin e Njukasëll në një kohë kur skuadra ishte në krizë dhe e ndihmoi të fitonte Çampionshipin, por u shkarkua në sezonin pasardhës, teksa skuadra mbante vendin e 11-të në Premier Ligë.

Toti ka një mesazh për Buffonin

Françesko Toti, drejtues i Romaës, që është tërhequr nga futbolli i luajtur në fundin e sezonit të kaluar, i ka dhënë një mesazh Gjanluigji Buffon. "Përshëndetje Gigione, 40 vjeç, sa bukur! Fatkeqësisht unë i kam kaluar. Nuk e di nëse do të tërhiqesh apo do të vazhdosh, vendos ti. Mos i lër të tjerët ta bëjnë, do të ishte gjëja më e keqe. Të puth dhe të dua të mirën!", këto kanë qenë fjalët e tij, të publikuara nga mediat italiane. Ndryshe, Buffon ka mbushur 40 vjeç të dielën dhe nuk ka bërë akoma të ditur se çfarë do të bëjë në fundin e këtij sezoni. Ndjesia e përgjithshme është se ai do të tërhiqet për t'i hapur rrugën të rinjve, siç ka thënë edhe vetë. Por gjithçka mund të varet nga ecuria në Ligën e kampionëve e Juventusit. Nëse bardhezinjtë e fitojnë këtë vit, tërheqja e Buffon do të ishte e sigurt, nëse jo numri 1 i bardhezinjve mund të vendosë të vazhdojë edhe një vit.

Federata Gjermane reagon pas dëmtimit të Sane

Mançester Siti u kualifikua në fazën e 1/8-ave të "FA Cup", duke triumfuar 0-2 ndaj Kardifit, por kostoja e këtij triumfi ishte mjaft e madhe për skuadrën e Guardiolës. Futbollisti vendas Josep Bennett, bëri një ndërhyrje mjaft të rëndë ndaj talentit gjerman, LeroJ Sane, duke i shkaktuar një dëmtim mjaft të rëndë, çka bëri që djaloshi të largohej menjëherë për të kryer analizat e detajuara.

Për dëmtimin e Sane ka reaguar edhe Federata Gjermane e Futbollit, që në "Twitter" i ka kërkuar klubit uellsian të ketë kujdes me futbollistët gjermanë, pasi luajnë një eveniment të rëndësishëm në verë. Ndërkohë, ylli i Mançester Sitit Leroy Sane mund të mungojë për disa muaj pas dëmtimit në kavilje, zbulon trajneri i tij Pep Guardiola. "Ai do të qëndrojë jashtë për një kohë, disa javë ose muaj, do të shohim", deklaroi Guardiola.

Reali në epërsi para sfidës me PSHZ-në

Eliminimi nga Kupa e Mbretit ka qenë një goditje e rëndë për Real Madridin, veçanërisht kur mendon se madrilenët janë edhe jashtë luftës për titull në kampionat. Megjithatë, ai eliminim do të ketë diçka pozitive që mund të rezultojë vendimtare në përballjen e dyfishtë të Ligës së kampionëve kundër Paris Sen-Zhermenit. Në fakt, "Los Blancos" do të luajnë gjysmën e ndeshjeve në krahasim më rivalët francezë. Para ndeshjes së parë me PSZH, lojtarët e Zinedin Zidan do të luajnë në kampionat kundër Levantes dhe Real Sosiedadit, ndërsa ekipi i Unai Emeri do të luajë në Kupën e Ligës së Francës kundër Rennes, kundër Lill në kampionat, kundër Soshos në Kupën e Francës dhe kundër Tulus në Ligue 1. Kështu, Parisi do të jetë në fushë për 360 minuta, ndërsa Reali për 180. Mënyra sesi Emeri do t'i menaxhojë këto minuta mund të rezultojë vendimtare para sfidës së parë, që do të zhvillohet në "Santiago Bernabeu" 14 shkurtin e ardhshëm.

DASHI 21. mars - 20. prill

Do merreni shume me jetën tuaj ne çift gjate kësaj dite dhe do mundoheni me çdo kush ta largoni rutinën. Partneri do ketë menduar për një surprize te mrekullueshme. Beqaret duhet te mendohen mire nëse personi qe do takojnë iu përshtatet aq sa duhet apo jo. Mos merrni vendime te nxituara. Klima ne planin financiar do jete e trazuar. Kujdes me shpenzimet sepse do keni probleme.

DEMI 21. prill - 21. maj

Marrëdhënia ne çift do jete goxha e mire gjate kësaj dite. Do kuptoheni edhe me një shikim me atë qe keni ne krah dhe do e toleroni pak me tepër se me pare. Beqaret me ne fund do realizojnë takimin e shumëpritur dhe do ndihen te plotësuar. Urani do ua mbroje financat gjete gjithë kohës dhe do iu beje me te kthjellet ne këtë sektor. Nuk pritet asnjë problem.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Ekuilibri do mbizotëroje gjate gjithë kësaj dite ne jetën sentimentale te çifteve. Do flisni hapur me partnerin tuaj dhe do i zgjidhni sa hap e mbyll sytë problemet qe keni pasur. Për beqaret ka ardhur momenti i duhur për te joshur. Personat do jene me te vërtetë te mrekullueshëm. Ne planin financiar do jeni me shume fat. Do arrini edhe te shpenzoni edhe te hiqni disa para mënjanë.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Tregohuni me realiste sot ne jetën tuaj ne çift dhe mos kërkoni qe partneri t'iu beje surpriza te jashtëzakonshme. Mos mendoni se jeta reale është si ne një fil sepse do zhgënjeheni. Nëse jeni ende vetëm, do iu duhet te prisni edhe pak për te gjetur personin me te përshtatshëm. Ne planin financiar mos ndërmerrni shume rreziqe sepse do bëni gabime.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Dite mjaft harmonike kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do jeni me te sjellshëm dhe me tolerante me partnerin. Disa do mendojnë edhe për një bashkëjetesë. Beqaret dhe sidomos meshkujt nuk duhet te bëjnë sakrifica te mëdha për te gjetur dashurinë. Lërjani çdo gjë kohës. Ne planin financiar do ketë përmirësime te njëpasnjëshme te situatës.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Dite përgjithësisht e qete dhe aspak problematike kjo e sotmja për te dashuruarit. Do keni një komunikim te mire dhe nuk do ua vini veshin atyre qe do iu thonë te tjerët. Edhe beqaret do kalojnë momente te mrekullueshme dhe mjaft emocionuese. Jupiteri do iu sjelle fat ne planin financiar dhe do arrini te kryeni investimet e menduara prej kohesh.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Qëndrueshmëria do mbizotërojë gjate gjithë kësaj dite ne jetën tuaj ne çift. Do jeni me humor te mire dhe ka mundësi te flisni edhe për disa tema delikate qe iu kane shqetësuar prej kohesh. Beqaret do kenë disa takime, por nuk është shume e mundshme qe te krijojnë një lidhje afatgjate. Situata financiar do ketë disa ndryshime pozitive. Me ne fund!

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Yjet do i ndihmojnë çiftet ta përmirësojnë jetën e tyre sentimentale gjate kësaj dite. Do tregoheni me te hapur me partnerin dhe nuk do i mbani me asnjë te fshehte. Nga ana tjetër do i shprehni çdo ndjesi te mire apo te keqe. Beqaret do kenë një takim vendimtar qe do ua ndryshoje jetën. Ne planin financiar do mbizotërojë qëndrueshmëria. Mos e prishni atë.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Asnjë planet nuk do ndikoje ne jetën sentimentale te çifteve. Çdo gjë do shkoje mire dhe nuk do ketë debate te zjarrta midis dy partnereve. Edhe beqaret do kenë një dite te zakonshme dhe pa ndonjë te papritur. Bëhuni te duruar nëse doni te gjeni personin e duhur. Financat nuk do jene ne gjendjen me te mire, prandaj merrni sa me shpejt masa për ta përmirësuar situatën.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Ata qe janë ne një lidhje duhet te tregohen paksa me te duruar me personin qe kane ne krah. Mos kërkoni qe ai t'ua realizoje te gjitha dëshirat përnjëherësh. Beqaret do vazhdojnë te jene ne kërkim te princit te tyre te kaltër, por serish gjasat janë për te mos e gjetur atë. Gjithsesi shpresat nuk duhen humbur deri ne minutën e fundit. Financat do jene shume te mira.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Do i merrni gjerat si t'iu vijnë sot ne jetën tuaj sentimentale dhe kjo është gjeja me e mire qe mund te bëni. Është e kote te stresoheni sepse ajo qe është parashikuar do te ndodhe. Beqaret do kenë druajte t'i shprehin ato qe mendojnë sot dhe do mbeten përsëri vetëm. Ne planin financiar duhet te kërkoni ndihmën e specialisteve sepse vetëm nuk keni për t'ia dale.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Dite e paqëndrueshme dhe e mbushur me mosmarrëveshje te njëpasnjëshme kjo e sotmja për te dashuruarit. Asgjë nuk do shkoje si e kishit menduar. Beqaret do jene te hapur ndaj njohjeve te reja dhe do e bëjnë për vete personin qe do pëlqejnë. Ne planin financiar tregohuni sa me te matur. Jo vetëm qe duhet te shpenzoni me maturi, por nuk duhet te jepni as hua.

Mensur Mamuti	FUTBOLLISTI TURK NË FOTO	INSTRUMENT MUZIKOR (SH.)	NJË NGA KLUBET E FUTBOLLISTIT NË FOTO	PRIJËSI I MYFTINISË
KALLI MISRI				
CEREMONI, RITUALE				
VIOLINISTI YNË, SHKELZEN / FILOZOFI NGA MILETI				
T				
EMRI I LUKRECIT, (SHQ.)				
EGOJA				I PANDERSHËM, I PAMORAL
PIJE ALKOOLIKE				
PJESË E MOLEKULËS / FUTBOLLISTI YNË I RI, VALON				

KOHA	XHAXHA	ANGSTREM	NJË NGA KLUBET E FUTB. NË FOTO / LLOJ KOMPJUTERËSH, MAK	B	DIDIMI	PJESË E MOLEKULËS / FUTBOLLISTI YNË I RI, VALON				
LLOJ JELEKU ME GAJTANË								MOLIBDENI / RRËZOHEN		
AMPERI		FILOZOFI GJERMAN, FROM / ARIA E SHKURTË					ILAÇ / AUSTRIA			
SHFAQJE ARTISTIKE ME NUMRA TË NDRYSHËM DËFRYES	ANILA KALLESHI'S CENTER / LLOJ LLAÇI PËR MURË				KOMUNË NË KALABRI / ISH POLITIKANI IRAKIAN, AZIZ					
V							TITULL FISNIK ANGLEZ / PARTI POLITIKE ESTONEZE			
ISH PRIJËSI I ALKAID										NDAJFOLJE PYETËSE
QË I PËRKET RETORIKËS / LLOJ GJARPRI								DANIMARKA / LLOJ DRURI		
P						RADIUMI / SHUMËSI			URUGUAJI / ITALIA	
KLUBI AKTUAL I FUTBOLLISTIT NË FOTO, ISTANBUL ...										

Sudoku

shumë i lehtë

		2	8	9		6		
		6	4					
				6		7	1	
	3					4		
				7	8	1		5
	5							
6						8		
		4		1				7
	1	7			3		6	

mesatar

	2	9			8	1	3	
		4				9		
5	3			9			8	2
2				5				
		3	4		2	5		
				1				8
4	7			2			5	9
		8				2		
	1	2	6			3	4	

Shumë i lehtë: 572891643, 196437582, 843265719, 231956478, 469378125, 758124396, 625749831, 384612957, 917583264. **Mesatar:** 729568134, 864231975, 531794682, 297856413, 183472596, 645319728, 476123859, 358947261, 912685347.

ZGJIDHJET: AVAR, RITE, DOLI, TALES, TITI, UNI, RAKI, B, ATOM, XHAMADAN, MO, A, ERIH, BAR, AKC, MAIDA, VARIETE, ERL, BIN LADENI, RETORIK, DK, PITONI, RA, U, BASHKSHEHIR.

Gabon punonjësi i hotelit, i jep çelësat e Ferrarit personit të gabuar

Një punonjës i hotelit aksidentalisht i ka dhënë çelësat e Ferrarit 230 mijë eurosh personit të gabuar. Por vjedhja e tij nuk ishte sikurse në filmin "Fast&Furios" pasi shoferi nuk ka ditur ta mbajë Ferrari 458 Italia Spiderin nën kontroll. Super vetura e verdhë, që arrin shpejtësinë rreth 320 kilometra në orë, është rikthyer nga policia rrugore pas vetëm disa orëve.

Policia ka zbuluar se si grabitësi u ndalua nga policia pasi ia shkeli gazit për të tërhequr vëmendjen e një vajze. Ai pasi është kapur, nuk e ka pranuar se ka vjedhur veturën, pasi vetë shërbëtori ia ka dhënë çelësat atij, dhe se e kishe në plan ta kthente atë pas disa orëve. Policia ka thënë se burri ia ka dal që ta marr veturën nga shërbëtori për shkak se në atë kohë kishe shumë punë, por pastaj nuk ka ditur ta ndezte atë. Shërbëtori pastaj ka shkuar te një konsumator tjetër, pasi ai nuk i dha atij bakshish, ndërsa shoferi arriti ta merrte atë dhe të bënte gjiro.

Po the "me pak fjalë", të nxjerrin jashtë lokali

Ekziston një kafene në New York që të ndalon përdorimin e fjalës "literally" e përkthyer në shqip si: "fjalë për fjalë" ose "me pak fjalë". Pronarët e këtij lokali të quajtur "Continental" mendojnë se kjo fjalë është fjala më e përdorshme por edhe më e bezdisshmja në jetën e përditshme. Më tej stafi i lokalit paralajmëron të gjithë ato që e përdorin këtë fjalë, brenda 5 minutash të mbarojnë pijen e tyre dhe të ikin. Më tej fleta paralajmëruese mbyllet me fjalën "Ndaloni Kardashianizmin". Menjëherë pas kësaj lokali përtej komenteve pozitive mori edhe komente negative nga gra të cilat e komentonin si maskilist pronarin e kësaj kafeneje. Por menjëherë ka reaguar zoti Smith që është edhe pronari i këtij bari i cili i konsideron këto akuza edhe më qesharake se fjala e "literally". "Të gjithë që më njohin e dinë se unë jam një feminist", tha ai. Më tej Smith ka vendosur edhe një mbishkrim në tualetin e lokalit , ku shkruan: Klienti e ka gjithmonë gabim. Këto shprehje kanë bërë që lokali të bëhet hit në internet.



"Macja e zemëruar" fiton padinë, merr 570 mijë euro dëmshpërblim

Një mace që është bërë hit në internet për shkak të shprehjes së fytyrës ka fituar një padi në gjykatë dhe ka marrë si dëmshpërblim 710 mijë dollarë (rreth 570 mijë euro). "Grumpy Cat" apo Macja e Zemëruar, që është paraqitur në shumë 'memes' në internet, kishte nënshkruar një marrëveshje për përdorim të imazhit me një kompani të kafesë, por kompania e kishte shkelur marrëveshjen duke lansuar edhe një lloj të pijes me fytyrën e maces si imazh kryesor. Gjykata në Florida të SHBA-ve vendosi që ta shpërblejë kompaninë që ka në pronësi të drejtat e imazhit të maces, duke urdhëruar që dëmi të paguhet me 710 mijë dollarë. Kjo është fotografia e kafesë ku u përdor pa të drejtë fytyra e maces së zemëruar. Macja e zemëruar tashmë ka arsye të qeshë.

I besuan verbërisht GPS, përfunduan në... liqen!

Tre persona të cilët po udhëtonin me makinë në një qytet në verilindje të SHBA-së kanë përfunduar në liqenin Champlain, pasi i kanë besuar verbërisht udhëzimeve të aplikacionit GPS në celular, sipas policisë lokale. I pyetur nga policia, drejtuesi i mjetit sqaroi se po ndiqte udhëzimet e GPS në qytetin Burlington, një orë larg nga kufiri kanadez, sipas raportit ku media siguroi një kopje. "E vetmja pjesë e dukshme e automjetit ishte parakolpi i pasëm", thekson raporti, duke saktësuar se pjesa tjetër e automjetit ishte fundosur në ujë. Policia e cila përpiloi raportin për aksidentin vlerësoi se drejtuesi nuk ishte nën ndikimin e alkoolit apo drogës në ato momente. Moti mund të shpjegojë pjesërisht këtë të papritur të pakëndshme, qyteti në momentin e aksidentit ka qenë nën ndikimin e reshjeve të dendura të shiut dhe mjegullës së lehtë. Një zëdhënëse e Google, gjiganti amerikan që mirëmban aplikacionin nuk ishte në gjendje të sqaronte arsyen përse automjeti kishte përfunduar në liqen. "Hartat përditësohen çdo ditë me miliona ndryshime për t'iu përshtatur sinjalistikës rrugore", pohoi ajo në USA Today. Google nuk ka dashur të prononcohet për median.

KALENDARI HISTORIK 30 JANAR

1077 - Papa Gregori i VII falë Perandorin gjerman Henri IV
1647 -Skocezët pajtohen të shesin Mbretin Çarls I Parlamentit anglez për 400 funta
1806 - Prusia merr Hanoverin
1925 - Qeveria turke dëbon Konstantinin VI të Konstantinopojës
1948 - Vritet Mahatma Gandi nga Nutharam Godse
1954 - Belgjika ndërpret marrëveshjen tregtare me BRSS.
1956 - Sulmohet me bombë shtëpia e Martin Luther King Jr.
1976 - Xhorxh Bush emërohet drejtori i 11 i CIA - deri më 1977
2003 - Belgjika ligjërisht njeh martesat e të njëjtës gjini.

A E DINI SE...

Një fëmijë nuk mund të shijojë kripën derisa të mbushi 4 muaj. Kjo vonesë në shije ka të bëjë me zhvillimin e veshkave, të cilat fillojnë procesin e përpunimit të natriumit në këtë moshë.

Foshnjat e lindura në muajin maj zakonisht peshojnë mesatarisht 200 gram më shumë se fëmijët e lindur në muajt e tjerë.

Foshnjat zakonisht preferojnë një zë femëror nga një zë mashkullor, fakt i cili mund të shpjegojë pse njerëzit hollojnë tonin e zërit të tyre kur u flasin foshnjave.

BARSOLETA

MBETURINAT NË DET

Në plazh fjalosen burri dhe gruaja. Në një moment burri thotë:
- Dhe falënderoju fatit që këtu është pllaka në të cilën shkruan:
"E ndaluar është që të hedhen mbeturinat në det", përndryshe të kisha hedhur kaherë.

THËNIA E DITËS

Dashuri nuk është diçka që ju duhet ta gjeni. Dashuria është diçka që ju gjen juve. **(Charles Bukowksi)**